



# Morali im

INFORMACIONE THEMELORE PËR ISLAMIN



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË

# Moralim

**Editor:**

Prof. dr. Mehmet Emin Özafşar - Prof. dr. Recai Doğan

**Drejtor publikimi:**

Dr. Fatih Kurt

**Koordinimi:**

Lokman Arslan

**Projekti:**

Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë - Kryesia e Zyrës së Arsimit Fetar

**Autorët e kapitujve:**

Kapitulli 1-2-3-4: Prof. ass Celal Türer - Kapitulli 5: Prof.dr. Erdoğan Pazarbaşı  
Kapitulli 6: Prof. ass. Süleyman Akyürek - Kapitulli 7: Prof. ass. Ali Kuşat

**Përktheu**

Florida Kulla

**Redaktor gjuhësor**

Fatjon Cuka

**Faqosës**

Erzen Pashaj

**Përgatiti për botim:**

Uğur Altuntop

**Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë: 1347**

**Libra profesionalë: 143**

Vendimi i Këshillit të Lartë të Çështjeve Fetare: 10.04.2017 / 26

2019-06-Y-0003-1347

ISBN: 978-975-19-6726-8

Certifikimi: 12930

Botimi i dytë, Ankara 2019

**Botimi:**

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

+90 312 397 16 17

© KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

**Kontakt:**

Kontakt me Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

## KAPITULLI 1

### MORALI DHE NJERIU

1. Përkufizimi i moralit .....	7
2. Nevoja që ndihet për moralin .....	7
3. Bota e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe morali .....	9
4. Vlerat morale në marrëdhëniet ndërnjerëzore .....	10
5. Vendi i vlerave morale në zhvillimin e karakterit .....	10
6. Vlerat morale në zhvillimin e shoqërisë .....	11

## KAPITULLI 2

### MORALI NË ISLAM

1. Marrëdhënia fe-moral .....	17
2. Morali i bukur sipas Islamit .....	18
3. Rëndësia që Islami i kushton moralit .....	23
4. Marrëdhënia besim, adhurim dhe moral.....	26

## KAPITULLI 3

### NJERIU SHEMBULLOR QË PARASHIKON MORALI ISLAM

1. Qëndrimet dhe sjelljet e mira e të çmueshme në moralin islam .....	33
2. Qëndrimet dhe sjelljet e këqija e të përçmueshme në moralin islam .....	44

## KAPITULLI 4

### QASJA E ISLAMIT NDAJ TË DREJTAVE THEMELORE

1. E drejta e jetës .....	63
2. E drejta e shëndetit .....	65
3. E drejta e arsimit .....	66
4. E drejta e besimit dhe e adhurimit ..	67
5. E drejta e jetës private .....	68
6. Të drejtat ekonomike .....	70

## KAPITULLI 5

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Allahut .....	77
---	----

2. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Pejgamberit .....	78
3. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj vetes .....	79
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes ndaj njëri-tjetrit .....	80
5. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të afërmeve, fqinjëve dhe shoqërisë .....	84
6. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj mjedisit .....	87
7. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj shtetit .....	88
8. Përgjegjësitë tona profesionale .....	89
9. Rregullat e mirësjelljes .....	90

## KAPITULLI 6

### DASHURIA NË MORALIN ISLAM

1. Dashuria ndaj Allahut .....	97
2. Dashuria ndaj Pejgamberit .....	100
3. Dashuria ndaj njeriut .....	102
4. Dashuria ndaj prindërve .....	104
5. Dashuria ndaj kafshëve dhe mjedisit ..	108
6. Dashuria ndaj flamurit dhe atdheut ...	111
7. Dashuria ndaj dëshmorëve dhe gazinjve ....	113

## KAPITULLI 7

### MODELET E SJELLJEVE TË PERSONALITETEVE SHEMBULLORE

1. Ahmet Jeseviu: Dashuria ndaj shërbimit .....	123
2. Junus Emre: Dashuria .....	126
3. Mevlana: Toleranca .....	129
4. Haxhi Bektash Veliu: Dashuria ndaj njeriut .....	131
5. Mimar Sinani: Përgjegjësia profesionale .....	134
6. Mustafa Kemal Atatürku: Dashuria ndaj atdheut .....	135

<b>ÇELËSI I PËRGJIGJEVE</b> .....	142
<b>LITERATURA</b> .....	143

# Parathënie



Allahu, zotëruesi i mëshirës dhe i dhembshurisë, e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, e ka pajisur atë me aftësi të larta, e ka përcaktuar si krijesa, ndaj së cilës drejtohet thirrja hyjnore, e ka nderuar dhe i ka ngarkuar përgjegjësi atij. Në jetën e kësaj bote nuk e ka lënë vetëm atë, e ka nxjerrë nga errësira e mosbesimit dhe, për të bërë të mundur që ai të arrijë në një moral të bukur e të shndritshëm, ka dërguar peygamberë dhe libra si ndihmë e mirësi hyjnore.

Feja, fillesat e së cilës nisin bashkë me njeriun e parë, është një nevojë ekzistenciale për njeriun. Feja është një tërësi këshillash kundrejt gjithë jetës. Ajo na mëson tërësinë e fesë dhe kuptimin përfundimtar, bën të mundur vendosjen e ekuilibrit mes botës dhe ahiretit, mendjes dhe shpirtit, fitimin e harmonisë dhe të paqes së brendshme, sjell dashuri dhe drejtësi, i shndërron detyrat tona individuale dhe shoqërore në një përgjegjësi në cilësinë e adhurimit.

Njeriu, i cili mundohet të kuptojë veten, gjithësinë dhe Krijuesin e tij, që e do Atë dhe është i lidhur me Të, duke ecur në rrugën e përfaqësuesve të mëshirës dhe të librave hyjnorë, të cilët i ka dërguar Krijuesi, e ka orientuar atë në kuptimin e robërimit dhe të vërtetës.

Në këtë pikëpamje, plotësimi i nevojës së njeriut me informacion të drejtë për fenë, është i rëndësishëm.

Meqë feja ka si synim parësor njeriun, është e rëndësishme që të bëhet një përtëritje e vetes në mënyrë të përhershme nëpërmjet informacioneve fetare, me qëllim që jeta të shndrijet, të freskohet mesazhi i Islamit në mendje dhe në zemra, të formohet një lidhje dinamike mes dijes dhe jetës. Në këtë kuadër, Kryesia e Çështjeve Fetare ka përcaktuar si objektiv ndriçimin e popullit tonë me informacion fetar, mbajtjen larg besëtytnive, realizimin e kësaj nevoje me informacione të sakta fetare mbi çështje të besimit, adhurimit, sjerit dhe moralit, duke marrë parasysh edhe të dhënat bashkëkohore e shkencore. Për këtë arsye, ajo ka planifikuar një kolanë të titulluar "Informacionet themelore islame". Vepra që keni në dorë, me titull "Moralit im", është e katërta e kësaj kolane dhe është përgatitur sipas programit mësimor Informacionet Themelore Fetare, mësim i cili jepet në kurset fetare të varura nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë.

Në vepër kemi fokusuar mbi çështjen e moralit, si një ndër temat themelore të fesë islame. Janë trajtuar çështjet e përkufizimit të moralit, vlerave morale, rëndësia që Islami i kushton moralit, veçoritë e njeriut model që parashikon moralit islam, qasja e Islamit ndaj të drejtave themelore, modelet e sjelljeve nga disa personalitete shembullore që kanë jetuar gjatë procesit të formimit dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore.

Dëshira jonë më e madhe është që ky punim të jetë i dobishëm për lexuesit.

Vullneti nga ne, sukcesi nga Allahu.

Kryesia e Çështjeve Fetare e Turqisë





morali im  
morali im



Kapitulli

1








# Morali dhe njeriu

1. Përkufizimi i moralit
2. Nevoja që ndihet për moralin
3. Bota e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe morali
4. Vlerat morale në marrëdhëniet ndërnjerëzore
5. Vendi i vlerave morale në zhvillimin e karakterit
6. Vlerat morale në zhvillimin e shoqërisë



### RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull do të trajtohet përkufizimi i besimit; nevoja që ndihet për moral; bota e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe vlerat morale në botën e këtyre marrëdhënieve; si dhe vendi i vlerave morale në zhvillimin e karakterit të njeriut e të shoqërisë.

Njeriu, aq sa është qenie biologjike, po aq është edhe qenie kulturore/shoqërore. Njeriu është i lidhur me natyrën në aspektin biologjik të tij, ndërsa me anën kulturore lidhet nëpërmjet moralit. Ashtu si nuk mund të jetohet pa u sjellë në përputhje me natyrën, po ashtu, pa qenë i lidhur me fushën morale, nuk mund të jesh qenie kulturore, pra, nuk mund të jesh njeri. Bota e marrëdhënieve ndërnjerëzore është fusha e vlerave. Si rrjedhojë, moral do të thotë të jetosh vlerat në botën e marrëdhënieve. Synimi i vlerave morale është të formojë personalitetin dhe karakterin e njeriut hap pas hapi. Bota që formojnë njerëz, të cilët zotërojnë vlerat morale, është një botë e lumtur.

### 6

### SYNIMET E KËTJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull:

1. Do të përkufizoni konceptin mbi moralin.
2. Do të përkufizoni konceptet në lidhje me moralin.
3. Do të mund të shpjegoni nevojën e njerëzve për moral.
4. Do të mund të thoni vendin e vlerave morale në zhvillimin e karakterit.
5. Do të mund të thoni vendin e vlerave morale në zhvillimin e shoqërisë.

### NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet që janë cituar në fillim të këtij kapitulli. Lexojni përsëri çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
2. Realizojni patjetër ushtrimet analitike që jepen brenda kapitullit dhe aktivitetet studimore.
3. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Studioni veprat që mund të siguronin nga literatura në fund të këtij libri.



### Të studiojmë – Të mësojmë

Përse duhet të jemi të moralshëm? Diskutoni me njerëzit që keni përreth dhe merrni mendimet e tyre.

## 1

### Përkufizimi i moralit



Moralin mund ta shtjellojmë dhe përkufizojmë në pikëvështrime të ndryshme. Mund të bëhen këto përkufizime, të cilat do të karakterizohen nga veçori të përbashkëta të këtyre emërimeve të ndryshme



### Le të mendojmë

- Morali është tërësia e vlerave gjykuese që tregon se si njeriu, duke përfshirë edhe veten e tij, duhet të sillet apo nuk duhet të sillet në marrëdhënie me qeniet dhe me njerëzit.
- Morali është tërësia e rregullave dhe e detyrave që duhet të zbatohet dhe kryejë njeriu në shoqëri.
- Morali është tërësia e sjelljeve të konsideruara të mira apo të këqija në një shoqëri.

## 2

### Nevoja që ndihet për moralin



Ne ushqehemi kur na merr uria, pimë ujë kur kemi etje, pushojmë kur lodhemi, flemë kur na vjen gjumë. Vallë, përse na merr etja dhe uria? Përse lodhemi dhe flemë? Përgjigjet e këtyre pyetjeve i dimë të gjithë. Në mënyrë që njeriu të jetojë e ta vijojë jetesën e tij ashtu si kafshët dhe bimët, trupi i tij ka nevojë të ushqehet, të pijë ujë, të pushojë dhe të flejë gjumë. Nga kjo pikëpamje, njeriu zotëron një strukturë të përbashkët me gjallesat e tjera.



### A e dini?

Bimët dhe kafshët, me qëllim që të mund të vijojnë jetesën e tyre, zotërojnë karakteristikat e tyre të posaçme. Merimangat thurin rrjeta për të siguruar ushqim, bletët jetojnë nëpër koshere, zogjtë ndërtojnë fole, delet e dinë se cilat barëra do të hanë si ushqim. Çdo kafshë, në mënyrë instinktive, e di se si do të jetojë në mjedisin natyror; e di se cila është e mirë apo e keqe për të.



Edhe njerëzit, që nga krijimi i tyre, janë programuar për të përballuar nevojat natyrore, me masa dhe kritere të caktuara. Mirëpo njeriu, krahas këtij programi, zotëron edhe veçori shpirtërore, kulturore ose shoqërore, të cilat janë të posaçme vetëm për të. Njeriu zotëron aftësinë e vendimmarrjes lirisht, zotëron vullnetin, aftësinë e mendimit dhe rrethin shoqëror, nga i cili ushqehet.



### Le të mendojmë

- Vullneti është forca përcaktuese dhe efektive në vendimet e njeriut.
- Sjelljet e njeriut, të bazuara në vullnet, dallojnë nga sjelljet natyrore. Sjelljet e vullnetshme janë sjellje të kryera në gjendje lirie, ngaqë realizohen me dëshirë dhe në mënyrë të vetëdijshme. Këto sjellje të lira i quajmë sjellje morale.

Njerëzit që zhvillohen në mënyrë të shëndetshme, nuk i plotësojnë sjelljet e tyre në formë instinktive ose me sy mbyllur, por sipas një logjike dhe morali të caktuar. Për shembull, nevoja për t'u freskuar në një dhomë të nxehtë është një kërkesë natyrore dhe njeriu, sipas kësaj nevoje dhe me dëshirë, kërkon të hapë dritaren. Mirëpo, nëse në dhomë është dikush i sëmurë, një njeri me mendje të shëndoshë nuk kërkon ta hapë dritaren, por gjen një zgjidhje dhe sjellje morale, duke vënë në funksion mendjen. Përsëri, ky njeri, i cili është i uritur dhe nuk ka mundësi të sigurojë ushqim, mund të zgjedhë të qëndrojë i uritur në vend që të vjedhë ose të marrë pa leje. Qëndrimi moral, i cili nis me një vullnet të tillë, në të vërtetë nxjerr në pah lirinë e njeriut.



### Le të mendojmë

- Liria nënkupton zgjedhjen e një sjelljeje të drejtë nga personi, duke përdorur mendjen, gjykimin dhe vullnetin e tij.
- Liria nuk nënkupton kryerjen e çdo gjëje që dëshirohet. Kjo sepse, as natyra, por as kultura ku njeriu jeton, nuk e lejon të bëjë çdo gjë që dëshiron.

Në vetvete, liria sjell pranimin e rezultateve që do të lindin nga sjelljet e kryera, pra përgjegjësinë.



### Është radha juaj

Përse është përgjegjës njeriu? Për çfarë është përgjegjës ai?

Njeriu, si domosdoshmëri e të qenit njeri, së pari është përgjegjës për sjelljet ndaj vetes, ndaj jetës në tërësi dhe ekzistencës së tij.



### Le të mendojmë

Në mënyrë që njeriu të sillet lirshëm dhe të jetë përgjegjës, duhet që të njohë patjetër të mirën dhe të keqen.



Ne, sjelljet që moralisht duhet të kryhen, i quajmë sjellje të mira; ndërsa sjelljet që nuk duhet të kryhen moralisht, i quajmë sjellje të këqija. Për shembull, nëse një nxënës ka ardhur me vonesë në mësim dhe tregohet i sinqertë kur shpjegon arsyen e të vonuarit, këtë e cilësojmë si një veprim të mirë, ndërsa në rastin kur ai justifikohet duke gënjyer, këtë e cilësojmë si veprim të keq.

## 3

## Bota e marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe morali



Çdo njeri që vjen në këtë botë është në një lidhje dhe marrëdhënie me qenien. Çdo njeri ka marrëdhënie me rrethin e tij natyror dhe historik, por edhe me njerëzit e tjerë. Morali që shfaqet në këtë mes formësohet në marrëdhëniet që personi i jeton personalisht nëpërmjet qëndrimeve dhe sjelljeve të tij të drejtuara ndaj njerëzve të tjerë. Marrëdhënia e njeriut me njerëzit e tjerë fiton kuptim vetëm me moralin dhe arrin në një rregull e harmoni të caktuar.

**Le të mendojmë**

Të realizosh sjellje, njëkohësisht do të thotë të vlerësosh. Sjellja e njeriut përfshin vlerësimin e qëndrimit të tij, por edhe vlerësimin e njerëzve të tjerë, ashtu siç ndodh në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

**Le të mendojmë**

Sjelljet dhe vlerësimet tona, njësoj siç ndikojnë te ne, ndikojnë edhe te njerëzit e tjerë. Por, ndërsa një pjesë e sjelljeve dhe e vlerësimeve tona janë të parëndësishme, të tjerat janë aq të rëndësishme sa të mund të ndikojnë mbi të gjithë jetesën tonë.

Ne, me qëndrimet dhe me sjelljet tona, u ngarkojmë disa gjëra njerëzve, me të cilët kemi marrëdhënie; edhe njerëzit e tjerë na ngarkojnë disa gjëra që duhet t'i realizojmë. Një pjesë prej këtyre gjërave i quajmë si të drejta dhe përgjegjësi. Në këtë pikë del në pah një detyrë morale, që është kriteri më themelor dhe thelbi i fushës së moralit.

Përveç kësaj, njerëzit, në mënyrë që të kenë një jetë shoqërore të rregullt, përcaktojnë rregulla sjelljeje, parime dhe kritere. Çdo shoqëri zotëron parime, rregulla dhe kritere të këtij lloji. Në këtë pikëpamje, edhe zakonet e traditat janë domethënëse. Mjaft të rëndësishme janë edhe ligji e drejtësia. Ndërsa morali është arti i jetesës në mënyrë të përbashkët.

**Le të mendojmë**

Morali është një forcë shoqërore gjithmonë e nevojshme; ai ekziston bashkë me jetën. Asnjë fushë e jetës nuk mund të mendohet e ndarë nga morali.

## 4

## Vendi i vlerave morale në marrëdhëniet ndërnjerëzore



Vlerat morale që shfaqen në marrëdhëniet ndërnjerëzore janë ato që lidhen me sjellje të cilësuara, në mënyrë të thjeshtë, si “të mira” dhe “të këqija”. Për shembull, nëse pyesim dikë se çfarë sjelljeje është të ndihmohet dhe ai e vlerëson si sjellje të mirë, ndërsa kur e pyesim se çfarë sjelljeje është të gënjesh dhe ai e vlerëson si sjellje të keqe, ky është një vlerësim moral.

**Le të mendojmë**

- Vlerat morale janë parime që orientojnë sjelljet tona.
- Vlerat morale u tregojnë njerëzve se çfarë është e mira dhe e keqja.
- Për njeriun, fakti se si duhet të jetojë ai apo ç’është jeta e mirë, përcaktohet vetëm nëpërmjet vlerave morale.
- Vlerat morale na falin vetëdijen e të qenit njeri.

**Le të mendojmë**

Duke qenë se vlerat morale shfaqen në marrëdhëniet ndërnjerëzore, ato shndërrohen në të tilla, prej të cilave nuk mund të largohemi dhe të cilat do të kenë gjithmonë vend në jetën tonë.

Në çdo vend ku gjendet njeriu do të ketë vlerë dhe vlerësim. Këto vlera, ashtu si na interesojnë neve, u interesojnë edhe të tjerëve. Si rrjedhojë, ato janë vlera të rëndësishme ngaqë ndikojnë thellë në jetën tonë.

## 5

## Vendi i vlerave morale në zhvillimin e karakterit



Detyra më e madhe e njeriut është të zbulojë kuptimin e jetës, synimin dhe vlerën e vërtetë dhe ta ndajë këtë me njerëzit e tjerë. Vlerat morale janë vlera që e bëjnë njeriun njeri. Tërësia e të gjitha këtyre vlerave formon njeriun; veprimet, sjelljet dhe zgjedhjet tona janë shprehje e personalitetit dhe e karakterit tonë.

**Le të mendojmë**

Personaliteti/karakterit është një strukturë e posaçme që i përket njeriut, është cilësia themelore që e dallon atë nga të tjerët dhe cilësia kryesore që përcakton modelet e sjelljes.

Personaliteti dhe karakteri i njeriut formohet dhe zhvillohet nëpërmjet jetesës së tij. Jetesa morale është gjendja e qëndrueshme që formon personalitetin e njeriut dhe që vijon gjatë gjithë jetës. Prandaj, edhe jeta morale është jeta në të cilën vijojmë mirësinë që kemi në vetvete dhe në të cilën gjithmonë kemi qëllime të mira. Jeta morale e ndërton personalitetin e njeriut duke e zhvilluar atë. Në këtë proces ndërtimi, personi del nga egoizmi i tij dhe përballet me thelbin në vetvete. Në këtë përballje, ashtu si në shprehjen e Junus Emresë: “Është edhe një unë brenda vetvetes sime”, vëmë re “unin” esencial në thellësinë tonë. Ky “un” esencial ndien respekt edhe ndaj vetes, por edhe ndaj gjallesave të tjera. Në të njëjtën kohë, e ndien se është përgjegjës kundrejt të gjithë atyre që ekzistojnë. Sepse moral do të thotë të jesh përgjegjës për qenien, të jesh i respektueshëm ndaj njeriut dhe jetës.

Nëse moralin e përkufizojmë si “personalitet/karakter”, mund të kuptohet lehtësisht fakti që njeriu është i detyruar të zhvillojë një “egoizëm” për të marrë mjaftueshëm nga vlerat e përbashkëta njerëzore që gjenden te çdo individ, por edhe t’i ndajë vlerat mes të gjithë njerëzve. Zhvillimi i personalitetit realizohet në mjedise të mira. Prandaj, edhe marrëdhënia e personit me atë që është e mirë, ndihmon në zhvillimin e personalitetit. Ndërsa gjërat që nuk e zhvillojnë personalitetin apo që e pengojnë atë, janë të këqija. Njeriu, për të zhvilluar personalitetin dhe për ta formësuar atë duhet të orientohet drejt mirësive dhe të qëndrojë larg të këqijave.



## Vlerat morale në zhvillimin e shoqërisë



Morali është themeli i marrëdhënieve ndërnjerëzore. Brenda një shoqërie, njeriu mund të gjejë mundësinë e jetesës në mënyrë njerëzore vetëm nëpërmjet vlerave morale. Nuk është e mundur të jetojë njerëzisht duke qëndruar i vetëm jashtë shoqërisë. Sepse njeriu, që nga krijimi, është një qenie shoqërore.

Sa më shumë që vlerat morale lëshojnë rrënjë në një shoqëri, sa më shumë përvetësohen dhe zhvillohen, aq më shumë formohen njerëz me moral dhe karakter të shëndoshë në atë shoqëri. Në kriterin e një jetese morale, duhet që njeriu të jetë gjithmonë në marrëdhënie me të tjerët. Sepse njerëzit ndikojnë te karakteri i njëri-tjetrit në mënyrë të ndërsjellë. Në këtë proces ndikimi, të jetosh dhe të ndash vlerat morale është e detyrueshme për zhvillimin e individit dhe të shoqërisë.



### Le të mendojmë

- Njeriu nuk mund të lartësohet duke poshtëruar të tjerët. Për shembull, shitësi që nuk përfill të drejtat e konsumatorit, pas një kohe të shkurtër nuk mund të gjejë një blerës që ta mashtrojë. Prandaj, pa përvetësuar vlerat morale nuk mund të formohet një sjellje e drejtë shoqërore dhe, si rrjedhojë, as edhe një shoqëri morale, e qetë dhe paqësore.
- Në një shoqëri ku morali nuk ka efekt ndikues, krijohet mungesë qetësie, harmonie, kaos dhe rrëmujë, madje, me kalimin e kohës, nuk ka ndikim as ligji.

Ndër vlerat morale, kryesore është ndjenja e respektit që ndiejnë njerëzit për njëri-tjetrin. Prandaj, morali mund të konkretizohet duke respektuar të tjerët, duke treguar kujdes me sjelljet tona dhe duke ndërtuar marrëdhënie të ekuilibruar me të tjerët.



### Le të mendojmë

Lumturia shtohet nëse e ndajmë atë me të tjerët.

Nuk duhet të harrojmë se lumturia e njeriut mund të shtohet vetëm nëse personi merr pjesë në aktivitetet shoqërore; se veprimet që nuk mund t'i kryejmë në mënyrë individuale, mund t'i realizojmë bashkë me të tjerët, nëpërmjet një bashkëpunimi të ndërsjellë; se duke ndarë problemet dhe vështirësitë me njëri-tjetrin mund ta lehtësojmë jetën; se në bashkëpunim me të tjerët mund të tejkalojmë të këqijat, të cilat nuk i përballojmë dot të vetëm.



### Përmbledhja e kapitullit

Morali mund të përkufizohet si tërësia e modeleve të sjelljeve dhe rregullave në marrëdhëniet ndërnjerëzore, të cilat njeriu ka përgjegjësinë t'i respektojë. Dallimi i njeriut nga gjallesat e tjera është se ai zotëron vullnet, i cili është forca që i mundëson atij të marrë vendime. Realizimi i sjelljeve me dëshirë nga ana jonë tregon se ne jemi të lirë. Sjellja lirshëm dhe në mënyrë të përgjegjshme e njeriut aludon për zotërimin e moralit nga ana e tij. Në të vërtetë, morali shfaqet te marrëdhëniet. Në marrëdhëniet ndërnjerëzore parimet që orientojnë sjelljet e njerëzve quhen vlera morale. Si rrjedhojë, të jetojmë nëpërmjet vlerave, do të thotë të jemi të moralshëm. Duke qenë se vlerat morale janë vlerat e të qenit njeri, ose vlera personale, ato na formojnë ne, pra formojnë personalitetin dhe karakterin tonë. Sa më shumë që vlerat morale lëshojnë rrënjë në një shoqëri dhe sa më shumë zhvillohen ato, aq më shumë lartësohet ajo shoqëri moralisht. Në një shoqëri ku vlerat morale nuk janë të efektshme, krijohet mungesë qetësie e paqeje, kaos, grindje dhe përçarje.



### Le t'i hedhim një sy kapitullit

1. Përse njeriu ndien nevojën për moral?
2. Morali është arti i të jetuarit bashkërisht. Përse? Shpjegojeni.
3. Cila është rëndësia e vlerave morale në jetën tonë?
4. Ç'marrëdhënie ka ndërmjet vlerave morale dhe formimit të karakterit tonë?
5. Cila është rëndësia e vlerave morale në zhvillimin e shoqërisë? Shpjegojeni me shembuj?





## Pyetje vlerësuese



**1. Cilat nga alternativat e mëposhtme përkufizohen si modele sjelljeje dhe rregulla që personat janë të detyruar t'i zbatojnë brenda një shoqërie?**

- A) Traditat dhe zakonet      B) Përgjegjësia      C) Morali      D) Instinkti

**2. Cilat nga parimet e mëposhtme i orientojnë sjelljet tona, i japin drejtim jetës sonë dhe na tregojnë se si duhet të jetojmë?**

- A) Të dhënat shkencore  
B) Vlerat morale  
C) Besimet besëtyte dhe të pabaza  
D) Sjelljet instinktive

**3. Cila nga alternativat e mëposhtme ka kuptimin e strukturës kryesore të individit, cilësisë themelore që e dallon atë nga njerëzit e tjerë ose që përcakton modelet e sjelljeve të individit?**

- A) Përgjegjësia  
B) Gjinia  
C) Struktura/përbërja  
D) Karakteri

**4. Zhvillimi i shoqërisë ka nevojë për vlera morale. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk e pasqyron këtë nevojë?**

- A) Fakti që njeriu është një qenie shoqërore  
B) Formimi i një shoqërie të qetë dhe paqësore  
C) Të jetuarit në mënyrë njerëzore/humane  
D) Të jetuarit në përputhje me instinktet tona të brendshme

**5) Cila nga alternativat e mëposhtme nuk pritet të shihet në një shoqëri ku përvetësohen dhe zhvillohen vlerat morale?**

- A) Në këtë shoqëri janë të përhapura të këqijat dhe mungesa e qetësisë a harmonisë.  
B) Në këtë shoqëri është zhvilluar ndjenja e vëllazërisë.  
C) Në këtë shoqëri është i përhapur solidariteti.  
D) Në këtë shoqëri ka bashkëpunim në çështjen e mirësisë.



moralii im  
moralii im



Kapitulli

2



The background features a soft-focus image of yellow and orange flowers, possibly tulips, with a bokeh effect. Overlaid on this are several semi-transparent, overlapping circles in shades of green and yellow. A stream of small, multi-colored diamond-shaped particles falls from the top left towards the center. On the right side, there is a white, stylized floral or scrollwork graphic element.

# Morali në Islam

1. Marrëdhënia fe-moral
2. Morali i bukur sipas Islamit
3. Rëndësia që Islami i kushton moralit
4. Marrëdhënia besim, adhurim dhe moral



### RRETH KAPITULLIT

Islami ofron një mënyrë jetese ndaj njerëzve, e cila në rast se zbatohet, do të bëjë që ata të jenë të lumtur, qoftë në këtë botë, qoftë në botën tjetër. Përvetësimi i kësaj e bën njeriun të zotërojë moralin islam. Të jetosh në mënyrën që ka urdhëruar feja, do të thotë të bësh një jetë morale. Morali lidhet me besimin dhe e merr burimin nga feja. Kur'ani i Madhërueshëm, jeta dhe fjalët e Pejgamberit janë themelet që formojnë moralin islam. Morali islam synon që, bashkë me parimet universale, të formësojë njeriun dhe shoqërinë në një mënyrë të tillë, me të cilën Krijuesi të jetë i kënaqur dhe njeriu të jetë i lumtur. Ngaqë Islami parashikon një jetesë morale të ekuilibruar me kriteret e besimit, ai krijon një lidhje të pandashme mes besimit, moralit dhe adhurimit.

Në këtë kapitull, ashtu siç përmbledhet më lart, do të analizohet marrëdhënia fe-moral; morali sipas Islamit, përkufizimi dhe natyra; burimet e moralit; rëndësia që Islami i kushton moralit dhe marrëdhënia mes besimit, adhurimit dhe moralit.

16

### SYNIMET E KËTJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull;

1. Do të mund të komentoni marrëdhënien fe-moral.
2. Do të mund të klasifikoni burimet e moralit islam.
3. Do të mund të thoni rëndësinë që i jep Islami moralit.
4. Do të mund të thoni përfitimet individuale, shoqërore dhe universale që përfiton morali.
5. Do të përfitoni të dhëna në lidhje me marrëdhënien besim, adhurim dhe moral.

### NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Lexojini përsëri çështjet që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Realizojini patjetër ushtrimet që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
3. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Studioni veprat, të dhënat e të cilave mund t'i siguroni nga literatura në fund të librit.



**Të studiojmë - Të mësojmë**

Cili është kuptimi i shprehjes “Feja është moral i bukur”?

**1****Marrëdhënia fe-moral**

Gjatë gjithë historisë, feja dhe morali kanë qenë në një marrëdhënie shumë të afërt dhe të lidhura me njëra-tjetrën në mënyrë të pandashme. Feja vë në qendër moralin dhe nuk mund të mendohet pa të. Thelbi i fesë është morali që respekton pëlqimin e Allahut.

**Le të mendojmë**

- Synimi kryesor i Islamit është të formojë një njeri dhe shoqëri të moralshme.
- Feja jonë e lartë, Islami, duke iu paraqitur njerëzve një mënyrë të moralshme jetese, mundëson që ata të lartësohen në aspektin moral. Si rrjedhojë, dërgimi i Pejgamberit tonë për të plotësuar bukuritë morale e shpreh qartësisht këtë synim.

Feja kërkon ta zhvillojë personalitetin e njeriut dhe angazhohet me sjelljet e tij. Për këtë arsye, ajo përfshin të gjitha vlerat morale që lidhen me çdo aspekt të jetës. Feja këshillon gjithmonë një jetesë të moralshme. Prandaj, fenë mund ta përkufizojmë si “tërësia e vlerave morale, të cilave njerëzit u besojnë dhe i pasqyrojnë në jetën e tyre, me qëllim që të arrijnë në lumturi”. Duke u nisur nga ky përkufizim, mund të arrihet në rezultatin se, më i virtytshmi dhe më i larti në pikëpamje të besimit, është ai që është më i përsosur në aspektin moral.

Feja, në kuadrin e besimit të njeriut në Allah, duke i bërë atij të ditura detyrat ndaj vetes, ndaj atyre që e rrethojnë dhe, madje, edhe ndaj gjallesave të tjera, luan kështu rolin e udhërrëfyesit për te vlerat. Feja u bën të ditur njerëzve idealet kundrejt të cilave duhet të drejtohen, si duhet të sillen dhe ç’lloj karakteri duhet të formojnë. Mënyra e jetesës e kërkuar nga feja është ajo e një jetese të moralshme.

Morali ku përqendrohet feja si tërësi e rregullave që organizon dhe përpilon marrëdhëniet ndërnjerëzore, ka si objektiv lumturinë e njeriut. Sepse synimi i thirrjes hyjnore është njeriu i lumtur, i cili zotëron moral të bukur. Lumturia e njerëzve mundësohet pikërisht duke respektuar këtë thirrje. Burimi më i lartë i vlerës në fe është Allahu dhe urdhëresat e Allahut përfshijnë njëkohësisht edhe moralin. Si rrjedhojë, për të qenë i moralshëm nga pikëpamja fetare, kjo mund të arrihet vetëm duke respektuar dispozitat fetare. Për këtë arsye, njeriu fetar, ndërsa kryen detyrat fetare, mendon se ka fituar sevap; ndërsa kur cenon rregullat morale, mendon se ka kryer gjynah.

Feja na njofton për një botë tjetër përtej botës së dukshme, të cilën nuk e njohim; ajo është e padukshme dhe lidhet me jetën e tashme. Si rrjedhojë, kur jeta shihet sipas koncepteve fetare, bota duket më e gjerë dhe më e vyer. Kjo pikëpamje dhe qasje hap horizonte të reja në mentalitetin dhe botëkuptimin moral të njeriut.



### Le të mendojmë

- Feja na paraqet aspektet më të thella të jetës morale.
- Jetën morale më të arrirë feja ua tregon njerëzve nëpërmjet peygamberëve.

Njerëzit, faktin se si duhet të jetë njeriu me moral të bukur e mësojnë lehtësisht nga sjelljet e peygamberëve. Në çdo çështje, të marrësh shembull peygamberët për të qenë me moral të bukur, kjo e lehtëson shumë njeriun për të pasur një jetesë të pajisur me moral. Sepse pa pasur një shembull dhe një model, nuk mund të realizohet një jetesë morale.



## Morali i bukur sipas Islamit



### Le të mendojmë

- Islami u ofron njerëzve një mënyrë jetese. U ofron atyre parime se si duhet të jetojnë dhe si mund të jenë të lumtur pasi të kenë zbatuar një mënyrë të caktuar jetese.
- Sipas Islamit, morali është përvetësimi i vlerave/parimeve që ofron ai dhe përjetësimi i tyre në mënyrë të përzemërt.

Sipas Islamit, morali nuk ndahet kurrë nga feja. Ai e bazon moralin gjithmonë në një themel fetar. Parimet morale nga pikëpamja e Islamit nuk janë vetëm rregullat që nxirren si rezultat i gjykimit dhe intelektit; janë shqisa dhe ndjenja thelbësore të vendosura te njeriu që kur krijohet. Në Islam morali mund të krijojë një themel në treshen e përbërë nga natyra e njeriut, përvoja dhe mendja e tij. Në thelb, natyra e njeriut ofron një burim ndaj ndjenjave morale. Përvoja e njeriut tregon se ndjenjat morale janë të zbatueshme, të dobishme dhe të nevojshme për njerëzimin. Ndërsa mendja, duke i sistemuar këto të dyja nga pikëpamja logjike, i bën ato të kuptueshme në trajtën e një mentaliteti të moralshëm.

Qëllimi i Islamit është t'i orientojë njerëzit drejt së drejtës dhe së vërtetës. Synimi është që njeriu të jetë i drejtë dhe i besueshëm. Të qenit dëshmitar i së vërtetës, të qenit në anë të së drejtës dhe të së vërtetës, mund të arrihet me sukses nga personat që kanë personalitet të shëndoshë, që kanë arritur pjekuri morale. Islami, i cili e sheh jetesën morale si një zgjatje të jetesës me besim, thekson se nuk do të mund të mendoheshin të ndara nga njëri-tjetri aspektet praktike, morale dhe të besimit.





Nëse morali kuptohet si realizimi i "së mirës"; "Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por është (cilësi) e atij që beson Allahun, ditën e fundit, melekët, librin dhe pejgamberët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun." (Bakara, 2/177)



Sipas Islamit, është Hz. Pejgamberi ai që tregon se si duhet të jetë qoftë besimi, qoftë morali i drejtë dhe i lartë. Ai, duke thënë: “Unë u dërgova për të plotësuar moralin e bukur” (*Malik, Muvatta, Husnu’l-huluk, 8, II/904*), shpall se në thelb të Islamit gjendet morali i bukur.

Parimet e moralit në Islam, qoftë me ajetet e Kur’anit, qoftë me fjalët e Hz. Pejgamberit, janë shprehur në një mënyrë që të mund të kuptohen lehtësisht nga njeriu i çdo niveli. Këto parime, në kuadër të besimit në Allah, duke filluar nga detyra dhe përgjegjësitë që i përkasin vetes dhe të tjerëve, tregojnë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj familjes, atdheut, shtetit, rrethit material dhe shpirtëror.

Parimet morale të Islamit e nxisin njeriun të kryejë mirësi, të shmanget nga të këqijat dhe të realizojë përgjegjësitë e veta. Në të vërtetë, edhe adhurimet e largojnë njeriun nga të këqijat dhe e afirmojnë atë moralisht. Nga kjo pikëpamje, morali mund të pranohet si tërësia e sjelljeve që e lartësojnë individin e shoqërinë dhe që i orientojnë sjelljet e tyre në një pozitë të respektueshme.

## Përkufizimi dhe natyra e moralit

Fjala moral është shumësi i fjalës “hulk” në arabisht. Fjala hulk ka kuptimet e mëposhtme: “feja, natyra, shprehia dhe karakteri”. Morali, i cili shpjegohet si feja, zakoni, mënyra e sjelljes dhe veprimet, njëkohësisht aludon në personalitetin dhe strukturën e karakterit që është vendosur te njeriu.



### Le të mendojmë

Morali është një aftësi e tillë që vendoset në nefsin e njeriut, ku sjelljet shfaqen pa asnjë shtrëngim, pa menduar dhe në saje të kësaj aftësie.

Analiza e këtij përkufizimi na çon në këto rezultate sa i përket natyrës së moralit:

1. Morali, më shumë sesa tërësinë e veprave dhe të sjelljeve të njeriut, shpreh tërësinë e aftësive shpirtërore që formojnë këto vepra dhe sjellje, pra, burimin e tyre.
2. Morali nuk nënkupton vetëm zakonet dhe aftësitë e mira; nga pikëpamja semantike e fjalës, ai shpreh të gjitha zakonet dhe traditat e mira a të këqija. Si rrjedhojë, ai që ka zhvilluar zakone dhe shprehi të mira në vetvete, quhet “me moral të mirë”, ndërsa ai që ka zhvilluar zakone dhe shprehi të këqija, quhet “me moral të keq”.
3. Morali nuk është një gjendje kalimtare te njeriu, por një gjendje e vendosur në strukturën e tij shpirtërore, duke aluduar mbi tërësinë e aftësive që kanë marrë trajtën e një prirjeje. Kjo veçori e moralit tregon se veprimet tona, qofshin edhe të pakta, duhet të jenë të vazhdueshme.
4. Morali, pa e detyruar njeriun të mendojë, të gjendet nën ndonjë presion apo shtrëngim, e shtyn atë të veprojë me qetësi e harmoni në zemër dhe duke përvetësuar detyrat. Gjërat që përvetësohen dhe që pranohen në mënyrë të vullnetshme, janë një kriter i rëndësishëm në zhvillimin dhe fuqizimin e moralit, sepse edukimi i moralit në fakt është një edukim vullneti.



## Burimet e moralit islam

Morali islam përbëhet nga parime që orientojnë jetën. Burimi kryesor i këtyre parimeve janë: a) Kur'ani i Madhërueshëm; b) Jeta dhe fjalët e Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit.

### Kur'ani i Madhërueshëm



#### Le të mendojmë

- Burimi i parë i moralit islam është Kur'ani i Madhërueshëm. Të gjitha bukuritë dhe vlerat që nxjerr në pah Islami shprehin moralin islam.
- Kur'ani, duke pranuar, së pari, veçoritë individuale dhe shoqërore të njeriut, thekson rregullat e përgjithshme që do ta bëjnë atë një krijesë të moralshme.
- Kur'ani, duke pasur parasysh veçoritë njerëzore, mundohet të krijojë te njeriu një gjendje vetëdijeje. Kjo gjendje vetëdijeje shfaqet në marrëdhëniet njerëzore, të cilat janë vendosur në një themel të formuar nga çështjet kryesore të Islamit: besimi, adhurimi dhe morali.

Kur'ani, vlerat morale, të mirën dhe të keqen e paraqet në mënyrën më të bukur dhe më të efektshme.



“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (Huxhurat, 49/12)

Kur'ani i Madhërueshëm, pasi paraqet veprat e mira dhe të këqija, na lajmëron për atë që do t'u ndodhë atyre që zgjedhin njëren prej këtyre rrugëve. Kështu, duke e lajmëruar njeriun për rezultatin e sjelljeve të tij, mundëson që individi të mund të organizojë veten. Kur'ani, në kryerjen e mirësive dhe të bukurive, parashikon që njeriu ta pastrojë sa mundet shpirtin dhe zemrën nga brengat, synimet dhe mendimet jo morale. Kur'ani, duke theksuar në mënyrë të vazhdueshme besimin dhe veprat e bukura, kërkon që njeriu të vijojë të bëjë një jetesë të ekuilibruar në atë që beson.

### Jeta dhe fjalët e Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit

Burimi i dytë i moralit Islam janë jeta dhe fjalët e Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit (s.a.s.), pra sunneti i tij. Pejgamberi ynë i dashur është njeri shembullor, që u bën të ditur njerëzve në mënyrë të plotë urdhëresat e Allahut dhe që i zbaton këto urdhëresa në trajtën më të bukur.



### Le të mendojmë

- Morali, si një mënyrë jetese, është konkretizuar në një formë të qartë në personalitetin e Hz. Pejgamberit. Ai ka treguar modelin e njeriut “kamil” (të plotësuar), që dëshiron të ndërtojë feja Islame. Prandaj është detyrë njerëzore dhe fetare për muslimanin të marrë shembull Pejgamberin tonë.
- Allahu i Lartmadhëruar, duke iu drejtuar Pejgamberit, urdhëron: “Ti je me virtyte madhore”, ndërsa duke iu drejtuar njerëzve urdhëron: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe te dita e fundit, si dhe e përmend shumë Allahun.” (*Ahzab, 33/21*)

Pejgamberi ynë, i cili është dërguar me qëllim që të plotësojë bukuritë morale, me jetesën dhe sunnetin e tij ka luajtur rolin e një edukatori moral. Të qenit të tij shembull duhet të kërkohet në jetesën në mënyrë të ekuilibruar me besimin. Pa dyshim, të kuptosh edukimin dhe mësimdhënien e tij mbi moralin, kjo mundësohet nëpërmjet analizimit të jetës së tij me të gjitha hollësitë.



### Është radha juaj

Një pyetje që të vjen në mendje lidhur me të qenit e Hz. Pejgamberit një model moral është kjo: A është e mundur që 14 shekuj pas Pejgamberit tonë, njerëzit që jetojnë në një rreth shoqëror krejt ndryshe nga kultura dhe gjeografia ku ka jetuar ai, të marrin sot si shembull Pejgamberin? Nëse është e mundur, si do të realizohet kjo? Përgjigjuni në grup kësaj pyetjeje.

Për ata që besojnë në Islam, të marrësh si shembull Pejgamberin tonë, Hz. Muhammedin, është një detyrë njerëzore që lidhet me besimin. Prandaj, ai është njeri shembull dhe model për çdo periudhë. Mirëpo të marrësh si shembull atë, kërkon edhe realizimin e disa kushteve. Sepse Hz. Pejgamberi e ka orientuar jetën sipas Kur’anit. Jeta e tij është si tefsiri i Kur’anit në mënyrën e jetesës. Kur u pyet Hz. Aisheja se si ishte morali i Hz. Pejgamberit, ajo u përgjigj: “Moral i tij ishte Kur’ani.” (*Ali el-Karni, Sherhu’sh-Shifa, 1/222*). Nga kjo pikëpamje, të mësosh mirë Kur’anin është kushti kryesor për të kuptuar të qenit e tij një shembull.

Kushti i dytë i rëndësishëm i marrjes si shembull të Pejgamberit tonë të dashur është të njohësh mirë qëndrimet që mban ai ndaj ndodhive dhe ngjarjeve, një situatë kjo që lidhet me mësimin e mirë të jetës së tij. Sepse jeta e Hz. Pejgamberit, mënyrat konkrete të urdhëresave fetare të kaluara në jetën shoqërore, janë pamjet e konkretizuara të vahjit hyjnor. Të mësosh në trajtën më të mirë si Kur’anin, ashtu edhe jetën e Hz. Pejgamberit, do të na mësojë se si ta marrim shembull atë.

Aktualisht, ndërsa mundohemi të kuptojmë se ç’është morali islam, kusht paraprak është të kuptojmë Kur’anin dhe sunnetin si burime themelore. Mirëpo, ndërsa bëjmë këtë, nuk mund të shpërfillim eksperiencën historike dhe shoqërore pesëmbëdhjetëshkullore të Islamit. Për të kuptuar, komentuar dhe për të shndërruar në shabllone kulturore vlerat morale që parashikon Kur’ani dhe sunneti, duhet të njohim edhe traditat e përvojat që kanë treguar muslimanët.



### Është radha juaj

Të mendohe mi të kuptojmë traditën. A është tradita pengesë për aktualizimin e moralit islam? Diskutoni!

## 3

### Rëndësia që i kushton Islami moralit



#### Le të mendojmë

- Islami është një tërësi vlerash, e dërguar me qëllim që ta udhëzojë njeriun për të mos devijuar nga synimi i ekzistencës në këtë botë dhe që të vijojë lidhjen me Krijuesin. Të jetosh duke përvetësuar këtë tërësi vlerash do të thotë pikërisht të jetosh sipas moralit islam.
- Islami është fe e pastërtisë krijimore, e cila është dërguar ndaj njerëzimit me qëllim që të formojë moralin e përsosur.
- Synimi përfundimtar i besimit dhe i adhurimeve në fenë islame është ta zhvillojë njeriun në aspektin moral.

Me qëllim që të realizojnë unitetin dhe harmoninë ndërmjet gjallesave në botë, Islami u kushton shumë rëndësi parimeve morale. Prandaj, morali islam nuk përfshin vetëm marrëdhëniet ndërnjerëzore, por edhe marrëdhëniet me krijesat e tjera.



### Është radha juaj

Diskutoni se si morali islam përfshin harmoninë e marrëdhënieve ndërmjet të gjitha gjallesave.

## Përfitimet individuale të moralit

Natyra e njeriut është në përputhje me kriteret morale që kërkon Islami. Morali islam i kushton njeriut vlerën më të lartë, për të cilën është i denjë si krijesa më e përsosur. Sepse në pikëvështrimin islam, njeriu është krijesa më e lartë, fryti më produktiv i pemës së qenies dhe ekzistencës, kurora e madhështisë së krijimit hyjnor. Për këtë arsye, parimet morale që Islami kërkon të përvetësojmë, kanë parasysh gjithmonë zhvillimin e njeriut si qenie e lartë, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerës tek ai. Ndërsa vlera e gjërave të tjera buron nga marrëdhëniet e njeriut me jetën dhe nga ndikimet që kanë këta mbi jetën e njeriut.





### Le të mendojmë

- Kur'ani, së pari bën analizimin e unit të njeriut dhe e shtyn atë që të mendojë në këtë pikë.
- Njeriu që ka si objekt Islami është individualizuar, pra është larg nga egoizmi, është në dijeni të vetes, detyrës që ka, krijimit të tij dhe mundësive që i janë dhënë; është një personalitet që i beson kësaj. Në saje të kësaj vetëdijeje, personi, duke e zhvilluar veten, vjen në trajtën e një krijese dhe ekzistence morale. Morali që shfaqet në këtë pikë nuk është në një natyrë që pranohet detyrimisht nga jashtë, por një moral i arritur, që del në pah nga egoizmi/pastërtia krijimore e njeriut.

Morali islam, duke zhvilluar mundësitë individuale të njeriut, paraqet një tablo jetese, që do t'i mundësojë individit një jetë normale, në normat njerëzore. Në këtë tablo jetese, më përfitues janë ata që kanë moralin më të bukur. Kjo situatë na tregon se morali është shenja e të qenit besimtar i vërtetë. Kriteri i vetëm i bazuar në themelin e respektit ndaj Allahut, i lartësimit në plan individual dhe shoqëror dhe i fitimit të vlerës, është pjekuria morale.

24



### Është radha juaj

Diskutoni mbi fjalinë: "Individi i moralshëm nuk është një person i orientuar nga jashtë, por një person që drejton dhe menaxhon vetveten!"

## Përfitimet shoqërore të moralit

Njeriu, si qenie shoqërore, ndien nevojë për rrethin shoqëror. Në mënyrë që njeriu të jetojë ashtu siç i shkon për shtat nderit të vet dhe që të jetë i lumtur, duhet që rrethi i tij shoqëror të jetë në harmoni. Sigurisht, kjo harmoni shoqërore mund të sigurohet nëpërmjet të qenit në dijeni të përgjegjësive nga individët që formojnë shoqërinë, të qenit në dijeni të urtësisë së krijimit dhe duke shmangur sjelljet që do të prishnin strukturën e individit dhe të shoqërisë. Sepse shoqëritë e krijuara nga individët që i shmangen prishjes së shoqërisë, të keqes dhe të shëmtuarës, jetojnë në një harmoni. Prandaj, morali, ashtu siç synon që njeriu të jetë i paqtë me vetveten, synon të jetë i paqtë edhe me shoqërinë brenda së cilës jeton. Hz. Pejgamberi e paraqet kështu një individ të tillë:



"Besimtari është një person, i cili afrohet me njerëzit dhe me të cilin njerëzit mund të afrohen. Nuk ka mirësi te njeriu që nuk krijon afrimetet dhe me të cilin nuk krijohet afrimetet." (Ahmed, Musned, II, 400)

Feja jonë, Islami, kërkon një shoqëri të gjallë dhe aktive në aspektin moral.



### Le të mendojmë

Shoqëria që parashikon Islami është një shoqëri model dhe që do të jetë shembull për të gjithë njerëzimin në shpërfaqjen e mirësive dhe të bukurive, duke iu kundërvënë së keqes dhe së shëmtuarës.

Sigurisht, ky model do të formohet nga individë të arsimuar dhe të edukuar, që do të solidarizohen me kriterin e mirësisë dhe të devotshmërisë; që do të kërkojnë për tjetrin atë që dëshirojnë për veten; që në vend të interesit personal do të kujdesen për interesin e shoqërisë; që do të mbulojnë të këqijat; do të bëjnë thirrje për mirësi; në të cilin do të pasqyrohen të gjitha vlerat dhe bukuritë morale.

## Përfitimet universale të moralit

Islami dëshiron që të përmirësojë të gjitha aspektet e jetës së njeriut dhe, krahas përmirësimit të njeriut, të realizojë edhe përmirësimin e shoqërisë dhe të universit. Ky proces përmirësimi, që fillon nga individ dhe shtrihet drejt botës, përmban një brendi universale. Si rrjedhojë, morali islam është në një strukturë që lidhet me përfitime universale. Ndërsa qëndrimet e kundërta me këtë proces përmirësimi universal, kritikohen gjithmonë në Kur'an. Allahu i Lartmadhëruar urdhëron: "E, kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin." (*Bakara, 2/205*)



### Le të mendojmë

- Në Islam, parimet morale janë rregulla të thella dhe që përfshijnë natyrën universale; ato i drejtohen të gjithë njerëzimit dhe u interesojnë të gjitha marrëdhëniet me gjallesat.
- Të jesh përgjegjës për ekzistencën, të jesh i respektueshëm ndaj jetës, të tregosh respekt ndaj të drejtave themelore dhe t'i mbrosh ato, të urdhërosh mirësinë, si dhe koncepte të tilla si toleranca, pastërtia materiale dhe shpirtërore, drejtësia, mëshira dhe dhembshuria, të gjitha këto janë vlera që pasqyrojnë aspektet universale të moralit islam.

Parimet universale të moralit islam bazohen tek Allahu i Lartmadhëruar, si burim i ekzistencës dhe së vërtetës.

## 4

## Marrëdhënia besim, adhurim dhe moral



## Le të mendojmë

- Një besimtar i vërtetë zotëron një jetesë morale të ekuilibruar me besimin.
- Besimi prodhon një vetëdije që hap rrugë për formimin e sjelljeve. Kur kjo vetëdije mbështetet me adhurime, jetesa që pasqyrohet bëhet e moralshme, ndërsa personi shndërrohet në një qenie morale. Prandaj, mes besimit, adhurimit dhe moralit ka një marrëdhënie mjaft të afërt.

## Marrëdhënia besim-moral

Islami sheh një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet jetesës morale dhe besimit. Sepse e drejta dhe e vërteta pasqyrohen vetëm te personat që janë fjalëdrejtë dhe kanë sjellje të drejta. Kjo tërësi shprehet kështu në Kur'anin e Madhërueshëm:



“Pa dyshim, ata që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu!’ dhe pastaj qëndrojnë në rrugën e drejtë, nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar e as për t’u dëshpëruar (kur t’u vijë vdekja).” (*Ahkaf, 46/13*)

“Me të vërtetë, atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin melekët (para vdekjes) e do t’u thonë: ‘Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhennetit që ju është premtuar.’” (*Fussilet, 41/30*)

Islami, i cili e cilëson si destinacion besimin dhe moralin, besimin e sheh si shpirtin e sjelljeve të njeriut. Ky shpirt është emri i të qenit i moralshëm, emri i synimit dhe i vendosmërisë që synon zbukurimin e jetës me sjellje të bukura.

Islami, i cili i sheh të lidhur fort me njëri-tjetrin besimin dhe sjelljen, bën të ditur se nga pikëpamja e besimit, më i vlefshëm është më i miri moralisht; ndërsa më i hairit është më i miri e më i bukuri moralisht. Si rrjedhojë, Hz. Pejgamberi na ka treguar se si duhet të jetë si besimi dhe morali, duke qenë ai vetë “në rrugë të drejtë dhe zotëruar i moralit të lartë”.

## Marrëdhënia adhurim-moral

Adhurimi është të qenit i vetëdijshëm i njeriut përballë krijuesit dhe Allahut si zotëruar të çdo gjëje, të qenit i vetëdijshëm për unën e tij, si dhe të shprehurit e respektit dhe përluljes së thellë kundrejt tij, në një mënyrë të posaçme.

Islami formon një lidhje të afërt mes adhurimeve dhe moralit. Sepse adhurimi është shprehja e qëndrimit që do të mbahet gjatë jetës, formësimi i vlerave që besohen në sjelljet e njeriut. Si rrjedhojë, në ajetin: “Por të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë” (*Jasin, 36/61*) aludohet pikërisht për këtë marrëdhënie.



Adhurimet jo vetëm forcojnë besimin në zemrën tonë, por mundësojnë edhe që të jemi me moral të mirë. Për shembull, pesë kohë namaz na kujtojnë gjithmonë Allahun, na bëjnë të heqim dorë nga çdo lloj sjelljeje e shëmtuar. Agjërimi zhvillon ndjenjat e mëshirës dhe të dhembshurisë, na e ruan dorën nga harami dhe gjuhën nga gënjeshtria. Zekati të shpëton nga koprracia, zhvillon ndjenjat e mirësisë dhe të solidaritetit ndaj tjerëve, e bën njeriun të dobishëm për shoqërinë. Kështu, besimi i ushqyer me adhurime jep frytet e moralit të mirë dhe i mundëson njeriut vlerën e tij të vërtetë.



### Të studiojmë - Të mësojmë

Diskutoni fjalën e Mevlanës: “E kërkova të gjithë botën, nuk arrita të gjej një virtut më të lartë se morali i bukur.”



## Përmbledhja e kapitullit



27

Synimi kryesor i Islamit është të formojë një njeri dhe shoqëri të moralshme. Islami, në pikëpamje të besimit të njeriut në Allah, e udhëzon atë duke i bërë të ditur detyrat ndaj vetes, ndaj atyre që e rrethojnë dhe, madje, edhe ndaj gjallesave të tjera. Këtu përfshihen edhe vlerat morale. Islami, aspektet më të thella dhe më të pasura të jetesës morale i ka treguar me shembullin e Hz. Pejgamberit. Hz. Pejgamberi, duke thënë: “Unë u dërgova për të plotësuar moralin e bukur”, ka aluduar se, në të vërtetë, Islami është moral i bukur.

Sipas Islamit, burimi themelor i moralit është Kur’ani. Kur’ani i Madhërueshëm na i paraqet në trajtën më të bukur dhe të efektshme vlerat morale. Burimi i dytë i moralit islam është sunneti i Pejgamberit tonë të dashur, Hz. Muhammedit (s.a.s.).

Morali islam, duke zgjeruar përfitimet universale dhe mundësitë personale të individit, paraqet një tablo, e cila bën të mundur që njeriu të jetojë në normë njerëzore. Më të mirët në këtë tablo janë më të moralshmit. Shoqëritë që kanë në përbërjen e tyre individë me moral të mirë, bëhen të qeta, të paqta dhe të lumtura. Islami kërkon nga njeriu një jetesë morale të ekuilibruar me besimin e tij. Si rrjedhojë, Islami, i cili e cilëson si destinacion tërësinë e besimit dhe të moralit, duke i përfshirë edhe adhurimet në këtë tërësi, ndërton një jetë të jetueshme.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Shpjegoni marrëdhënien ndërmjet fesë dhe moralit.
2. Cilat janë burimet e moralit islam?
3. Cilat janë përfitimet individuale dhe shoqërore të moralit?
4. Shpjegoni marrëdhënien besim-moral.
5. Shpjegoni marrëdhënien adhurim-moral.



## Pyetje vlerësuese



### 1. Cila nga alternativat e mëposhtme është qëllimi kryesor i Islamit?

- A) Të ftojë njerëzit të vuajnë.
- B) Të frikësojë njerëzit.
- C) Të shtyjë njerëzit të sillen pa qëllim dhe mision.
- D) Të formojë një shoqëri morale të ekuilibruar me besimet.

### 2. Cili nga hadithet e mëposhtme tregon se Islami është në thelb një moral i bukur?

- A) "Pastërtia është gjysma e besimit."
- B) "Unë u dërgova për të plotësuar moralin e bukur."
- C) "Të qenit buzagaz është sadaka."
- D) "Ai që na mashtron nuk është prej nesh."

### 3. Cila nga alternativat e mëposhtme është ndër burimet themelore të moralit islam?

- A) Besimet besëtyte.
- B) Tregimet dhe legjendat.
- C) Traditat dhe zakonet.
- D) Jeta dhe fjalët e Hz. Pejgamberit.

### 4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një ndër përfitimet individuale të moralit?

- A) Mundëson që individi të jetojë në mënyrë njerëzore.
- B) I mundëson njeriut vlerë në planin social dhe e lartëson atë.
- C) E drejton individin drejt ndjenjës së egoizmit.
- D) I mundëson njeriut dashurinë e Allahut të Lartmadhëruar.

### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk pasqyron marrëdhënien adhurim dhe moral?

- A) Falja e namazit na mbron nga çdo sjellje e shëmtuar.
- B) Agjërimi të zhvillon ndjenjat e mëshirës dhe të dhembshurisë.
- C) Dhënia e zekatit të shpëton nga koprracia.
- D) Ndiqja ndaj të tjerëve na bën të njohur.



moralii im  
moralii im



Kapitulli

3






# Njeriu shembullor që parashikon morali islam

1. Qëndrimet dhe sjelljet e mira e të çmueshme në moralin islam
2. Qëndrimet dhe sjelljet e këqija e të përçmueshme në moralin islam





### RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull do të tregohen qëndrimet dhe sjelljet që morali islam i parashikon si të mira dhe të çmueshme, si dhe qëndrimet dhe sjelljet që morali islam i parashikon si të këqija dhe të përçmueshme. Njeriu shembullor që parashikon morali islam është njeriu i mirë dhe i drejtë, që u ofron ndihmë materiale të tjerëve, që është i ndershëm, respekton amanetin, që toleron dhe fal, ka durim, është modest, që e mban gjithmonë fjalën, ka sjellje të mirë, që u thotë fjalë të mira njerëzve dhe që është solidar. Njeriu që demonstroi këto sjellje nuk bën koprraci; nuk krijon përçarje mes njerëzve; qëndron larg smirës; nuk e përdor pasurinë pa kriter; shmanget nga dukja dhe veprimet sa për sy e faqe; nuk shtyhet drejt marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore dhe prostitucionit; qëndron larg dehjes dhe kumarit; nuk tërhiqet nga magjia etj.; nuk jep dhe nuk merr rryshfet kur bën çfarëdolloj pune.



# 32

### SYNIMET E KAPITULLIT

Pasi të keni mësuar këtë kapitull:

1. Do të njihni veçoritë e njeriut shembullor që parashikon morali islam.
2. Do të mund të thoni qëndrimet dhe sjelljet e mira e të çmueshme në moralin islam.
3. Do të mund të thoni qëndrimet dhe sjelljet e këqija e të përçmueshme në moralin islam.
4. Do të keni dëshirë të realizoni veçoritë e të qenit njeri shembullor që parashikon morali islam.

### NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Lexojini sërish çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
2. Realizojini patjetër ushtrimet analitike që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
3. Mos u mjaftoni me librin për të mësuar. Studioni veprat, informacionet e të cilave mund t'i siguroni nga literatura në fund të librit.





### Le të diskutojmë

Çfarë nënkupton fakti që Pejgamberi ynë, Hz. Muhammedi, është shembulli më i bukur për muslimanët? Diskutojeni.

## 1

### Qëndrimet dhe sjelljet e mira e të çmueshme në moralin islam

Të kesh qëndrime dhe sjellje, të cilat konsiderohen si të mira dhe të çmueshme në moralin islam, të krijosh personalitet nëpërmjet këtyre sjelljeve, e gjitha kjo bëhet me qëllim ndërtimin e personalitetit. Ngaqë morali është një mënyrë jetese, bukuritë morale duhet të vijnë në trajtën e një shprehie, qëndrimi dhe sjelljeje te një person.

## Mirësia dhe drejtësia

Në Islam, në lidhje me konceptin “mirësi” morale përdoren mjaft fjalë, të tilla si “salah”, “bir”, “hajr”, “maruf”, “hasen”, “tajjib” dhe “ihsan”, të cilat kanë kuptimin ‘mirësi’. Cilësia e përbashkët e këtyre koncepteve është të përshkruajnë sjelljet e bukura që lindin nga një besim i përzemërt e i sinqertë dhe që janë në përputhje me këtë besim.



### Le të mendojmë

Marrëdhëniet e mira dhe sjelljet e bukura të krijuara me njerëzit në botë, nivelet e larta që kërkohen të përfitohen në ahiret, formohen gjithmonë me anë të mirësive

Njeriu i mençur është njeriu që arrin të shohë se dobia gjendet te mirësitë, ndërsa dëmi te të këqijat. Prandaj, të gjithë duhet të orientohen drejt mirësisë dhe bukurisë, aq sa munden, duke e zbuluar moralin. Duhet të dihet se shija e mirësive të kryera nuk krahasohet me asnjë shije në këtë botë dhe gëzimi që vjen nga kryerja e mirësive do të jetë më i madh se gëzimi që do të japë arritja në atë mirësi. Në Kur’an, Allahu i Lartmadhëruar, duke urdhëruar: “...Allahu me të vërtetë i do bamirësit” (*Bakara*, 2/195) dhe “E s’ka dyshim se të mirët janë në kënaqësinë e përjetimeve (në xhennet)” (*Infitar*, 82/13), ka bërë të ditur shpërblimin e mirësive të kryera.



### Le të mendojmë

- Drejtësia, si thelbi i moralit islam, nënkupton që njeriu të jetë i njëjti, në fjalë dhe në vepra, brenda dhe jashtë vetes.
- Drejtësi është emri i kombinimit të fjalëve dhe veprave të njeriut me njëra-tjetrën.
- Drejtësi është veçoria dalluese e të qenit zotërues i moralit të bukur.

Drejtësia, e cila në Kur’an citohet si “sidk” dhe “hakk”, sipas Mevlanës, është gjendja ku njeriu ose duket ashtu siç është, ose është ashtu siç duket. Dijetarët e përshkruajnë drejtësinë si frytin e personalitetit, kriterin e fisnikërisë, një shprehje të pranuar dhe një zbulim të mbarë.

Drejtësia është një formë jetese që bën të domosdoshëm të qenit njeri. Njeriu nuk duhet të jetë i drejtë për çfarëdolloj interesi, por vetëm dhe vetëm si domosdoshmëri e të qenit njeri dhe për të fituar kënaqësinë dhe pëlqimin e Allahut. Sepse drejtësia, ashtu si mirësia, është një virtyt i bukur, që do të na shpëtojë nga përgjegjësia në botë dhe në ahiret dhe që do të na udhëzojë në një makam të lartë në mesin e njerëzve.



“Allahu thotë: ‘Kjo është dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe!’” (Maide, 5/119)



#### Le të mendojmë

Ashtu si çdo virtyt moral, edhe drejtësia shfaqet vetëm në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Njerëzit që nuk sillen drejt në marrëdhëniet ndërnjerëzore, cilësohen me epitete të tilla si gënjeshtar, mashtrues ose dyfytirësh. Munafiku është një person që, megjithëse nuk u beson disa parimeve të caktuara, duket sikur ka besuar. Njerëz të tillë nuk janë njerëz të drejtë, por dyfytirësh.

## Të ofrosh ndihmë materiale ndaj të tjerëve

34



#### Le të mendojmë

Njëra prej veçorive njerëzore që parashikon morali islam është të solidarizohet dhe të ndihmojë materialisht të tjerët. Infak është dhënia e ndihmës ndaj të afërmeve, të varfërve, nevojtarëve dhe institucioneve të bamirësisë për të fituar kënaqësinë dhe pëlqimin e Allahut, përveç zekatit dhe sadakasë.

Infaku është një aktivitet ku, në të vërtetë, do të mundësohet ekuilibri social dhe ky aktivitet është diçka që mund ta bëjë njeriu me vetëdije. Në këtë mënyrë, mallrat dhe pasuria që zotëron njeriu, në të vërtetë i përkasin Allahut; u është dhënë amanet njerëzve që të përfitojnë në një mënyrë të ligjshme nga ajo. Meqenëse shpenzimi i mallrave që zotërojnë njerëzit është si shpenzimi dhe përdorimi nga një person i autorizuar, çfarëdo të urdhërojë i zoti i pasurisë, duhet që edhe njeriu t’i përshtatet asaj.



“Jepuni të afërmeve, të varfërve dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar. Dorëshpuarit janë vërtet vëllezërit e shejtanit dhe shejtani është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.” (Isra, 17/26-27)

Të ofrosh ndihmë ndaj të tjerëve nuk duhet të shihet si përballimi i një nevoje, por si domosdoshmëri e të qenit njeri. Pra, dikush nuk duhet ta ndihmojë dikë për një arsye tjetër, por duhet ta ndihmojë ngaqë ai ka përgjegjësi njerëzore për ta bërë këtë. Sepse rruga e të qenit njeri i arriret kalon nga zgjatja e dorës së ndihmës ndaj të tjerëve. Prandaj, duhet pasur parasysh se, më shumë kanë nevojë për të ndihmuar individët me të mira materiale, sesa nevojtarët për të marrë ndihmë. Një qasje e tillë do të hapë rrugë për eliminimin e pabarazive në shoqëri dhe të dallimeve e ndarjeve mes njerëzve.

## Të jesh i ndershëm (të mbrosh nderin)

Ndershmëria, si virtyt i domosdoshëm që njeriu të jetë qenie e moralshme, është një ndër qëndrimet dhe veçoritë e njerëzve të respektueshëm, e njerëzve të qetë, të paqtë, që kanë arritur të fitojnë kënaqësinë dhe pëlqimin e Allahut në ahiret.

Nderi është shprehja e pastërtisë së shpirtit, qëndrimit larg gjynahut dhe gabimeve. Nderi ka edhe kuptimin e mosshikimit të asgjëje që nuk i përket njeriut; të jesh syngopur karshi çdo gjëje. Ndërsa ai që është i mjaftueshëm me çdo gjë të ligjshme e të lejuar, pra, që është i kënaqur me çfarë i përket atij me të drejtë, ai është një person i ndershëm. Por, kur themi 'iffet', ajo që na vjen në mendje është mbrojtja e nderit. Të tregosh respekt ndaj nderit të dikujt tjetri, njësoj si ndaj nderit tënd, do të thotë të mbrosh nderin tënd.

Siç dihet, njëri prej instinkteve themelore të njeriut është epshi. Epshi ka edhe kuptimin e ndjenjës ndaj gjinisë së kundërt, ndjenjës seksuale që ka femra ndaj mashkullit dhe mashkulli ndaj femrës. Të bësh paturpësi duke ndjekur epshin është një sjellje e keqe, por edhe të ndalohet epshi tërësisht, nuk është diçka e pranuar. Ruajtja e kësaj ndjenje në mënyrë të ligjshme dhe në formë të matur përkufizohet si 'iffet'. Kjo veçori që formon thelbin e fetarizmit, përfshin durimin ndaj çdo lloj kërkese dhe dëshire seksuale.



“Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta! Me të vërtetë, Allahu është i Dijshëm për çfarë bëjnë ata. Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme).” (Nur, 24/30-31)

Të jesh i ndershëm dhe i turpshëm, është domosdoshmëri. Turp është ndjenja e ndrojtjes. Kjo ndjenjë e mban njeriun larg të këqijave, larg fjalëve, veprave dhe sjelljeve që janë gjynah. Mungesa e turpshit, fjalët e thëna hapur, veprat dhe sjelljet e këqija bëhen shkak për përhapjen e këtyre në shoqëri, për prishjen e moralit. Hz. Pejgamberi, i cili thotë se turpi është pjesë e besimit dhe se vetëm mirësi do të sjellë, kërkon që personat besimtarë të jenë të turpshëm dhe të ndershëm, si dhe bën të ditur se Allahu i do personat e turpshëm.

## Të respektosh amanetin

Amaneti është një koncept mjaft përfshirës në lidhje me thelbin e pastërtisë krijimore. Kur thuhet fjala amanet, fillimisht të vjen në mendje diçka që mbahet për t'u ruajtur dhe i dorëzohet dikujt që është pronar i saj, kur ai ta kërkojë. Në fakt, amaneti përfshin të gjitha përgjegjësitë, nga më e vogla, deri te më e madhja. Si rrjedhojë, kur flitet për amanetin duhet të na vijnë në mendje të gjitha përgjegjësitë. Të kujdesesh për shëndetin, të ruash një fjalë që nuk duhet thënë, një sekret mes bashkëshortit dhe bashkëshortes, të përdorësh si duhet një objekt, të plotësosh çdo lloj detyre, të jesh i drejtë në tregti etj., të gjitha mund të kuptohen brenda konceptit amanet.



Të respektosh amanetin në fakt është rezultat natyror i të qenit njeri i besueshëm. Feja islame kërkon të formojë një njeri të besueshëm me anë të parimeve morale. Pejgamberi ynë i dashur e shpreh këtë kriter duke thënë: “Muslimani është një person, nga dora dhe gjuha e të cilit njerëzit janë të besueshëm!” (*Tirmidhi, Iman, 12*) Ajo që shprehet në hadith në mënyrën: “të jesh i besueshëm nga dora dhe nga gjuha”, në kuptimin më të gjerë përshkruan personin, nga dija dhe sjellja e të cilit njerëzit janë të sigurt. Individu që nuk arrin të kombinojë dijen dhe sjelljen, është cilësuar si negativ, qoftë në Kur’an, qoftë në hadithe. “O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!” (*Saff, 61/2-3*)



### Le të mendojmë

Pejgamberi, në një hadith të tij, duke urdhëruar: “Ai që mashtron nuk është prej nesh” (*Muslim, Iman, 164*), ka theksuar se të respektosh amanetin, është kriteri dallues i të qenit njeri shembullor dhe i pjekur.

## Të jesh i drejtë

Koncepti drejtësi mund të përkufizohet si vendosja e çdo gjëje në vendin e saj, si dhënia e së drejtës atij që e meriton, pra, as më shumë e as më pak nga sa i takon. E kundërta e drejtësisë është padrejtësia dhe përçarja. Në saje të drejtësisë mundësohet rregulli dhe harmonia në një shoqëri, si dhe vijimi i këtij rregulli e harmonie.

Drejtësia është një vlerë morale që duhet të marrë trajtën e një jetese. Që njeriu ta bëjë këtë, do të thotë që çdo punë ta bëjë siç duhet. E thënë ndryshe, drejtësia do të thotë të bësh një punë ashtu siç duhet të bëhet.



“Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t’ia vini veshin.” (*Nahl, 16/90*)

Ngaqë drejtësia është një virtut moral që duhet të respektohet në çdo lloj marrëdhënie njerëzore, është e detyrueshme qoftë për qetësinë e individit, ashtu edhe për qetësinë e shoqërisë. Nëse në një shoqëri punët nuk bëhen siç duhet, nëse nuk i dorëzohen atij që është i denjë dhe nuk i jepet e drejta atij që e meriton, nuk mund të flitet për gjallëri, energji dhe rregull në atë shoqëri. Në shoqëri të tilla krijohet padrejtësi, mizori dhe anarki. Sa i përket kësaj çështjeje, është shumë domethënëse hadithi i mposhtëm: “Kur punët i jepen dikujt që nuk është i denjë për to, atëherë prisni kiametin.” (*Buhari, Ilim, 2*)

Dhënia e detyrave ndaj dikujt që nuk është i denjë do të thotë mosrespektimi i së drejtës dhe i drejtësisë. Te njerëzit e një shoqërie, ku nuk respektohet e drejta dhe drejtësia, ku nuk vendoset drejtësia, nuk ka më besim dhe mbështetje. Dhe kjo bëhet shkak për prishjen e paqes. Në shoqëri paqja mund të vendoset me drejtësi. Ndërsa vendosja e drejtësisë bëhet e mundur duke qenë të gjithë të drejtë, sidomos duke mos shmangur nga drejtësia individët me pozita dhe përgjegjësi. Fjalja “Drejtësia është themeli i pasurisë” është thënë enkas për të kujtuar përgjegjësinë e drejtimit dhe të drejtuesve.



### Pjesë leximi

Një grua gjykohet nga Hz. Pejgamberi pasi kishte kryer një grabitje. Gruaja i përkiste një familjeje mjaft të respektuar. Të gjithë u mobilizuan me qëllim që ajo grua të mos dënohej. Dëshën që të ndërhyenin te Hz. Pejgamberi, por askush nuk guxoi. I dërguan Hz. Pejgamberit Usame b. Zejdin, të cilin ai e donte shumë. Pas kësaj Hz. Pejgamberi (s.a.s.) mbajti një qëndrim, të cilit sa më shumë kalon koha, aq më shumë i shtohet vlera. Ai u shpreh: “Ja, popujt që erdhën para jush për këtë arsye u shkatërruan. Nëse njëri prej tyre kryente krim e shpërfillnin, mbyllnin sytë dhe nuk dënohej. Ndërsa kur kryenin krim njerëz të vetmuar, të dobët dhe pa mbështetje, ata i dënonin. Beto hem në Allah, edhe nëse vajza ime, Fatma, do të kryente grabitje, nuk do të hezitoja t’i jepja dënimin!” (Buhari, Hudud, 12)

## Vëllazëria

Njëri prej parimeve morale ku bazohet shoqëria islame është vëllazëria. Kur’ani i Madhërueshëm aludon në vëllazërinë e të gjithë njerëzve dhe më pas vendos theksin ndaj vëllazërisë që buron nga besimi. Në Kur’anin e Madhërueshëm, me ajetin: “Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj me njëri-tjetrin dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni” (Huxhurat, 49/10), bëhet e ditur se vëllazëria nuk buron vetëm nga lidhja e gjakut dhe e qumështit, por edhe lidhja e besimit dhe e zemrës i bën njerëzit vëllezër. Ajo që synohet në ajet është vëllazëria e kësaj bote dhe e botës tjetër. Një vëllazëri e tillë do të thotë të shfaqësh një dashuri për besimtarët larg çdo lloj ndjenje interesi, çdo lloj dëshire përfitimi dhe e pastruar nga çdo lloj dyshimi. Ajo që në Islam e lidh dikë me diçka tjetër është lidhja vëllazërore, besimi.



### Le të mendojmë

Vëllazëria në besim është më e fuqishmja e lidhjeve të zemrës, më e qëndrueshmja e marrëdhënieve të zemrës dhe më e larta e lidhjeve shpirtërore. Në lartësimin e kësaj vëllazërie të pashoqe, në pastërtinë, thellësinë dhe vijimësinë, shfaqja e një dashurie që krijon admirim nuk është diçka për t’u habitur. Si rrjedhojë, vëllazëria islame bazohet në dashurinë e besimit dhe kjo dashuri është e drejtuar ndaj të gjitha krijesave. Në themel të kësaj dashurie, me gjuhën e Junusit, qëndron shprehja: “Toleroje krijesën për shkak të Krijuesit”.

Vëllazëri do të thotë unitet dhe bashkim. Besimtarët, të cilët edhe pse të ndarë si individë, jetojnë brenda një shoqërie, janë si një ndërtesë e fortë; ata plotësojnë njëri-tjetrin dhe forcohen duke u mbështetur te njëri-tjetri. Halli dhe problemi që mund të ketë njëri, u intereson të gjithëve. Ky unitet dhe solidaritet është rezultat i një ndjenje të sinqertë dhe ideale. Duhet që ky ideal të ushqehet vazhdimisht dhe të forcohet. Hz. Pejgamberi, kur thoshte: “Për sa kohë nuk keni dëshiruar për vëllanë atë që dëshironi për vete, nuk konsideroheni se keni besuar” (Buhari, Iman, 7), ka bërë të ditur kriterin e vëllazërisë.

Sipas këtij kriteri, besimtarët do të duan vetëm mirësi për vëllezërit e tyre. Sepse harmonia mundësohet nëse dëshirojmë afrimet, unitet, synime të mira, sinqeritet dhe duke menduar mirë për njëri-tjetrin.



### Le të mendojmë

Aty ku nuk gjendet vëllazëria, nuk gjelbëron as dashuria, ndërsa aty ku nuk gjendet dashuria nuk mund të flitet për unitet, tërësi dhe vëllazëri.

Në rrugën e Allahut, vëllazëri do të thotë të jesh ballë për ballë me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, braktisja e dikujt nga dikush tjetër për shkak të çfarëdolloj arsyeje, ose për shkak të interesit botëror, bëhet shkak për humbjen e dashurisë, ndërsa kur humbet ligji i vëllazërisë dhe i miqësisë që bazohet në dashuri, humb edhe uniteti e bashkimi.

Hz. Pejgamberi, me jetesën e tij ka treguar se sa e rëndësishme është vëllazëria. Pejgamberi ynë ka migruar bashkë me vëllezërit e tij, ka punuar bashkë me ta, ka luftuar bashkë me ta në Bedir, Uhud dhe Hendek, është gëzuar dhe pikëlluar bashkë me ta.

Duhet treguar kujdes i madh mbi ndjenjën e vëllazërisë, duhet të tregohet vullnet moral në ruajtjen e saj, si forca shtytëse e unitetit dhe e bashkimit. Duhet të shmangemi nga dyshimet, thashethemet, mbartja e fjalëve dhe, në veçanti, nga interesi personal, si armiku më i madh i vëllazërisë. Nuk duhet të harrojmë se dëmi i këtyre shprehive të këqija nuk ndodh vetëm mbi një person ose mbi disa persona, por mbi të gjithë shoqërinë.

## Toleranca dhe falja

Kur flasim për moralin e bukur, ajo që na vjen në mendje është toleranca. Toleranca mund të përkufizohet si përballimi me mirëkuptim i çdo gjëje, si tolerancë ndaj çdo gjëje. Toleranca shpreh një gjendje shpirtërore dhe qëndrim më të lartë moral se fjalët "lejim".

Toleranca është një virtyt dhe një vlerë, që në fakt buron nga ekzistenca. Sepse të pranosh faktin, sipas të cilit njeriu është pajisur që në lindje me disa të drejta themelore, siç janë "të drejtat njerëzore", bëhet shkak për tolerancë. Prandaj, tolerancë do të thotë t'i bësh vend dikujt tjetri në jetën tënde dhe të krijosh vend për të. T'i krijosh vend dikujt tjetër në jetën tënde është një konceptim natyror dhe thekson fillimisht jetesën e përbashkët, solidaritetin, 'dashurinë natyrore' që mundëson 'vijimësinë/jetesën e llojeve', pra, ka kuptim të ndryshëm nga mendimi perëndimor në trajtën: "përpjekje dhe luftë për të jetuar", ose "njeriu është krimb i njeriut". Të gjithë e pranojmë se nuk mund të mohohet fakti që qeniet dallojnë nga njëra-tjetra. Mirëpo duhet që këto "dallime" të shkrihen dhe të afrohen, gjë që mund të realizohet vetëm nëpërmjet tolerancës, e cila qëndron mbi themelin e drejtësisë dhe zemrës.

Drejtësia që bën të mundur tolerancën dhe të qenit i tolerueshëm do të thotë të vendosësh qenien në vendin që i takon, të sillesh në përputhje me të. Në këtë kuptim, të jesh i drejtë nuk është një mirësi që i është dhuruar njeriut; është përgjegjësia thelbësore e të qenit qenie dhe e zotërimit të egoizmit. Një kriter tjetër, nga i cili buron



toleranca, është zemra. Zemra është vendshikimi i Allahut ku afrohen me njëra-tjetrën dashuria, afërsia, mëshira, dhembshuria, mirësjellja dhe paqja e qetësia. Zemra është mirësia e Allahut.



“O besimtarë! Në të vërtetë, ju keni armiq në radhët e grave tuaja dhe të fëmijëve tuaj, andaj ruajuni prej tyre! Por, nëse nuk i vini re fyerjet e tyre dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”  
(Tegabun, 64/14)

Njeriu, duke qenë tolerant, pra duke krijuar vend për të tjerët te vetja, ndihmon në arritjen e qetësisë së brendshme dhe të lumturisë. Nga kjo pikëpamje, toleranca nuk është një mirësi apo dhunti, por është një detyrë, një përgjegjësi morale që shtrohet në themelin e ekzistencës. Si rrjedhojë, edhe njerëzit nuk kanë të drejtë të jenë jotolerantë.

## Rezistenca dhe vendosmëria kundrejt negativiteteve (Durimi)

Siç dihet, jeta nuk është vetëm diçka e bukur; vështirësitë dhe problemet janë realitet që duhet t'i njohim nga fillimi e deri në fund të jetës. Nëse e kuptojmë vërtet jetën, shohim se vështirësitë dhe problemet janë kritere të nevojshme për afirmimin dhe pjekurinë e njeriut. Durimi nënkupton përballjen me vështirësitë dhe problemet që njeriu has në jetë. Pasi njeriu beson, durimi është kusht për të, në mënyrë që të mund ta jetojë besimin ashtu siç duhet. Dijetarët islamë tërheqin vëmendjen për dy aspekte të durimit. I pari është të presësh bukuri dhe mirësi duke treguar rezistencë ndaj mundimeve të rënda. Ndërsa tjetri të qëndrosh larg gjërave që të ofrojnë shije dhe epsh, të mbrohesh nga rezultatet e këqija të këtyre gjërave.



### Le të mendojmë

Në përgjithësi, durimi përfaqëson gjendjen e pranimit dhe të rezistencës së treguar në çastin e parë të vështirësisë dhe problemeve; por ai ka edhe kuptimin e të qëndruarit larg haramit dhe të qenit i vendosur në urdhëresat fetare.

Sipas shumë dijetarëve islamë, vështirësitë dhe problemet në jetë janë udhërrëfyesi i njeriut; sepse në botë asnjë punë nuk realizohet pa mundime dhe vështirësi. Durimi është mbështetja e vetme e njeriut kundrejt vështirësive. Durimi është një kundërhelm, i cili i bën të paefektshme vështirësitë e jetës që janë si helm. Durimi është një qëndrim i vështirë, të cilin mund ta arrijë vetëm një person që mund të shohë rezultatin. Sepse askush nuk mund ta vijojë një aktivitet të tillë pa pasur shpërblim. Si rrjedhojë, të tregosh durim është diçka e ngjashme me qëndrimin që tregon se personi është i sigurt nga sukcesi i tij.



“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit.”  
(Bakara, 2/155)

Durimi përballë negativiteteve e largon njeriun nga vështirësitë dhe hallet që mund të ketë. Ajo që i përket personit besimtar dhe të moralshëm është të dijë se, qoftë bukuritë, qoftë vështirësitë, vijnë nga Allahu. Prandaj, ai duhet të falënderojë për bukuritë e të përballet me durim ndaj vështirësive. Kjo situatë është një gjendje që edhe e pjek njeriun, e bën më rezistent ndaj jetës, por edhe i ofron mirësi atij. Hz. Pejgamberi e shpjegon kështu këtë situatë: “Është për t’u habitur puna e besimtarit. Sepse çdo punë e tij, si rezultat është hair e mirësi për të. Nëse arrin në bollëk dhe mirësi, këtë e di nga Allahu dhe e falënderon atë; nga kjo pikëpamje, bollëku dhe mirësia, duke u nisur nga rezultati, është hair për të. Nëse përballet me ngushtim dhe fatkeqësi, si rezultat kjo është e hairit për të.” (Muslim, Zuhd, 64)

## Thjeshtësia

Thjeshtësia, e cila ka kuptimin e të qenit modest, është një ndër virtytet morale që shton respektin ndaj njeriut. Një veçori dhe cilësi e tillë mbështetet në një konceptim që zhvillohet nga kuptimi dhe perceptimi i vogëlsisë së njeriut kundrejt madhësisë së Allahut. Modestia është e kundërta e madhërimit, e mburrjes; ajo është shkalla e nderit dhe e lartësisimit. Pejgamberi ynë, duke shprehur se është më i larti i adhurimeve, thekson rëndësinë e këtij qëndrimi dhe sjelljeje.

Thjeshtësia është e vyer kur bëhet me qëllim të mirë dhe shprehet për të fituar pëlqimin e Allahut. Gjendja e kundërt me thjeshtësinë dhe modestinë është mburrja. Ka shumë njerëz që duken modestë dhe të thjeshtë, por që zemrat e të cilëve janë të mbushura me mburrje. Modestia nuk nënkupton as servilizmin apo poshtërimin dhe as nuk duhet të jetë kështu. Në çfarëdo pozite që të gjendet njeriu, përsëri nuk duhet të harrojë se është njeri dhe se në çdo situatë që ndihet i dobët a i pafuqishëm, nuk duhet të harrojë se në aspektin e krijimit dhe të të qenit njeri, nuk ka ndonjë dallim nga të tjerët. Nuk duhet harruar se personi që zotëron shumë mirësi a cilësi pozitive, nuk i ka nga vetja, por janë mirësi që ia ka dhënë Allahu dhe se mund t’ia rimarrë ato përsëri. Sepse njerëzit e thjeshtë dhe modestë u japin paqe dhe besim njerëzve me të cilët jetojnë.

Ashtu siç përkulen kallinj të pjekur të grurit drejt tokës, edhe njerëzit e aftë dhe me mirësi, duhet të tregojnë më shumë modesti.



“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’” (Furkan, 25/63)

## Të mbash fjalën

Të mbash fjalën, apo të realizosh një fjalë të dhënë, është një ndër parimet morale. Kjo gjendje tregon se ai person është i drejtë dhe i besueshëm. Të mbash fjalën është e një rëndësie të veçantë, qoftë për individin, qoftë për jetën shoqërore. Në çdo çast të jetës, për shembull, duke filluar që nga punët e jetës së përditshme e deri te nëpunësit zyrtarë, në themelimin e tregtisë dhe të institucionit familjar, shohim se bëhet fjalë gjithnjë për mbajtje fjale. Në këtë pikë, vlerësimi i një njeriu në aspekt të moralit, së pari përcaktohet duke e parë nëse na bind me vepra që

janë të besueshme apo jo. Pra, në themel të rregullave që përpilojnë marrëdhëniet e njeriut me Allahun e Lartmadhëruar, me njerëzit e tjerë dhe me objektet, shtrihet drejtësia dhe qëndrimi besnik ndaj fjalës së dhënë.



“Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni përsipër...” (*Nahl, 16/91*) “Ata e zbatojnë premtimin dhe i frikësohen ditës (së kiametit), tmerri i së cilës përhapet gjithkund.” (*Insan, 76/7*)



### Le të mendojmë

Të mbash fjalën e dhënë është një nevojë e aspektit moral dhe njerëzor. Sepse të mos mbash fjalët e dhëna prish marrëdhëniet mes njerëzve dhe harmoninë shoqërore. Fjala e dhënë është një borxh i nevojshëm ndaj personit që i është dhënë. Nëse ai person nuk do ta plotësojë fjalën e dhënë, është më mirë të mos e japë atë.

Mosrespektimi i fjalës së dhënë është konsideruar si shenjë dyfytërisë nga Hz. Pejgamberi.



“Shenjat e dyfytërisë janë tri: gënjen kur flet, nuk e mban fjalën e dhënë dhe nuk e respekton amanetin.” (*Muslim, Iman, 107*)

## Të jesh i mirësjellshëm

Njëri prej parimeve morale që duhet të respektojnë njerëzit për një jetë të lumtur është të qenit i mirësjellshëm. Ajo që synojmë me mirësjellje është vendosja e qetësisë, paqes dhe e lumturisë individuale e shoqërore, duke treguar sjellje të pjekura dhe qytetare në marrëdhëniet ndërnjerëzore në një shoqëri.

Të tregohesh i mirësjellshëm bëhet shkak që, në punët e përditshme me të cilat përballemi, të dominojë rregulli dhe harmonia, kështu shoqëria arrin në një rehati të caktuar. Rregullat e mirësjelljes mund të tregojnë ndryshim sipas besimit, zhvillimit ekonomik, nivelit teknologjik, traditave dhe zakoneve të një shoqërie. Në themelin e të qenit i mirësjellshëm qëndron të qenit i ditur dhe i kulturuar. Të jesh i kulturuar, i mirësjellshëm, janë ndër cilësitë më të rëndësishme që u shtojnë vlerë dhe bukuri të gjitha aktiviteteve njerëzore. Respekti përbën themelin e mirësjelljes dhe njeriu i mirësjellshëm është ai që u jep vlerë të tjerëve dhe që i ndihmon ata.

Të pështysh në rrugë, të hedhësh mbeturina, të pengosh kalimin, të lësh në rrugë gjëra që krijojnë neveri te njerëzit, është mungesë mirësjelljeje. Të shtysh kur zbrit dhe hip në mjetet e transportit publik, të mos presësh radhën aty ku duhet, është një sjellje e shëmtuar. Të jesh më shumë fytyrëqeshur se gjithmonë në dasma dhe bajrame, të jesh i gëzuar, delikat, bujar, të japësh dhurata ndaj të rriturve dhe të vegjëleve, të fitosh zemrën dhe duatë e tyre është ndër rregullat e mirësjelljes. Një tjetër parim që lidhet me mirësjelljen është të mos lëndosh të tjerët me zemër dhe me dua. Të mirëkuptohesh, të solidarizohesh, të marrësh pjesë në halle dhe në gëzime, të përshëndetesh në çdo takim, të pyesësh për shëndetin e të tjerëve, të realizosh me aq sa mundesh kërkesat e tjetrit, janë ndër rregullat e rëndësishme të mirësjelljes.





“Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë! Pa dyshim, Allahu llogarit çdo gjë.”  
(Nisa, 4/86)

## Të sillesh mirë me njerëzit dhe të thuash fjalë të bukura

Të sillesh mirë me njerëzit dhe të thuash fjalë të bukura është ndër parimet morale



të Islamit. Kur themi se duhet të thuhet fjalë të bukura, shumica e njerëzve e perceptojnë këtë në kuptimin e bërjes së ndonjë komplimenti, shprehjes së dashurisë ose të mbajtjes së fjalimeve që japin shpresë. Mirëpo fjalë të bukura nuk janë vetëm këto.

Fjalë të bukura janë të gjitha fjalët që thuhet me zemër, që nuk lëndojnë, që tregojnë të drejtën dhe të vërtetën. Mbajtja lart e dashurisë, së drejtës dhe së vërtetës ndër individët, eliminimi i urrejtjes dhe i armiqësisë, bëhet e mundur vetëm me fjalë që përputhen me të vërtetën. Më e bukura e fjalëve është fjala e Allahut. Prandaj, edhe fjala e vërtetë e bukur është fjala që të thërret tek Allahu, që të fton të jesh i moralshëm.

H.z. Pejgamberi (s.a.s.) në mjaft hadithe ka urdhëruar dhe këshilluar që të themi fjalë të bukura ndaj njerëzve. Edhe ai vetë personalisht është shmangur gjatë gjithë jetës nga fjalët vulgare. H.z. Pejgamberi urdhëron kështu: “Fjala e bukur është sadaka!” (*Buhari, Sulh, 11; Muslim, Zekat, 56*), “Besimtari nuk flet fjalë të këqija, nuk është mallkues, nuk bën punë të keqe, nuk thotë fjalë të keqe.” (*Tirmidhi, Bir, 48*)

Të sillesh mirë me njerëzit dhe të thuash fjalë të bukura është ndër punët e mëdha e të mira. Ky kriter theksohet si në ajete, ashtu edhe në hadithe.



“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (*Fussilet, 41/34*)

## Solidarizimi

Në mënyrë që shoqëria të jetë e lumtur dhe e qetë, njëri ndër parimet morale të nevojshme është ndihmesa e ndërsjellë dhe solidarizimi. Solidarizimi ka dy aspekte, njëri material dhe tjetri moral. Sa i përket ndihmës dhe solidarizimit material, çdo musliman është i detyruar të ndihmojë vëllanë e tij në nevojë për kënaqësinë dhe pëlqimin e Allahut.



“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen.” (*Bakara, 2/274*)

Sipas Islamit, ndihma materiale është kriteri i të qenit njeri, por edhe urdhër i fesë. Me koncepte të tilla si zekati, sadakaja, infaku dhe ihsani, Islami e ka paraqitur solidarizimin ndaj besimtarëve si një adhurim. Zhvillimi dhe ngritja e një shoqërie mund të bëhet e mundur vetëm me anë të solidarizimit dhe ndihmësës. Prandaj, edhe individët duhet të jenë të vetëdijshëm se lartësimi dhe zhvillimi do të ndodhin bashkërisht.



“Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim, se për ata ndërmjet jush që besojnë dhe shpenzojnë (për bamirësi), do të ketë shpërblim të madh!” (*Hadid, 57/7*)

Ndërsa aspekti i dytë i solidarizimit është morali. Muslimanët janë të ngarkuar me detyrë për të informuar njëri-tjetrin, të tregojnë të mirën dhe të drejtën, të shprehin këshilla të bukura dhe të ndriçojnë njëri-tjetrin, të ndalojnë të shëmtuarën dhe të dëmshmen. Një shoqëri mund të jetë e paqte vetëm duke plotësuar këto detyra.



“... Ndhimoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqtësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër.” (*Maide, 5/2*)

## 2

## Sjelljet e këqija dhe të përçmuara në moralin islam



Islami kërkon nga njeriu që të kryejë sjellje të mira dhe të lëvduara, por edhe që të shmanget nga sjelljet e këqija dhe të përçmuara. Sepse këto janë qëndrime dhe sjellje që prishin thelbin e njeriut, që lëndojnë nderin e tij.

## Koprracia

Ndër sjelljet kryesore të këqija dhe të përçmueshme renditet koprracia. Koprracia, si e kundërta e bujarisë, është një ndër veset dhe zakonet që lëndon identitetin dhe nderin e të qenit njeri. Thuhet se frika ndaj koprracisë dhe varfërisë vjen nga nevoja ose nga ndjenja e dashurisë në nivel të tepërt ndaj pasurisë, ose për shkak të braktisjes së dashurisë dhe dhembshurisë ndaj njerëzve, si rezultat i smirës. Dijetarët islamë thonë se ata që shfaqin koprraci duke u frikësuar nga të qenit të varfër, në fakt tregojnë se ushqejnë dyshime të këqija ndaj Allahut dhe këta persona kanë mangësi në gjykim dhe mendim.



“Ata që bëhen koprracë me të mirat që ua ka dhënë Allahu, të mos mendojnë kurrsesi se kështu është më mirë për ta! Jo, kjo është më keq për ata! Ajo që kanë grumbulluar do t’u ngarkohet në qafë ditën e kiametit. E Allahut është trashëgimia e qiejve dhe e Tokës dhe Allahu e di mirë ç’punoni ju.” (Al-i Imran, 3/180)

Njeriu koprrac nuk i beson vetes dhe njerëzve të tjerë. Si burim besimi sheh vetëm paranë dhe materialen. Sa më shumë para të ketë, mendon se po aq shumë do të jetë i lidhur me besimin. Ndërkohë që miku i personit koprrac nuk zotëron nder në shoqëri. Kjo gjendje shpirtërore do të lëndojë jo vetëm ndjenjën e besimit tek Allahu, por edhe në pikëpamje të besimit është një sjellje e dëmshme, që prish paqen dhe lumturinë e shoqërisë.

Si rrjedhojë, Hz. Pejgamberi ynë (s.a.s.) urdhëron: “Shmanguni nga koprracia, sepse koprracia ka shkatërruar ata që erdhën para jush, i ka orientuar ata të derdhin gjak, të shohin haramin si hallall...” (Muslim, Bir, 56) Kur’ani, në vend të koprracisë propozon: “Dhe ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.” (Furkan, 25/67)

## Shpifja

Shpifje do të thotë të thuash për dikë që ka bërë diçka, të cilën në të vërtetë nuk e ka bërë dhe t’i dedikosh atij diçka që nuk e ka kryer. Islami nuk e pranon këtë situatë, por as logjika nuk e sheh të përshtatshme. Sepse shpifja, përtej të qenit një mangësi morale, është krim. Një shpifje e thënë bëhet shkak për shpërbërjen e familjeve të formuara me përkujdesje, për prishjen e lidhjeve të shoqërisë. Prandaj, shpifja është e keqja më e madhe që mund të bëhet ndaj njerëzve dhe ndaj shoqërisë.





### Le të mendojmë

Personi që shpif pa qenë në dijeni, dëmin më të madh ia shkakton vetes. Sepse njeriu, për të cilin konstatohet se ka shpifur, përjashtohet nga shoqëria dhe shtyhet në vetmi.

Kur themi shpifje, ajo që vjen në mendje është fajësimi i dikujt për kryerje marrëdhënieje të jashtëligjshme.



“Vërtet, ata që përgojnë gratë e ndershme, zemërdëlira e besimtare, janë të mallkuar në këtë botë dhe në tjetrën; për ata ka dënim të madh. Atë ditë do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët, duart dhe këmbët e tyre për çfarë kanë bërë.” (Nur, 24/23-24)

Shpifja është një ndër gjynahet më të rënda dhe më të turpshme. Ata që janë me mendje në kokë, që besojnë në Allah dhe në ditën e ahiretit, qëndrojnë larg shpifjes si një veprim që shqetëson të tjerët, që dëmton rrethin shoqëror, njëkohësisht si një sjellje që lëndon nderin e njeriut.

## Përmendja e mirësisë së bërë

Përmendja e mirësisë së bërë është një ndër sjelljet e këqija dhe të përcmueshme. Kjo u shkon për shtat më shumë personave të pamend dhe që nuk mendojnë, që e kanë të kalbur thelbin e tyre. Persona të tillë, duke tentuar të shpjegojnë me fjalë apo sjellje mirësinë që kanë bërë, e turpërojnë atë person dhe si shpërblim, e ngarkojnë atë në zemër, aq sa të mos ngrihet dot.



“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.” (Bakara, 2/262)

Për personat e ndershëm, të lësh shpirtin dhe trupin në vështirësi është më e thjeshtë se mbajtja e peshës së mirënjohjes.

## Thashethemet

Njëra prej sjelljeve të këqija, nga e cila duhet të qëndrojmë larg, është të flasësh pas krahëve të njerëzve. Kjo vepër emërtohet ndryshe si thashetheme apo mbartje fjalësh.



### Le të mendojmë

Të bësh thashetheme do të thotë të flasësh pas dikujt gjëra që nuk i pëlqejnë. Edhe nëse fjalët që thuhën për dikë janë të vërteta, kjo nuk e bën të drejtë të folurin pas krahëve të tjetrit. Gjithsesi, të flasësh gjëra të gabuara në lidhje me një njeri, do të thotë të shpifësh në lidhje me të.

Thashethemet janë një sjellje e keqe, që trondit besimin mes njerëzve. Tronditja e atmosferës së besimit mes njerëzve e prish qetësinë e njeriut dhe të shoqërisë; lëndon ndjenjat e solidarizimit dhe të vëllazërisë mes njerëzve.



“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (*Huxhurat, 49/12*)

Siç shihet, në ajet thuhet se thashethemet janë një vepër aq e neveritshme, sa lëndojnë nderin, njësoj si të hash gjakun dhe mishin e njeriut. Moskryerja dhe pengimi i kësaj vepre të keqe është ndër detyrat e individit dhe të shoqërisë.

Duhet të qëndrojmë larg thashethemeve, të cilat lëndojnë nderin e njeriut, që bëhen shkak për mëzri dhe armiqësi. Thashethemet janë thika që i ngulet vëllazërisë, një flakë që e vyshk dashurinë. Janë burim i grindjes dhe i përçarjes, që prishin unitetin dhe bashkimin mes njerëzve. Me një fjalë, është kënetë e gjynaheve.

## Vetëpëlqimi (mburrja)

Njëra prej sjelljeve të këqija dhe të përçmuara, që ndikon negativisht në marrëdhëniet ndërnjerëzore, është mburrja. Mburrje do të thotë që një person të ndihet krenar, të mbivlerësohet dhe t'i pëlqejë vetja nga pikëpamja e cilësive të vyera, të nderit dhe suksesit.



“Mos i trajto njerëzit me përçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhentë e mburracakët!” (*Lukman, 31/18*)

Fakti që mburrja konsiderohet si sjellje e keqe dhe e përçmueshme, si dhe fakti që Allahu nuk i do mburravecët, ka të bëjë me vlerësimin e gabuar të disa aftësive dhe të mirave që i jepen një njeriu, apo për shkak të keqkuptimit të ngjarjeve dhe dukurive përreth. Të mburresh do të thotë që njeriu të mos dijë vlerën e tij të vërtetë, pra, të

mos njohë veten. Si domosdoshmëri e besimit të teuhidit që gjendet në themelin e sistemit të besimit, në Islam pronari i vërtetë i çdo gjëje është Allahu. Edhe nderi dhe madhështia i përket Atij. Ai që e di këtë realitet nuk duhet të mburret.



“Një person, i cili ka në zemër një thërrime besim, nuk hyn në zjarr. Ndërsa ai që ka në zemër një thërrime mburrje, nuk hyn në xhennet.” (*Muslim, Iman, 39*)

Nuk është vepër e personit të mençur të zgjedhë mburrjen dhe krekosjen, që bëhen shkak për humbjen e vlerës dhe të respektit, ndërkohë që ekziston një traditë e bukur si thjeshtësia dhe modestia, të cilat ndihmojnë në lartësimin e nderit të njeriut.

## Përçarja

Përpjekjet për prishjen e harmonisë dhe të rregullit, që janë në përputhje me vullnetin hyjnor në sipërfaqen e tokës, të qetësisë dhe të paqes së natyrës, të rrethit shoqëror dhe të shoqërisë, të sigurisë së fesë, pasurisë, mendjes dhe nderit, të të drejtave dhe lirive njerëzore, të moralit, rregullit të punës, tregtisë, unitetit dhe paqes shoqërore, quhen ifsat (përçarje), ndërsa ata që i bëjnë këto veprime quhen mufsit. Thelbin e përçarjes e përbën prishja e ekuilibrit të qenia dhe ekzistenca. Kjo ndodh herë në botën e brendshme të njeriut, herë në trupin tonë e herë të tjera në botën tonë të jashtme.

Në themel të përçarjes qëndron kthimi prapa i vlerave morale dhe natyrore për hir të instinkteve personale dhe pangopshmërisë. Përçarja më shkatërruese është shirku, i cili ka kuptimin e aludimit të forcës dhe të vlerave të posaçme të krijuesit ndaj një qenieje tjetër. Përçarja që krijon njeriu e mbush sipërfaqen e tokës me rrëmujë, kaos, grindje dhe mungesë lumturie.



“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t’i bëjë ‘të shijojnë’ pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (*Rum, 30/41*)



### Le të mendojmë

Morali islam urdhëron marrjen e masave parandaluese ndaj personave dhe grupeve që krijojnë përçarje dhe kryerjen e përpjekjeve që do të sjellin paqe.

## Smira (hased)

Smirë do të thotë të ndiesh shqetësim për shkak të mirësisë që ka dikush tjetër, të ndiesh dhimbje për këtë dhe të kërkosh që ajo mirësi të ikë nga ai person. E thënë ndryshe, smirë do të thotë që një individ të mos durojë faktin që veçori, të cilat nuk janë tek ai, të gjenden te dikush tjetër. Smira është një shprehje e keqe, që lind nga bashkimi i paditurisë me pangopshmërinë.



Në botë gjenden bukuri dhe veçori të panumërta. Nuk është e mundur që një njeri t'i ketë të gjitha këto. Njeriu, i cili xhelozohet për gjëra që nuk gjenden tek ai, do të thotë që zotëron një karakter, që mund të bëjë çdo lloj të keqeje tjetër. Nëse dikush bëhet xheloz ndaj bukurive që ka dikush tjetër dhe përpiqet të jetë si ai, kjo quhet zili dhe lakmi. Dëshira për t'i ngjarë dikujt tjetër e pjek dhe e afirmon njeriun. Ndërsa smira është një shprehi e keqe që e zvogëlon dhe e poshtëron njeriun moralisht. Aq shprehi e keqe është smira, sa Kur'ani i Madhërueshëm na mëson dua, me të cilat të mund të mbrohemi nga smira e smirëziut.



“Thuaj: ‘Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar dhe nga sherri i natës kur kaplon terri, nga sherri i falltarëve që fryjnë në nyje (duke bërë magji) dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.’” (Felek, 113/1-5)

Feja islame, me parimet morale që përfshin, synon të formojë një atmosferë vëllazërie mes njerëzve, të mbështetur në dashuri dhe respekt. Smira e cenon lidhjen vëllazërore që duhet të formohet mes njerëzve. Pejgamberi ynë e thekson kështu këtë pikë në hadithin e tij:



“Mos u ashpëroni dhe zemëroni kundrejt njëri-tjetrit, mos ndieni smirë për njëri-tjetrin dhe mos u xhelozoni. Mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. O robërit e Allahut, jini vëllezër. Për një musliman nuk është e lejuar të qëndrojë më shumë se tri ditë i zemëruar me vëllanë e tij.” (Buhari, Edebu'l-Mufred, I, 491)

“Ashtu si zjarri e djeg drurin dhe e mbaron atë, edhe smira shkatërron mirësitë.” (Ebu Davud, Edeb, 44)

Rrugëzgjdhja e shpëtimit nga ndjenja e smirës është të dimë se çdo gjë vjen nga Allahu; në vend që të mendojmë “Përse gjendet tek ai dhe jo tek unë”, të themi, “Allahu që i ka dhënë atij, më jep edhe mua.” Në këtë mënyrë, njeriu mund të kërkojë për veten e tij dhe të shprehë mundim në këtë rrugë.

## Vrasja

Sipas Islamit, të vrasësh një qenie njerëzore është krimi dhe e keqja më e madhe që vjen pas shirkut ndaj Allahut. Të vrasësh njerëz të pafajshëm është një sjellje e frikshme, që shkakton dëm tek individit dhe te shoqëria; që zhdok qetësinë materiale dhe shpirtërore. Allahu i Lartmadhëruar e ka ndaluar vrasjen me qëllim; ndërsa vrasjen e pavend të një njeriu e ka konsideruar si vrasjen e të gjithë njerëzve.



“... Kush vret dikë që s’ka vrarë njeri, ose që nuk ka bërë çrregullime në tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.” (Maide, 5/32)

“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh.” (Nisa, 4/93)



### Le të mendojmë

E drejta më e madhe që Allahu u dhuron njerëzve është e drejta e jetesës. Këtë të drejtë nuk duhet ta cenosh askush. Kjo e drejtë i përket krejtësisht Allahut. Prandaj, jeta e njeriut është e shenjtë; madje, jo vetëm ta vrasësh atë, por edhe ta torturosh a të shprehësh mangësi në respektin ndaj tij, është një rebelim ndaj Allahut.

Mund të kuptohet lehtësisht se njerëzit që cenojnë të drejtën e jetesës pothuajse nuk do të marrin parasysh asnjë të drejtë dhe rregull tjetër. Për më tepër, nëse vrasjet nuk paraprihen, nuk mund të paraprihet as kaosi e përçarja në sipërfaqen e tokës. Kur'ani i Madhërueshëm, duke nxjerrë në plan të parë ndjeshmërinë e individëve mbi këtë çështje, tregon rrugën që do të bëhet pengesë për përhapjen e padrejtësisë dhe të mizorisë: "Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun..." (Al-i Imran, 3/110)

## Gënjeshtria

Në kuptimin e përgjithshëm, të thuash gënjeshtria do të thotë të thuash diçka që është në kundërshtim me të drejtën dhe të vërtetën, të tregosh një ngjarje që ka ndodhur, sikur nuk ka ndodhur, si dhe të tregosh një ngjarje tjetër që nuk ka ndodhur, sikur ka ndodhur. Gënjeshtria është një ndër të këqijat më të shëmtuara. Të gënjeshtër është një sjellje që cenon nderin dhe dinjitetin e njeriut dhe që e poshtëron atë. Në fakt, edhe vetë gënjeshtari e di që kjo është kështu. Sepse njeriu që thotë gënjeshtria nuk dëshiron që të cilësohet si gënjeshtar.

Gënjeshtria e vë njeriun në një pozitë të tillë që nuk i beson dhe nuk e respekton rrethi shoqëror. Sepse shumica e atyre që gënjejnë janë njerëz smirëzinj dhe koprracë. Ndërsa këtyre personave me të drejtë nuk u beson askush. Të jesh fjalëdrejtë është një cilësi njerëzore dhe morale, ndërsa të gënjeshtër është një situatë jonjerëzore dhe jomorale. Sepse dëmi që shkakton gënjeshtria nuk është vetëm tronditja e marrëdhënieve mes njerëzve, por bëhet shkak edhe për shfuqizimin e të drejtave të disa personave dhe dhënies së të drejtës ndaj disa njerëzve që janë të padrejtë.



Gënjeshtria, e cila shuan çdo lloj mundësie për formimin e marrëdhënieve të shëndetshme dhe të sinqerta mes njerëzve, në moralin islam është ndaluar në mënyrë të prerë. "... dhe largohuni prej fjalëve të rreme." (Haxh, 22/30)

"Vërtet, gënjeshtria trillojnë vetëm ata që nuk u besojnë shpalljeve të Allahut; pikërisht ata janë gënjeshtarët e vërtetë." (Nahl, 16/105)

Pejgamberi ynë, i cili e konsideron gënjeshtren si një ndër gjynahet më të mëdha, tregon se gënjeshtria është shenjë e dyfytërisë.

Gënjeshtria ndikon negativisht mbi çdo lloj marrëdhënie njerëzore që mund të krijojë njeriu. Dëmton rrethin shoqëror, të cilin njeriu e krijon me përkujdes; personi, mendimet dhe idetë e të cilit respektohen, e humb veçorinë e të qenit njeri i besueshëm. Për këtë arsye, të thuash gënjeshtria qoftë edhe për shaka, nuk është diçka e mirë. Në pjesën më të madhe të rasteve, të gënjeshtër bëhet pengesë për formimin dhe vendosjen e drejtësisë. Për këtë arsye, ashtu si dëshmia e rreme, edhe të betohesh pa vend është e ndaluar kategorikisht.



## Përdorimi pa kriter (israf)

Islami e sheh si zhvillim negativ që cenon lumturinë e individit dhe të shoqërisë çdo lloj ekstremi dhe tejkalimi mase.

Përdorimi pa kriter (israf) mund të kuptohet si tejkalimi i normës nga një njeri në çfarëdolloj pune, harxhimi më kot dhe pa vend i fjalës, forcës, kohës dhe pasurisë, shpërdorimi i tyre, mungesa e maturisë dhe e kriterit. Fjala israf përdoret më shumë për të treguar tejkalimin e masës

gjatë shfrytëzimit të pasurisë. Ndërsa përdoruesi pa kriter quhet musrif.

Në Kur'an, parimi themelor në lidhje me israfën haset në këtë mënyrë:



“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (A'raf, 7/31)

Për një jetesë të rehatshme në jetën e njeriut janë të nevojshme dy gjëra. E para është të fitosh, ndërsa tjetra është ta harxhosh atë që ke fituar në vendin e duhur dhe në mënyrë të matur. Nëse njëra prej këtyre do të jetë e paplotë, prishet harmonia e jetës, jetesa vështirësohet, qetësia zhduket. Njohja e vlerës së pasurisë, shfrytëzimi i saj në vendin dhe vetëm sipas nevojës së duhur, është një detyrë mjaft e rëndësishme.

Ashtu si në çdo çështje tjetër, edhe sa i përket këtij kriteri, të ndjekësh rrugën e mesme, pra të jesh i ekuilibruar në harxhim, është rregulli dhe parimi më i mirë. Përdorimi pa kriter është përçmuar ngaqë ka prishur parimin e ekuilibrit. Sepse harxhimi i tepërt nga dikush, nënkupton harxhimin në sasi më të paktë nga një person tjetër. Allahu i Lartmadhëruar i ka dërguar në një mënyrë të ekuilibruar mirësitë në sipërfaqen e tokës. Ata që i përdorin pa kriter këto mirësi janë persona që e prishin këtë ekuilibër në favor të tyre, ndërsa mosprishja e këtij ekuilibri është detyrë e besimtarëve





“Dhe, ata që, kur shpenzojnë, nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen të mesmes.” (Furkan, 25/67)

## Grabitja

Grabitja dhe vjedhja nënkupton marrjen fshehurazi të pasurisë, të vlerës dhe të mundësisë së dikujt tjetër, si dhe përvetësimin e saj. Grabitja është një prej sjelljeve të ndaluara në fenë tonë. Sepse vjedhja kryhet që fitimet të arrihen pa mund e vullnet dhe që të tjerët të pësojnë padrejtësi. Vjedhja është shenjë e rënies morale në një shoqëri. Të zhdukësh sjelljen e keqe duke u orientuar drejt masave parandaluese materiale dhe shpirtërore është një detyrë njerëzore.

Feja islame ka pranuar çdo gjë që është e pastër dhe e bukur, ka konsideruar haram dhe ka refuzuar atë që është e shëmtuar dhe e papastër. Pasuri e pastër është ajo që fitohet në rrugë të lejuar. Feja jonë nuk e ka parë si të mjaftueshme vetëm dhënien e urdhëresave sa i përket fitimit të mallrave në rrugë të lejuar; por, ashtu siç i largon njerëzit nga rrugët që të çojnë në grabitje, ka parashikuar edhe dhënien e zekatit, solidarizimin, dhënien e borxhit dhe sadakasë, si dhe vendosjen e sigurisë shoqërore. Duke i bashkuar këto kritere me ndjenjën e besimit, ka nxitur që të formohen sjelljet e nevojshme.



“O besimtarë, mos e përvetësoni pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të palejueshme, përveç rastit kur ajo është tregti me pëlqim të dyanshëm dhe mos e dëmtoni veten (dhe njëri-tjetrin)! Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm me ju.” (Nisa, 4/29)

## Përcmimi dhe mospërfillja e njerëzve

Të tallesh me njerëzit dhe t'i ofendosh ata është moral i keq. Njeriu jeton brenda një shoqërie dhe kjo e bën të detyrueshme vendosjen e marrëdhënieve me të tjerët. Personi që tallet dhe i ofendon njerëzit që e rrethojnë, do të thotë se ka humbur paraprakisht mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të shëndetshme me ta.

Tallja te një njeri fillon bashkë me mendjemadhësinë dhe mburrjen; më pas arrin deri në mospërfilljen dhe nënvleftësimin e atij që ka përballë. Krahas ndjenjës së krenarisë dhe mburrjes, njeriu që tall lëndon vëllanë e tij nga besimi, e shqetëson atë. Njësoj siç është haram të mburresh, edhe tortura ndaj besimtarit është haram. Sepse tallja shkakton ndërprerje të lidhjeve vëllazërore në shoqëri, bëhet shkak për shfaqjen e armiqësisë dhe ndjenjën e urrejtjes ndërmjet njerëzve.

Në fenë tonë, çdo individ zotëron të drejtën e paprekshmërisë së dinjitetit dhe të nderit. Nuk mund të njollosen ndjenjat e nderit dhe të dinjitetit, të cilat formojnë themelin e jetës shpirtërore të individit. Tallja renditet ndër veprimet kryesore sa i përket njollosjes së dinjitetit. Islami qëndron mbi parimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirisë së njeriut, të nderit dhe dinjitetit; për këtë arsye, nëpërmjet Kur'anit merr nën garanci ndjenjat dhe mendimet e muslimanëve.



“O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e përçmoni dhe mos e qesëndisni njëri-tjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.” (Huxhurat, 49/11)



### Le të mendojmë

Marrëdhëniet në shoqëri duhet të ndërtohen mbi bazë sinqeriteti. Ky sinqeritet gjendet në zemrën e njeriut.

Njerëzit janë në dijeni të pamjes së jashtme, por jo edhe të asaj të brendshme. Ajo që do të peshohet pranë Allahut nuk është pamja e jashtme, por sinqeriteti i zemrave. Dija e njeriut nuk është e mjaftueshme për ta perceptuar dhe kuptuar këtë. Për këtë arsye, nuk duhet të poshtërojme askënd dhe as ta lëndojmë dikë duke e tallur.

## Sjellja sa për sy e faqe

Dëshira për t’u dukur, qoftë me fjalë, qoftë me sjellje, nënkupton që një mirësi apo vepër të bukur, ta bësh jo për të fituar pëlqimin e Allahut, por për të fituar pëlqimin e njerëzve. Dëshira për t’u dukur ka në thelb mendjemadhësinë dhe lidhet edhe me dyfytërsinë. Ai që zotëron këtë cilësi njihet si individ që vepron e sillet sa për sy e faqe, pra, sa për t’u dukur.

Sjellja sa për t’u dukur bëhet për t’u siguruar autoritet, njohuri dhe famë, si dhe për interesa materiale. Për të fituar interesa materiale dhe shpirtërore të këtij lloji, abuzohet me ndjenjat dhe respektin që ushqehet ndaj vlerave të shenjta, gjë që përbën edhe kulmin e sjelljes sa për sy e faqe. Sjellje të tilla janë dredhi dhe gënjeshtria. Janë ofendim ndaj nderit dhe dinjitetit të njeriut.

Mungesa e sinqeritetit në fjalët dhe veprimet e personit që ka një sjellje të tillë kuptohen në një kohë të shkurtër nga të tjerët. Askush nuk u beson këtyre. Çdo sjellje që bëhet sa për sy e faqe, konsiderohet imoralitet. Si rezultat, të sillesh në mënyrë të tillë në adhurime, është një mungesë e madhe morali. Sepse adhurimi bëhet për Allahun. Të bësh adhurim për një qëllim tjetër nga fitimi i pëlqimit të Allahut, kjo bën që të mos e kesh pëlqimin e Tij. Të këndosh Kur’an, të falësh namaz, të mbash agjërim, të japësh zekat, të shkosh në haxh, të japësh sadaka sa për sy e faqe dhe me mendimin e përfitimit, kjo i bën të padobishme adhurimet.



“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet sa për sy e faqe të botës dhe që nuk beson në Allahun dhe në ditën e fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhe, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues.” (Bakara, 2/264)

Pra, të bësh adhurim jo duke menduar urdhrin dhe pëlqimin e Allahut, por sa për sy e faqe, të angazhohesh me nxënie dijeje thjesht që të thonë se je dijetar, të japësh zekat dhe sadaka thjesht për t'u bërë i njohur si bujar, nuk është gjë tjetër, por një sjellje e keqe që ka në thelb veprimin sa për sy e faqe.

Megjithëse sjellja sa për sy e faqe realizohet në forma nga më të ndryshmet, veçoria e përbashkët e tyre është dëshira për përfitim, arritja e famës nën petkun e fetarizmit apo të drejtësisë.



### Le të mendojmë

Të qëndrosh larg sjelljes sa për sy e faqe, duke qenë i sinqertë me Allahun dhe me njerëzit, të parapëlqesh pëlqimin e Allahut në vend të lëvdave të njerëzve, të kërkesave të tyre, të frikës dhe interesit, është parimi moral i muslimanit.

## Zinaja dhe prostitucioni

Zinaja nënkupton realizimin e marrëdhënieve seksuale ndërmjet personave, të cilët nuk janë në martesë legjitime apo lidhje martesore. Ngaqë zinaja është një sjellje që prish njerëzimin, qoftë si individ, qoftë si shoqëri, që njollos pastërtinë e dinjitetit të njeriut, ajo është e ndaluar nga feja islame.

Si rrjedhojë, në Kur'an urdhërohet: "Dhe mos iu qasni kurvërisë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!" (*Isra, 17/32*) Një njeri i mençur nuk e bën këtë sjellje të shëmtuar dhe nuk shpreh pëlqim në kryerjen e saj. Sepse nuk mund të imagjinohet një fatkeqësi tjetër më e tmerrshme që njollos nderin e të tjerëve dhe rregullin e jetesës shoqërore.

Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore dhe prostitucioni janë ndaluar, sepse shkaktojnë ndërprerje të strukturës së familjes, e cila përbën thelbin e shoqërive; ajo bëhet shkak për prishjen e brezave pasardhës, vë në rrezik shëndetin e njeriut, krijon rënie shpirtërore te njeriu dhe e bën femrën mjet shfrytëzimi. Marrëdhëniet seksuale dhe prostitucioni lëndojnë ndjenjat shpirtërore të njeriut, sepse nuk është e mundur që një besim i pjekur dhe një sjellje si prostitucioni të ekzistojnë që të dyja tek i njëjti person. Këto të këqija bëhen pengesë edhe për formimin e familjes, shpërbërjen apo rënien në mjerim të saj. Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore dhe prostitucioni e privojnë njeriun nga veçoria më e madhe, nga ndjenja e dashurisë dhe e dhembshurisë. Në cilëndo shoqëri që janë përhapur marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore, kanë krijuar rënie në atë shoqëri. Marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore prishin edhe shëndetin e njeriut. Edhe nga pikëpamja mjekësore është konstatuar se marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore dhe prostitucioni janë burimi i mjaft sëmundjeve shpirtërore. Po ashtu, edhe në aspektin juridik, marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore dhe prostitucioni bëhen shkak për lindjen e mjaft problemeve në lidhje me brezat e rinj.

Shprehja e vullnetit nga individ dhe shoqëria për parandalimin e këtyre të këqijave është një domosdoshmëri. Virtytshmëria më e madhe e njeriut është të zotërojë vullnetin e tij pa u kapluar në ndjenjat epshore. Një person i tillë ka fituar pëlqimin e Allahut. Këta meritojnë të hyjnë në xhennet dhe të arrijnë në mirësitë e mëdha të Allahut. Si rrjedhojë, në Kur'an urdhërohet: "Dhe ata që, pos Allahut, nuk adhurojnë zot tjetër dhe, përveçse me të drejtë, nuk vrasin njeri, gjë që Allahu e ka ndaluar, apo që nuk bëjnë kurvëri. E kush i bën këto, do të marrë gjynahe." (*Furkan, 25/68*) Edhe Hz. Pejgamberi (s.a.s.) urdhëron kështu: "Kushdo që më siguron mua me fjalë se do të ruajë vendin e turpshëm, edhe unë i siguroj xhennetin atij personi." (*Buhari, Rikak, 23*)



## Alkooli dhe kumari

Islami ka si parim mbrojtjen e mendjes, jetës, brezit, pasurisë dhe fesë; ka urdhëruar që këto të vlerësohen siç duhet dhe ka ndaluar kategorikisht që vlera të tilla të dëmtohen në çfarëdo mënyre. Ka ndaluar lëndët që shkaktojnë dehje, të cilat bëhen shkak për çrregullime personale, familjare dhe shoqërore, që pengojnë lumturinë e botës dhe të ahiretit dhe ka ndaluar lojën e kumarit



54



### Le të mendojmë

Alkooli dhe kumari, të cilat kanë shkaktuar probleme serioze gjatë gjithë historisë së njerëzimit, janë të këqija morale që bëhen shkak për torturimin e mjaft njerëzve, shpërbërjen e familjeve, përhapjen e sëmundjeve, janë të këqija që kanë efekte anësore në aspektin shoqëror, psikologjik dhe ekonomik.

Këto dy shprehje të këqija janë armiqtë më të mëdhenj të njerëzimit. Sepse ato, duke pasur si objektiv drejtpërdrejt njeriun, sëmurin jo vetëm trupin, por edhe shpirtin e tij. Disa njerëzve që janë dhënë pas alkoolit dhe kumarit nuk u mjafton që të ardhurat e fituara t'i shpenzojnë për alkool dhe kumar, duke shkatërruar kështu veten, por shpenzojnë edhe të ardhurat e familjes dhe të fëmijëve pikërisht për këtë arsye. Duke e kaluar cakun edhe më shumë, shkaktojnë dëme fizike dhe shpirtërore mbi bashkëshortet dhe fëmijët, madje bëhen shkak për vrasje të ndryshme. Alkooli dhe kumari gjithmonë sjellin të këqija; krijojnë hapësira dhe mosmarrëveshje mes njerëzve, bëhen shkak për përhapjen e mllëfit dhe të zemërimeve, si dhe për kryerjen e të këqijave në shoqëri. Sa i përket kësaj çështjeje, në Kur'anin e Madhërueshëm urdhërohet kështu:



“O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, kumari, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra nga punët e shejtanit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, shejtani me pije alkoolike dhe me kumar kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje, t’iu shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”  
(Maide, 5/90-91)

Në ajetet kur’anore është ndaluar si alkooli, ashtu edhe kumari. Kumari dhe lojërat e fatit janë fitim i padrejtë. Ato bëjnë që pasuria dhe paraja të fitohen me dredhi. Ndjenjat e fitimit të njerëzimit janë të fuqishme. Mirëpo këto ndjenja pozitive kumari i fut në një situatë negative. Duke shtuar të njeriu ambicien për të fituar, shkatërron gjendjen shpirtërore të tij. Tek ata që luajnë kumar, shoqëria dhe miqësia shndërrohen në armiqësi.

Sjellje të tilla të dëmshme, siç dihet, formohen herë për shkak të imitimit, smirës dhe rrethit të keq, herë të tjera për shkak të merakut dhe dobësisë në personalitet. Pothuajse të gjithë ata që janë zhytur dhe kanë humbur në kënetën e alkoolit dhe të kumarit, dihet se fillojnë sjellje të këqija. Për këtë arsye duhet që familjet dhe institucionet arsimore të jenë mjaft të kujdesshme në formimin e të rinjve. Prindërit duhet të kujdesen se ku hyjnë dhe dalin fëmijët e tyre, me kë bëjnë shoqëri, duhet të krijojnë komunikim të shëndetshëm me ta. Brezi i ri duhet të forcohet sa i përket besimit, moralit dhe veprave të bukura, të rinjve duhet t’u tregohen ideale dhe synime të mëdha.

## Magjia dhe orientimi drejt magjisë

Magjitë janë vepra që bëhen për të përfituar rezultate me qëllime të dëmshme, të dobishme ose për mbrojtje, duke krijuar marrëdhënie me forcat mbinatyrore, apo duke përdorur disa sende, në të cilat besohet se gjenden forca të fshehta. Magjia dhe kryerja e magjisë, të cilat kanë si synim parësor përfitimin, nuk kanë asnjë qëllim moral. Nëpërmjet magjisë, magjistarët mund të shfrytëzojnë në maksimum vlerat e shenjta, ku njerëz që pretendojnë se mund të dinë çdo gjë, arrijnë të mashtrojnë njerëz të tjerë.

Në magji përfshihet gënjeshtria, mashtrimi, sjellja sa për sy e faqe, prishja e mendjeve të pastra, lidhja dhe vartësia ndaj dikujt tjetër veç Allahut dhe pretendimi se gajbin mund ta dijë dikush tjetër përveç Allahut, negativitete të cilat nuk përputhen me parimet themelore të Islamit. Duke u nisur nga kjo, një musliman me besim të fuqishëm qëndron larg këtyre sjelljeve, nuk respekton gjërat që hedhin hije mbi besimin e tij dhe nuk u jep përparësi atyre që merren me punë të errëta.

Sipas Islamit, magjia dhe falli, të cilat janë aq të vjetra sa historia e njerëzimit dhe pothuajse e kanë vijuar ekzistencën në të gjithë popujt në mënyra të ndryshme, janë konsideruar ndër gjynahet e mëdha dhe janë ndaluar në formë kategorike. Pavarësisht se mund të konsiderohen ndër gjynahet e mëdha, arsyeja që magjia parapëlqehet nga disa njerëz ka të bëjë me mosnjohjen e mjaftueshme të kësaj çështjeje. Për fat të keq, magjia përbën një treg të rëndësishëm në shtetin tonë dhe ky treg lehtëson punën e

atyre që përfitojnë nga aktivitete të tilla të errëta. Feja jonë e ka ndaluar rreptësisht magjinë, parashikimin e fatit dhe aktivitete të ngjashme. Në Kur'anin e Madhërueshëm urdhërohet kështu: "Gjithashtu, është e ndaluar për ju të kërkonit fatin në fall!" (*Maide, 5/3*) "... Thuaj: 'Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji).'" (*Felek, 113/4*) Pejgamberi ynë e ka konsideruar si një ndër gjynahet e mëdha angazhimin me magji. "Kushdo që bën magji ka kryer shirk." (*Nesai, Tahrir, 197.11*)

Ndërsa rruga më e besueshme për t'u mbrojtur nga magjia dhe magjistari, është që njeriu të mbajë gjallë besimin në Allah, të mbështetet tek Allahu nga rreziqet dhe të këqijat që e tejkalojnë forcën e tij, të përpiqet të mësojë fenë në mënyrë më të drejtë dhe më të bukur. Të qëndrosh larg të gjitha aktiviteteve të errëta dhe që bien në kundërshtim me rrugën e ndritur të Islamit, është ndër detyrat më kryesore të individit dhe të shoqërisë që beson.

## Marrja dhe dhënia e ryshfetit

Ryshfeti ka kuptimin e dhënies së diçkaje nën dorë dhe në mënyrë të paligjshme kundrejt dikujt tjetër, qoftë mall apo para, me qëllim që të përfitohet lehtësi dhe shpejtësi për kryerjen e një pune, apo për të shtënë në dorë diçka të pamërituar. Ryshfeti është një sjellje e shëmtuar, që e çon shoqërinë në fatkeqësi, që trondit nga rrënjët ndjenjat e unitetit dhe të vëllazërisë, që zhduk besimin dhe mbështetjen.

Marrja dhe dhënia e ryshfetit është një rënie morale që bëhet shkak për pengimin e të drejtës dhe ligjëvënies, për prishjen e rregullit dhe të harmonisë shoqërore. Kjo sjellje shumë herë është një cenim ndaj të drejtave njerëzore. Marrja dhe dhënia e ryshfetit është përcaktuar haram nga feja jonë dhe është konsideruar ndër gjynahet e mëdha. Jeta e ahiretit për personat që japin apo marrin ryshfet është e mjeruar. Herët apo vonë do ta vuajnë dënimin e bëmave të tyre. Allahu i Lartmadhëruar është i informuar për të gjitha veprimet tona, të fshehta dhe të hapura: "Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dituria e Tij, përveçse aq sa dëshiron Ai." (*Bakara, 2/155*) "Mos ia merrni pasurinë njëri-tjetrit padrejtësisht! Dhe mos u bëni mitëdhënës te gjykatësit për të përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe me vetëdije mallin e të tjerëve." (*Bakara, 2/155*) Edhe Pejgamberi ynë urdhëron: "Allahu ka mallkuar si atë që merr, po ashtu edhe atë që jep ryshfet." (*Tirmidhi, Ahkam, 9; Ebu Davud, Akdije, 4*)

Në vendet ku nuk funksionon ligji, një individ pa besim dhe pa moral, ngaqë nuk i frikësohet Allahut, mund të kryejë çdo sjellje të turpshme. Mirëpo një person që beson, nuk merr e nuk jep ryshfet, nuk kryen as gjynahe të tjera, pasi e di që Allahu gjithmonë e sheh atë. Ryshfeti dhe korrupsioni janë ndër sjelljet e shëmtuara që i çojnë shoqëritë në fatkeqësi, që tronditin nga rrënjët ndjenjat e unitetit dhe të vëllazërisë, që zhdukin



besimin dhe mbështetjen. Në një shoqëri të përbërë nga besimtarë që e dinë se shihen nga Allahu në çdo vend dhe se një ditë do të gjykohen, nuk rastisen sjellje të tilla. Nëse një musliman nuk përzihet në punë të pista, siç është ryshfeti, është e kuptueshme se nuk frikësohet nga Allahu.

Meqenëse ryshfeti është një sjellje që e shemb një popull qoftë shpirtërisht, qoftë materialisht, duhet të qëndrohet larg tij. Shfuqizimi i ryshfetit, të cilin feja jonë e konsideron si gjynah të madh, bëhet i mundur me vendosjen e ligjit në të gjitha institucionet, por dhe në mendjet e njerëzve. Prandaj, duhet të merret si bazë arsimit dhe edukimi, të cilat ruajnë vlerat shoqërore; krahas kësaj, duhet të respektohen edhe masat parandaluese morale.



## Përmbledhja e kapitullit



Njeriu shembullor që parashikon morali islam u shmanget sjelljeve të këqija dhe mban qëndrime e sillet në mënyrë pozitive. Njeriu shembullor është njeriu i drejtë, që shfaq sjellje të përshtatshme me besimet. Ai, para së gjithash, ndihmon të tjerët, si një domosdoshmëri kjo e të qenit njeri; mundohet të jetë i ndershëm duke u larguar nga çdo lloj gjynahu dhe shëmtie. Njeriu i pjekur, duke i perceptuar si amanet përgjegjësitë e të gjithë jetës, e respekton amanetin, sillet drejt duke e bërë çdo punë ashtu siç duhet, e mban lart dashurinë e vëllazërisë dhe është tolerant ndaj njerëzve. Ky njeri, duke u treguar i durueshëm ndaj vështirësive dhe problemeve të jetës, sillet me modesti kundrejt të gjithëve. Njeriu shembullor, që është në dijeni të rëndësisë që ka mbajtja e fjalës në marrëdhëniet ndërnjerëzore, shton mirësjelljen dhe dijen, duke qenë i vetëdijshëm gjithmonë për solidaritetin, si një ndër vlerat kryesore të jetës; po ashtu, sillet mirë me njerëzit dhe thotë fjalë të bukura.

Njeriu shembullor që parashikon morali islam, qëndron larg shprehive të këqija që lëndojnë dinjitetin dhe nderin e të qenit njeri, pra nga koprracia, shpifjet, nga shprehja e mirësisë së kryer, bërrja e thashethemeve, sjellja me mburrje, përçarja, nxitja e smirës, tallja me njerëzit, nga veprimet sa për t'u dukur, kryerja e zinasë dhe prostitucionit, nga orientimi drejt dehjes dhe kumarit, magjisë dhe marrjes së ryshfetit.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Përse është e rëndësishme mirësia dhe drejtësia?
2. Përse është e nevojshme të jesh i ndershëm?
3. Përse Islami e këshillon vëllazërinë?
4. Ç'është modestia dhe përse është e nevojshme ajo?
5. Përse është i nevojshëm solidariteti?
6. Cilat janë dëmet e shpifjes?
7. Përse Allahu nuk e pëlqen faktin që njeriut t'i pëlqejë vetja?
8. Cilat janë dëmet e marrjes dhe të dhënies së ryshfetit?



## Pyetje vlerësuese



**1. Me cilin nga konceptet e mëposhtme shprehet dhënia e ndihmesës ndaj të afërmeve, të varfërve, nevojtarëve dhe institucioneve të bamirësisë për pëlqimin e Allahut, përveç zekatit dhe sadakasë?**

- A) Iffet (Nder).
- B) Infak (Ndihmesë).
- C) Mohim.
- D) Drejtësi.

**2. Cili nga veprimet e mëposhtme nuk bën pjesë te respektimi i amanetit?**

- A) Të kujdesesh për shëndetin.
- B) T'u tregosh të tjerëve një situatë të veçantë mes bashkëshortëve.
- C) Të realizosh detyrën.
- D) Të jesh i drejtë në shitblerje.

**3. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një ndër dobitë e të qenit modest?**

- A) Njerëzit modestë u falin qetësi dhe besim njerëzve, me të cilët jetojnë bashkërisht.
- B) Njerëzit modestë ankohen te të tjerët dhe bëjnë thashetheme.
- C) Njerëzit modestë gëzojnë respektin e të tjerëve.
- D) Njerëzit modestë fitojnë pëlqimin e Allahut.

**4. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkaku kryesor i të qenit një e keqe morale vetëpëlqimi?**

- A) Tronditja e besimit ndërmjet njerëzve.
- B) Zemërimi i njerëzve.
- C) Keqvlërësimi dhe keqkuptimi i disa aftësive dhe mirësive që i janë dhënë njeriut, po ashtu edhe fakti që njeriu mendon se këta i vijnë nga vetja.
- D) Prishja e marrëdhënieve mes njerëzve.

**5. Cila nga alternativat e mëposhtme është shkaku më i efektshëm në luajtjen e kumarit dhe në konsumimin e alkoolit?**

- A) Mungesa e edukimit.
- B) Imitimi dhe lakmia.
- C) Dobësia në personalitet.
- D) Mungesa e interesit.



morali im  
morali im



Kapitulli

4








# Qasja e Islamit ndaj të drejtave themelore

1. E drejta e jetesës
2. E drejta e shëndetit
3. E drejta e arsimit
4. E drejta e besimit dhe e adhurimit
5. E drejta e jetës private
6. Të drejtat ekonomike



## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull do të trajtohet në mënyrë të përgjithshme qasja e Islamit ndaj të drejtave themelore. Ekzistojnë disa të drejta kryesore të pashmangshme, me qëllim që njeriu të vijojë jetën në një mënyrë të ndershme. Këto janë e drejta e jetesës, e drejta e shëndetit, e drejta e arsimit, e drejta e besimit dhe e adhurimit, e drejta e jetës private dhe e drejta e pronësisë. Këto të drejta themelore përbëjnë tërësinë e vlerave që e bëjnë njeriun njeri. Të drejtat themelore shërbejnë në njohjen e vlerës së njeriut dhe në dëshirën për të mbrojtur këtë vlerë. Gjatë gjithë historisë së tij, njerëzimi i ka përvetësuar këto vlera dhe, për t'i ruajtur ato, ka paguar e do të vijojë të paguajë çmime të mëdha. Këto të drejta dhe vlera, Islami na i ka bërë të ditura para 14 vitesh si objektivat kryesorë që ka synuar t'i realizojë. "Deklarata universale e të drejtave të njeriut", e pranuar në ditët e sotme, i përfshin në vetvete këta objektiva.



# 62

## SYNIMET E KAPITULLIT

Pasi të keni mësuar këtë kapitull:

1. Do të mund të thoni se cilat janë të drejtat themelore.
2. Do të mund të thoni qasjen e Islamit ndaj të drejtave themelore.
3. Do të mund të shpjegoni marrëdhënien e të drejtave themelore me njëra-tjetrën.
4. Do të ndieni dëshirë të realizoni të drejtat themelore në moralin islam.

## NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Lexojini sërish çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
2. Realizojini patjetër ushtrimet analitike që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
3. Mos u mjaftoni vetëm me librin për të mësuar. Studioni veprat, informacionet e të cilave mund t'i siguroni nga literatura në fund të librit.





### Le të diskutojmë

Ç'do të thotë "të jesh njeri"? Diskutoni.

## 1

### E drejta e jetesës



Koncepti "hak", i cili nënkupton çdo vlerë që zotërojnë njerëzit, shpreh "të drejtat e fituara" që nga lindja dhe ato që përfitohen më pas. Në të drejtat themelore, të cilat në gjuhën ligjore përkufizohen si "të drejtat e njeriut", bëhet fjalë për mjaft dispozita që përcaktohen nga Kur'ani dhe sunneti. Të drejtat themelore sipas Islamit janë vlera që burojnë nga të qenit njeri dhe që e ruajnë nderin e njeriut.

Të drejtën e jetesës Islami e sheh si një të drejtë themelore, që duhet të mbrohet dhe ndaj së cilës duhet të tregohet respekt. Në mënyrë që njeriu të vijojë ekzistencën e tij, duhet të plotësojë tërësisht aktivitetet jetësore. Si rrjedhojë, një person që nuk zotëron të drejtën e jetesës, nuk zotëron edhe të drejtat e tjera. Nuk mund të flitet për përgjegjësitë dhe detyrat e atyre që nuk zotërojnë të drejtën më natyrore, e cila është e drejta e jetesës.



### Le të mendojmë

E drejta e jetesës së njeriut buron që nga krijimi. Njeriu është një model i vogël i gjithësisë, është anëtar dhe përfaqësues i të gjithë botës njerëzore. Për shkak të të qenit krijesa më e respektuar e Allahut, ai konsiderohet si më i larti i krijesave.

Kur'ani i Madhërueshëm, në ajete të ndryshme, bën të ditur se të shprehësh respekt ndaj të drejtës së jetesës është një sjellje e lartë. Po ashtu, thekson edhe shenjtërimin e të drejtës së jetesës. Në të vërtetë, e drejta e jetesës nuk përfshin vetëm njeriun, por edhe kafshët e bimët. Çdo krijesë që është e gjallë meriton respekt. Paprekshmëria e gjallesave mund të shfuqizohet vetëm në kuadër të disa parimeve fetare, morale, juridike dhe njerëzore, sepse të jetosh është e drejta më themelore e tyre. Individit, jo vetëm zotëron të drejtat sa i përket vijimit të jetës, por edhe është i ngarkuar me detyrën e ruajtjes së jetës. Prandaj, duke qenë se askush nuk ka të drejtë t'i marrë jetën dikujt tjetër, as vetë personi nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij për të jetuar. E drejta e jetesës i ngarkon individit dhe shoqërisë përgjegjësi serioze dhe të rënda ndaj shtetit si një organizim politik.

Kur'ani, duke filluar kryesisht nga njeriu, vrasjen e një gjallese pa të drejtë e pranon si një ndër gjynahet më të mëdha. Për atë që i drejtohet një krimi të tillë, Kur'ani bën të ditur se është mallkuar përjetësisht dhe se do të mbetet në xhehennem, po ashtu se ky qëndrim është një gjynah i madh, që tërheq mbi vete dënimin dhe mallkimin e Allahut.



"Dhe, ata që, pos Allahut, nuk adhurojnë zot tjetër, nuk vrasin njeri pa vend, gjë që Allahu e ka ndaluar, përveçse me të drejtë dhe që nuk bëjnë kurvëri. E kush i bën këto, do të marrë gjynahe." (Furkan, 25/68)

Shprehja “vrasje pa vend”, që citohet në ajet, ka një domethënie specifike dhe të rëndësishme. Kjo shprehje aludon në ndërhyrjen e padrejtë brenda fushës që fillon nga ardhja e njeriut në jetë e deri në marrjen e ekzistencës së tij nën garanci dhe vijimin e saj. Nga ky aspekt, që nga procesi i ardhjes së njeriut në jetë e deri në vdekje, çdo ndërhyrje që mund të vijë qoftë nga jashtë, qoftë nga brenda, që bëhet ndaj nderit të njeriut, për shembull, kryerja e një aborti pavarësisht se nuk rrezikohet shëndeti i nënës, një torturë e vogël ose një nëpërkëmbje dhe shtypje e madhe, të gjitha këto kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës për të jetuar. E thënë ndryshe, nuk është e mjaftueshme vetëm mbrojtja e jetës, thelbësor është parandalimi i cenimeve ndaj jetës materiale e shpirtërore të njeriut dhe mundësimi i vijimit të jetesës në një mënyrë të ndershme.

Islami kërkon që të ruhet e drejta e jetesës për të gjithë njerëzit, jo vetëm për muslimanët. Sepse përtej të drejtës së jetesës që pasqyron nderin e njeriut, nuk ka gjë tjetër që meriton më shumë respekt. Prandaj, të dëmtosh çfarëdolloj gjallese, tregon mungesën e respektit ndaj jetës.



Feja jonë, përveç përçarjes dhe vrasjes pa pasur të drejtë, e ka ndaluar vrasjen e njeriut. Sepse përçarje do të thotë t'i drejtohesh çdo lloj dhune që zhduk rregullin, stabilitetin dhe lumturinë e shoqërisë. Allahu bën të ditur se grindja dhe përçarja në shoqëri është më keq se vdekja: “... Mosbesimi është më i rëndë se vrasja.” (*Bakara, 2/191*)

Thelbësore për njeriun është të jetojë në qetësi. Kjo, përveçse një domosdoshmëri e të qenit njeri, është edhe një situatë që e do Allahu.

Islami, ndërsa krijon një marrëdhënie ndërmjet kritereve jetësore dhe besimit, parashikon të mbajë gjallë te njeriu ndjenjën e gjykimit dhe të përgjegjësisë ndaj Allahut. Nuk

mund të formojmë një shoqëri të ekuilibruar pa qenë të vetëdijshëm se çfarë është e drejta e jetesës. Në ditët e sotme, çdokush që zotëron gjykim të shëndoshë, e kupton se çfarë dëmi kanë shkaktuar mbi jetën njerëzit që nuk e zotërojnë një vetëdije të tillë.

## 2

### E drejta e shëndetit



Renditja e të drejtës së shëndetit pas të drejtës së jetesës në radhën e të drejtave themelore, është domethënëse. Kjo sepse të gjithë jemi në dijeni të vështirësive që heq njeriu kur ka, për shembull, probleme me frymëmarrjen, kur nuk arrin të përdorë në mënyrë të shëndetshme pesë shqisat apo kur vuan. Një person që ka probleme me shëndetin, meqenëse i cenohet paqja e tij e brendshme, së pari orientohet drejt rregullimit të shëndetit të tij. Një person që ndodhet në këtë gjendje nuk mund të mendojë të tjerët, përjeton probleme sa i përket pjesëmarrjes në jetën shoqërore, po ashtu edhe në marrëdhëniet ndërnjerëzore.



#### Le të mendojmë

- Shëndeti nuk nënkupton vetëm faktin që njeriu të mos ketë sëmundje. Në një kuptim më të gjerë, ai nënkupton gjendjen e mirë fizike, shpirtërore e shoqërore të individit.
- E drejta e shëndetit ose e drejta e jetesës në mënyrë të shëndetshme është një e drejtë që Islami e parashikon në mbrojtjen e shëndetit.
- Nëse nuk mundësohet apo nuk arrihet të mundësohet jetesa e shëndetshme, në asnjë rast nuk mund të flitet për të drejta njerëzore.
- E drejta e shëndetit është një e drejtë që vjen nga lindja, që buron nga të qenit njeri. Ajo nuk lidhet as me racën, as me përkatësinë fetare, politike apo sociale të individëve.

Njeriu i shëndetshëm mendon në formë të shëndetshme, merr vendime dhe formon marrëdhënie të shëndetshme. Prandaj, edhe feja islame ka urdhëruar që të mbrohet shëndeti, ka ndaluar çdo vepër dhe sjellje që e dëmton shëndetin. Kur'ani, kur urdhëron: "Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit" (*Bakara, 2/195*), krahas urdhëresës për të kryer mirësi në rrugën e Allahut, nënkupton edhe shmangien nga çdo lloj qëndrimi dhe sjellje që vë në rrezik jetën dhe shëndetin tonë. Edhe Hz. Pejgamberi (s.a.s.), duke urdhëruar: "Në Islam nuk ekziston kryerja e dëmit apo hakmarrja me dëm ndaj dëmit të shkaktuar" (*Ibn Maxhe, Ahkam, 17*), ka bërë të ditur, parimisht, se njeriu nuk duhet të dëmtojë as veten, as të tjerët.

Islami urdhëron që individi dhe shoqëria të jenë të vetëdijshme në çështjen e shëndetit; që drejtuesit e një shteti të mundësojnë çdo lloj shërbimi shëndetësor pa bërë asnjë dallim dhe të marrin masat parandaluese kundrejt çdo kriteri që dëmton shëndetin. Si rrjedhojë, është detyrë e shtetit që të mundësojë shëndetin fizik dhe shpirtëror të të



gjithëve, të pasur apo të varfër, të sigurojë mundësinë e përkujdesjes mjekësore dhe të parandalojë çdo lloj sulmi kundrejt të drejtës së shëndetit.

Njerëzit e shëndetshëm shtojnë produktivitetin, afrimitetin dhe dashurinë në shoqëri. Ndërsa një situatë krejt e kundërt nga kjo shkakton humbje të shëndetit, prishje të marrëdhënieve dhe mungesë lumturie, pra, dëshpërim. Njerëzit, me qëllim që të jenë të shëndetshëm, duhet t'u kushtojnë rëndësi shërbimeve për mbrojtjen e shëndetit. Shërbimet e mbrojtjes së shëndetit në disa situata janë veprime që njeriu nuk duhet t'i realizojë individualisht, por në grup. Këto aktivitete të realizuara në grup do të ndihmojnë në krijimin e afrimitetit me njëri-tjetrin në shoqëri dhe në bashkëpunimin e tyre për kryerjen e punëve, si rrjedhojë, edhe për funksionimin e paqes sociale. Përveç kësaj, që të funksionojë e drejta e shëndetit, është e nevojshme të vëmë në funksion institucionet e sigurisë shoqërore.



## E drejta e arsimit



Individi i zhvillon aftësitë me të cilat lind në saje të arsimit. Perceptimi i plotë i jetës nga njeriu është i mundur vetëm me një aktivitet arsimor që do të zgjasë gjatë gjithë jetës. Arsimi, duke i pajisur njerëzit me informacion të drejtë, duhet të jetë i tillë që të bëhet barrierë e çdo përpjekjeje për të marrë mendjet peng

66



### Le të mendojmë

- Arsimi mund të përkufizohet në mënyrë të përgjithshme si çdo lloj aktiviteti që çon në zhvillimin e dinjitetit dhe të nderit të njeriut, forcimit të respektit ndaj të drejtave njerëzore dhe lirive themelore.
- Në mënyrë të veçantë, duke marrë për bazë të gjitha aftësitë që mundësojnë formimin e njeriut, arsimi nënkupton orientimin e tij, përgatitjen drejt së ardhmes, mësimin se si do të fitohet dija.

Islami e pranon si të drejtë njerëzore zhvillimin e njeriut në aspektin material dhe shoqëror, si dhe përcjelljen e mendimeve dhe të ideve të tjerët.

E drejta e arsimit mund të pranohet si e drejta e mësimnxënies dhe mësimdhënies në pikëpamje të funksionalizmit të tyre. Në të vërtetë, e drejta e arsimit mund të pranohet si një detyrë fetare. Nëse kujtojmë se urdhri i parë i Kur'anit është në trajtën "lexo", mund të kuptojmë se sa shumë nxitet shtimi i mësimin, i dijes dhe mirësjelljes në Islam. Njeriu mund ta dallojë të mirën nga e keqja dhe të drejtën nga e gabuara vetëm duke lexuar dhe duke mësuar. Dija është mjeti që çon në rrugën e drejtë dhe e cila udhëzon veprat në këtë botë dhe në botën tjetër. Në Kur'anin e Madhërueshëm gjenden mjaft ajete që nxisin leximin dhe mësimin:



“... Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...”  
(*Fatir, 35/28*)

“Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm të mençurit i pranojnë këshillat!” (*Zumer, 39/9*)

Islami, i cili i kushton mjaft rëndësi dijes dhe mësimnxënies, kërkon t’u mësojmë patjetër të tjerëve atë që kemi mësuar vetë. Individët që nuk ua mësojnë të tjerëve dijen që kanë nxënë, por e mbajnë atë për vete, janë qortuar. Sepse këta persona e fshehin dijen që u ka dhënë Allahu dhe nuk e paraqesin atë në dobi të të tjerëve. Edhe Hz. Pejgamberi urdhëron kështu: “Kushdo që fsheh diçka që di, kur e pyesin për të, në ditën e kiametit Allahu e godet atë person me një kamxhik prej zjarri.” (*Tirmidhi, Ilim, 3*)



#### Le të mendojmë

Theksi i veçantë që Islami vë mbi të drejtën e arsimit, si shtesë e të drejtës së jetesës, është e rëndësishme qoftë në mbështetjen e zhvillimit individual, ashtu edhe në orientimin e të ardhmes së shoqërisë.

Sepse në Kur’an, urdhëresa në trajtën: “Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.” (*Al-i Imran, 3/110*), mund të arrihet vetëm nëpërmjet përhapjes së arsimit dhe me lartësimin e nivelit arsimor.

## 4

### E drejta e besimit dhe e adhurimit



Islami, duke qenë në vetvete një mendim i vërtetë dhe një liri besimi, kërkon që të jemi tolerantë në çështjet e besimit dhe të respektojmë të drejtën e besimit dhe të adhurimit. Islami e ndalon shtrëngimin dhe detyrimin. Allahu i ka lënë të lirë njerëzit në çështjen e besimit. Ajeti “... Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë.” (*Kehf, 18/29*) është shprehje e lirisë. Është ndaluar shtrëngimi i njerëzve për të hyrë në fe (Islam). Ajeti “S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka” (*Bakara, 2/256*), jo vetëm që nuk lejon të bëhet presion mbi njerëzit sa i përket besimit, por njëkohësisht shpreh se në fe nuk ekziston shtrëngim dhe detyrim në asnjë çështje.

Feja jonë nuk ka ndaluar disa lloje të caktuar të detyrimit, por vetë detyrimin. Si rrjedhojë, presioni në fe është një qëndrim që bie në kundërshtim me Islamin.

Sa i përket kësaj çështjeje, në fe tregohet si shembull jeta e Hz. Pejgamberit. Edhe Allahu urdhëron kështu: “Sikur të donte Allahu, ata nuk do të ishin idhujtarë. Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre e as që je përgjegjës për ta.” (*En’am, 6/107*) Allahu kërkon që njerëzit të mos besojnë si rezultat i disa shtysave dhe shtrëngimeve, por si rezultat i dëshirës dhe kërkesës së tyre.

Besimi, në të cilin do të gjykojen njerëzit, është vetëm besimi që njeriu zgjedh me vullnetin e lirë. Njeriu është i lirë të shprehë dua dhe të kryejë adhurime sipas zgjedhjes së besimit që dëshiron dhe domosdoshmërisë së besimit të tij.

## 5

### E drejta e jetës private

Jeta që dikush dëshiron të mos e shohin, dëgjojnë dhe dinë të tjerët, pra që e mban të fshehtë, quhet jetë private. Hyrja e të tjerëve në këtë pjesë, mësimi i sekreteve të tij dhe përcjellja e këtyre sekreteve te të tjerët, nënkupton cenimin e të drejtave të personalitetit. Jeta private e dikujt nuk duhet të kuptohet si diçka që nuk duhet ta dijë dikush tjetër përveç tij. Kjo sepse njeriu mund t’ia thotë sekretet e tij dikujt tjetër, me të cilin ndien afërsi. Kjo situatë nuk nënkupton faktin se këto kritere janë pjesë e jetës private dhe nuk jep të drejtën që të tjerët ta dinë këtë. Një person, të cilit i janë shpjeguar sekretet që lidhen me jetën private, nëse nuk i mban të fshehta këto sekrete, por ua përcjell të tjerëve, kjo do të thotë se ka ndërhyrë dhe ka cenuar të drejtat personale të të zotit të sekretit. Mbrojtja e jetës private në Islam është bërë e mundur me anë të disa parimeve. E thënë ndryshe, për sa kohë respektohen këta parime, do të jetë ruajtur edhe jeta private, njerëzit nuk do të tentojnë të cenojnë jetën private të të tjerëve, madje nuk do të gjejnë as mundësi për ta bërë këtë. Si rrjedhojë, këto parime nuk kërkojnë drejtpërdrejt moscenimin e jetës private, por në përgjithësi faktin e të genit i respektueshëm ndaj të drejtave njerëzore.

Përndjekja e jetës private të të tjerëve dhe hetimi i mangësive të tyre, në Kur’an dhe hadithe është quajtur si “texhessus”. Ky qëndrim është pranuar si njëra prej të këqijave morale më të rëndësishme. Ajeti që ndalon “texhesusin” në mbrojtjen e jetës private në veçanti, përbën dispozitën kryesore në mbrojtjen e të gjitha gjendjeve dhe situatave të jetës private.





“O ju që keni besuar! Mënjaroni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin...”  
(Huxhurat, 49/12)

Texhessus do të thotë të qenit e dikujt kureshtar për diçka që i përket dikujt tjetër dhe ndërmarrjen e veprimeve për ta mësuar këtë. Një sjellje e tillë, me formën më të thjeshtë dhe më të pasqyruar shihet në përpjekjen për të mësuar të dhënat që lidhen me jetën personale. Në këtë kuptim, jo vetëm situatat e fshehta dhe private, por edhe të hetosh mbi rrethana që nuk janë të turpshme, përfshihen te çështja e texhessusit. Për shembull, të qenit kureshtar për të ardhurat financiare të dikujt dhe për këtë arsye të zbulosh llogarinë e tij bankare, kjo konsiderohet si texhessus dhe është e ndaluar. Po ashtu, edhe të lexosh pa leje ditarin e dikujt bën pjesë te texhesussi.

Në Islam, krahas ruajtjes së jetës private të të tjerëve, gjenden edhe urdhëresa që nuk ofrojnë mundësinë e cenimit të saj. Ajeti: “O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banorët e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshta do t’ia vini veshin!” (Nur, 24/27) e ka ndaluar hyrjen në shtëpi pa pasur lejen e të zotëve të shtëpisë. Ky kriter, që shërben për mbrojtjen e jetës private, në fakt duhet të mendohet si respekt ndaj të drejtave personale.

Nga ana tjetër, Islami urdhëron që dikush, i cili mëson jetën private të dikujt tjetri, rastësisht apo në ndonjë mënyrë tjetër, të mos e tregojë këtë, por ta fshehtë.



“Kushdo që në këtë botë fsheh një gjendje të muslimanit, edhe Allahu fsheh në ahiret gjendjen e tij (e fal atë); kushdo që nxjerr në pah mangësinë e vëllait të tij musliman në këtë botë, edhe Allahu i nxjerr në ahiret gjendjen e tij të fshehtë.” (Ibn Maxhe, Hudud, 5)

Në rrethana të veçanta, Islami ka edhe kufizime sa i përket mbrojtjes së jetës private. Për shembull, nuk konsiderohen si një ndërhyrje ose “cenim” i jetës private nëse nuk marrim leje të futemi në shtëpinë e dikujt, jeta e të cilit është në rrezik për shkak të zjarrit, përmbytjes, vjedhjes etj. Brenda kufijve ligjorë, për shkak të profesionit të tyre, avokatët, noterët, doktorët etj., mund të mësojnë të dhëna që lidhen me jetën private të të tjerëve. Por, këto persona janë të detyruar t’i mbajnë të fshehta të dhënat e mësuara dhe të mos i tregojnë ato.



## Të drejtat ekonomike (e drejta e pronësisë)



Të drejtat ekonomike janë përgjithësisht të drejta që lidhen me prodhimin, zotërimin e asaj që është prodhuar, shkëmbimin dhe konsumimin. Feja islame e ka lënë të lirë prodhimin dhe konsumimin e një lënde që është e lejuar. Të gjithë duhet të kenë të drejtën e punësimit dhe të prodhimit, pa hasur në vështirësi. Madje, shteti duhet të hapë vende pune, të ofrojë mundësi e të ndihmojë ata që merren me prodhime të ndryshme.

Njerëzit janë të detyruar të punojnë për të siguruar jetesën e tyre. Prandaj, të gjithë zotërojnë të drejtën dhe lirinë e punës. Allahu i Lartmadhëruar urdhëron kështu: "Njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar." (*Nexhm, 53/39*) Sa i përket punës dhe fitimeve prej saj, nuk bëhen diferenca gjinore. Po ashtu, duhet të ruhet patjetër munda i atyre që punojnë. Jeta e punës në Islam është nën sigurinë e ligjeve të formuara nën dritën e parimeve morale. Kur'ani dhe hadithet fisnike e kanë nxitur shpërblimin ndaj atij që punon dhe kanë kërkuar që kjo e drejtë të merret nën mbrojtje. Për shembull, në kuptimin e sotëm ekziston e drejta e formimit të sindikatave për të mbrojtur dhe zhvilluar interesat ekonomike dhe sociale të individëve, si dhe e drejta e pjesëmarrjes në institucionet e sigurisë shoqërore. Krahas kësaj, feja jonë ka urdhëruar që personat, të cilët nuk arrijnë të punojnë ose personat e papunë, të mbështeten nëpërmjet institucioneve të sigurimit shoqëror.

Në Islam, krahas të drejtës së punës, me kusht që të mos kalohet në përdorim pa kriter, është njohur edhe e drejta e pronësisë. Në kuadër të urdhëresave të Allahut, me kusht që të mos i tejkalojë kufijtë e caktuar prej Tij, në mjaft ajete është njohur e drejta e zotërimit të pronës private. Të gjithë duhet të prodhojnë në mënyrë të ligjshme dhe mallrat e fituar duhet t'i harxhojnë në mënyrë të ligjshme. "... O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë." (*A'raf, 7/31*)

Islami mund t'i kufizojë të drejtat ekonomike në përputhje me ligjin. Për shembull, prona private mund të kufizohet pa e dëmtuar individin, kur bëhet fjalë për dobinë dhe interesin publik. Të cenosh pasurinë e dikujt tjetër duke pretenduar se po përfiton të drejtën, nuk është konsideruar si veprim i pëlqyeshëm në Islam.



## Përmbledhja e kapitullit



Në literaturën islame, koncepti i “së drejtës”, i cili nënkupton çdo lloj mirësie që zotëron njeriu, shpreh “të drejtat e fituara” që nga lindja dhe ato që fitohen më pas. Në gjuhën juridike, të drejtat themelore të përkufizuara si “të drejtat njerëzore”, janë çështje e disa dispozitave, të cilat i thekson edhe Kur’ani e sunneti.

Sipas Islamit, të drejtat themelore janë vlera që burojnë nga të qenit njeri dhe që mbrojnë në çdo kusht nderin e njeriut. Po sipas Islamit, në themel të të gjitha të drejtave ndodhet e drejta e jetesës.

Sipas kësaj, e drejta e jetesës së të gjithë njerëzve, pasuria dhe nderi i tyre, ia vlen të respektohet dhe është e paprekshme. Paprekshmëritë nuk mund të shfuqizohen pa pasur një shkak të ligjshëm, ose pa pasur një urdhëresë legjitime. Renditja e të drejtës së shëndetit pas të drejtës së jetesës në radhën e të drejtave themelore ka domethënie të veçantë. Sepse njerëzit e shëndetshëm mund të formojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe Islami ka urdhëruar mbrojtjen e shëndetit, si dhe ka ndaluar punët dhe sjelljet që dëmtojnë shëndetin.

Islami e sheh si të drejtë arsimore faktin që njeriu të zhvillojë veten qoftë në aspektin material, qoftë në atë shpirtëror dhe t’ua përcjellë të tjerëve mendimet dhe idetë e tij. Si shtesë e të drejtës së jetesës, fakti që Islami e thekson në mënyrë të veçantë të drejtën mbi arsimin, qoftë sa i përket mbështetjes së një individi, qoftë orientimit të së ardhmes së shoqërisë, është diçka e rëndësishme.

Duke qenë se vetë Islami është një liri e vërtetë mendimi dhe besimi, ai mbron të drejtën e besimit dhe të adhurimit. Prandaj, për çfarëdo lloj çështjeje që të bëhet fjalë, Islami ndalon çdo mënyrë shtrëngimi. Feja jonë, e cila e pranon njeriun si një qenie të respektuar dhe të nderuar, merr nën mbrojtje jetën private të individit. Po ashtu, me qëllim që njeriu të ketë një jetesë komode dhe të qetë, Islami merr nën garanci të drejtat ekonomike dhe të drejtën e pasurisë.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Përse e drejta e jetesës është e drejta më themelore?
2. Çfarë përfshin e drejta e shëndetit?
3. Ç’është e drejta e arsimit dhe përse është e nevojshme?
4. Përse është e nevojshme ruajtja e jetës private?
5. Cilat janë të drejtat ekonomike? Ilustrojeni me shembuj.





## Pyetje vlerësuese



### 1. Cila nga fjalitë e mëposhtme nuk ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtës së jetesës dhe me respektimin e saj?

- A) Vijimi i ekzistencës së njeriut si i tillë është i mundur me plotësimin e të gjitha aktiviteteve të tij jetësore.
- B) Ata që nuk zotërojnë të drejtën e jetesës, si e drejta më natyrore, nuk kanë as përgjegjësi dhe as detyra.
- C) Një person që nuk zotëron të drejtën e jetesës nuk mund të zotërojë as të drejtat e tjera.
- D) E drejta e jetesës i mundëson njeriut çdo lloj lirie.

### 2. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ka të bëjë me të drejtën e shëndetit?

- A) Të sillesh me trupin ashtu siç dëshiron.
- B) Të përfitosh nga shërbimet mjekësore.
- C) Të mund të zgjedhësh një mjek.
- D) Të mbrosh shëndetin shpirtëror.

### 3. Cila nga alternativat e mëposhtme është e drejta që shpreh çdo lloj veprimi kundrejt zhvillimit të plotë të personalitetit dhe nderit të njeriut dhe kundrejt forcimit të respektit ndaj të drejtave të njeriut dhe lirive themelore?

- A) E drejta e jetës private.
- B) E drejta e arsimit.
- C) Të drejtat ekonomike.
- D) E drejta e komunikimit.

### 4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk shërben si burim i të drejtës së besimit dhe adhurimit?

- A) Allahu kërkon që njerëzit të mos besojnë për shkak të disa shtrëngimeve dhe detyrimeve, por për shkak të dëshirës dhe kërkesës së tij.
- B) Një besim, në të cilin njeriu do të merret nën llogari, është veçse besimi që njeriu e zgjedh me vullnetin e lirë.
- C) Duhet t'i detyrojmë njerëzit të besojnë në një fe të vetme, duke i shtrënguar dhe detyruar.
- D) Vullneti hyjnor nuk kërkon që dikush të shtrëngohet a detyrohet sa i përket çështjes së besimit a adhurimit.

**5. Cila nga alternativat e mëposhtme shpreh kuptimin e konceptit "texhessus"?**

- A) Të ndihmohet të tjerët.
- B) Të ndjekësh jetën private të të tjerëve dhe të zbulosh gabimet e tyre.
- C) Të bësh thashetheme.
- D) Të shpërndash pasurinë sa në një anë në një tjetër.



morali im  
morali im



Kapitulli

5





# Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj Allahut
2. Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Pejgamberit tonë
3. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj vetes
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes ndaj njëri-tjetrit
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e fëmijëve ndaj prindërve
6. Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit
7. Detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve ndaj fëmijëve
8. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj të rriturve të familjes
9. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj të afërmve, fqinjëve dhe shoqërisë
10. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj shoqërisë sonë
11. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj shtetit
12. Përgjegjësitë tona profesionale
13. Rregullat e mirësjelljes



## RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull jepen të dhëna në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë tona individuale dhe shoqërore. Vendoset theksi mbi aspektet fetare dhe morale të konceptit të përgjegjësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj Allahut, Pejgamberit dhe vetes, janë individuale. T'i besosh Allahut, t'i bësh robërim atij dhe t'i bindesh Pejgamberit është detyra themelore e çdo besimtarit. Njeriu është përgjegjës për përballimin e nevojave trupore dhe shpirtërore, të tilla si: të mbrosh jetën e njeriut, të hash, të pish, të strehohesh, të mendosh dhe të besosh. Njeriu ka detyra dhe përgjegjësi shoqërore.

Ndërkohë që trajtohet tema e detyrave dhe e përgjegjësive të fëmijëve ndaj prindërve, e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit, e prindërve ndaj fëmijëve, e fëmijëve ndaj të rriturve të familjes, aludohet edhe mbi rregullat morale që duhet të respektohen në marrëdhëniet e pjesëtarëve të familjes me njëri-tjetrin. Njeriu është një qenie shoqërore. Jemi të detyruar t'i realizojmë marrëdhëniet shoqërore në mënyrë të shëndetshme, të ekuilibruar dhe pozitive. Për këtë arsye, duhet të plotësojmë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj të afërmve, fqinjëve, shoqërisë, atyre që na rrethojnë dhe shtetit tonë. Njëra prej detyrave tona shoqërore është realizimi i përgjegjësive profesionale, duke e kryer punën që bëjmë në formën më të bukur. Në formimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore sa më pozitivisht, nuk duhet të harrojmë të respektojmë rregullat e mirësjelljes që janë përvetësuar dhe vendosur në shoqëri.

## SYNIMET E KAPITULLIT

Pas mësimi të këtij kapitulli pritet që të zotëroni informacionet e mëposhtme:

1. Të thoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tona individuale dhe shoqërore.
2. Të perceptoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Allahut dhe Pejgamberit tonë.
3. Të jeni të vetëdijshëm kundrejt detyrave dhe përgjegjësive ndaj vetes.
4. Të kuptoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes ndaj njëri-tjetrit.
5. Të thoni detyrat dhe përgjegjësitë e fëmijëve ndaj prindërve.
6. Të mësoni detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve ndaj fëmijëve.
7. Të perceptoni rëndësinë e plotësimit të detyrave dhe të përgjegjësive të bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit.
8. Të radhisni detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të rriturve të familjes.
9. Të kuptoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të afërmve, fqinjëve dhe shoqërisë.
10. Të thoni se cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj rrethit shoqëror.
11. Të jeni në dijeni të detyrave dhe përgjegjësive ndaj shtetit.
12. Të perceptoni rëndësinë e plotësimit të përgjegjësive profesionale.
13. Të radhisni rregullat e mirësjelljes.

## NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Së pari lexoni tekstin mësimor dhe mundohuni ta kuptoni.
2. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
3. Realizojini patjetër veprimet analitike që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
4. Studioni veprat, informacionet e të cilave mund t'i siguron nga literatura në fund të librit.

## 1

## Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj Allahut



Njeriu është i ngarkuar me besimin ndaj Allahut dhe me robërimin ndaj Tij. Përgjegjësia e parë dhe themelore e njeriut të mençur është besimi ndaj Allahut, si i vetmi i denjë për adhurim dhe lëvdim. Allahu është Krijues, ndërsa njeriu është ai që ka detyra dhe përgjegjësi ndaj Krijuesit. Është Allahu ai që e bën njeriun si qenien më të përzgjedhur, që e mban në jetë atë, që i jep çdo mirësi që zotëron dhe që do ta ringjallë sërish atë. Me këtë besim, njeriu e do Allahun, ndien respekt për të, e falënderon, respekton urdhëresat e tij, shmanget nga gjërat e ndaluara.

Kur'ani, qëllimin themelor të krijimit të njeriut e përcakton si njohjen e ekzistencës së Allahut, t'i besosh atij dhe t'i bësh robërim vetëm Atij (*Dharijat, 51/56*). Respekti i thellë dhe i ndierë ndaj Allahut e forcon marrëdhënien njeri-Allah dhe e lartëson njeriun:



*"Sikur ata të besonin dhe të ruheshin (nga gjynahet), shpërblimi i Allahut do të ishte më i mirë. Ah, sikur ta dinin ata!" (Bakara, 2/103)*

Njeriu i plotëson detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Allahut duke bërë robërim ndaj Tij:



*"... O bijtë e Allahut! Të më adhuroni vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë..." (Jasin, 36/61)*

Kur'ani e udhëzon njeriun sa u përket detyrave dhe përgjegjësive ndaj Allahut. Duke ndjekur këtë rrugë, njeriu arrin në shpëtim dhe lumturi. Njeriu duhet të dijë se vetë ai është gjithmonë në një pozitë që merr, që përfiton, ndërsa Allahu që jep, dhe kurrë nuk duhet ta harrojë përgjegjësinë përballë tij. Ata që janë të ndjeshëm kundrejt detyrave dhe përgjegjësive, tregojnë të njëjtën ndjeshmëri në marrëdhëniet me njerëzit dhe me qeniet në të gjithë universin.

Njeriu është ai që i shkel rregullat në marrëdhënien njeri-Allah dhe që gabon vazhdimisht, ndërsa Allahu është falës. Njeriu nuk duhet të këmbëngulë në gabimin e tij. Kur'ani këshillon që njeriu, sado i gabueshëm që të jetë, duhet të kërkojë falje nga Allahu dhe kurrë të mos e humbë shpresën. Nëse robi orientohet ndaj Allahut, pendohet nga zemra, kërkon falje, edhe Allahu nuk e kthen atë duarbosh:



*"Kush kryen vepra të këqija ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të shohë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë." (Nisa, 4/110)*



Duaja në marrëdhënien njeri-Allah zë një vend shumë të rëndësishëm. Duaja e mban gjithmonë të gjallë marrëdhënien mes njeriut e Allahut dhe kontaktin ndërmjet tyre. Duaja është kundrejt faljes dhe mëshirës së Allahut, është kërkimi i Allahut për ndihmë. Ja si paraqitet gjendja e robit ndaj Allahut, përgjërimi dhe mbështetja ndaj tij:



*“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, thuaju se Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.” (Bakara, 2/186)*

## 2

### Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Pejgamberit tonë

Ai që na shpalli fenë dhe librin tonë të lartë, që na e shpjegoi dhe që na e mësoi, është Pejgamberi ynë. Kur’ani bën të ditur se, për të qenë një njeri i mirë, duhet të ndjekim udhën e tij dhe të marrim si shembull moralin e tij (*Ahzab, 33/21; Kalem, 68/4*). Sepse morali i tij është Kur’ani (*Muslim, Musafirin, 139*). Ai është udhërrëfyesi që u tregon njerëzve udhën e drejtë, që jep sihariq, që është paralajmërues dhe ndriçues (*shihni Shura, 42/52; Ahzab, 33/45-46*). Në Kur’an, Allahu u ngarkon besimtarëve si detyrë që t’i binden Hz. Muhammedit (s.a.s.), t’i përshtaten atij:



*“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjane, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.” (Nisa, 4/80)*

Prandaj, të duash Pejgamberin, të ndiesh respekt për të dhe t’i bindesh atij, është detyra dhe përgjegjësia jonë më e vyer.

Me qëllim që të mësojmë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj Pejgamberit, duhet të njohim jetën e tij në të gjitha aspektet. Sahabet e kanë ndjekur me përkushtim jetën e tij, e kanë marrë shembull dhe e kanë përcjellë në brezat e mëpastajmë.

Hz. Muhammedi (s.a.s.) është një person i drejtë, i besueshëm, i mëshirshëm, i guximshëm, durimtar, delikat dhe tolerant. Mbante fjalën e dhënë, cilësonte si të lartë të drejtën dhe të drejtin. Ai u jepte vlerë njerëzve, ishte buzagaz me ta, përsëndetej me ta, pyeste për shëndetin e tyre. Ai e vlerësonte mirë kohën, e planifikonte mirë atë dhe nuk e vononte asnjë punë. Ai donte të punonte duke u konsultuar, merrte pikëpamjet e specialistëve të fushës dhe i vlerësonte ata. Detyra dhe përgjegjësia jonë ndaj Pejgamberit nxjerr në pah sjelljet e përshtatshme të fesë së lartë që ai ka sjellë.



### Është radha juaj

Kur përmendet emri i Pejgamberit, me cilat fjalë shprehet respekti dhe dashuria ndaj tij?

Gjithmonë e përmendim emrin e Pejgamberit me dashuri dhe respekt, e tregojmë vartësinë ndaj tij me fjalë dhe me sjellje. Të tregojmë dashuri dhe respekt ndaj Pejgamberit është detyra jonë, gjë që Allahu e bën të ditur kështu në Kur'an:



*"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin, dhe melekët e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me "selam!" (Ahzab, 33/56)*

*"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin." (Ahzab, 33/6)*

Edhe Pejgamberi ynë e shpreh kështu lidhjen e afritetit dhe të dashurisë që duhet të kenë njerëzit me të:



*"Për sa kohë nuk më konsideroni mua më të afërt se babanë tuaj, fëmijët tuaj dhe se gjithë njerëzimi, asnjëri prej jush nuk konsiderohet se është besimtar i vërtetë."*

*(Buhari, Iman, 8)*

## 3

### Detyra dhe përgjegjësitë tona ndaj vetes

Njeriu ka detyra dhe përgjegjësi ndaj vetes. Mbrojtja fizike dhe shpirtërore e qenies renditet ndër më kryesoret. Në mënyrë që njeriu të plotësojë detyrat dhe përgjegjësitë fetare e botërore, duhet të jetë i shëndetshëm dhe të mbrojë jetën. Trupi dhe shëndeti i njeriut është një amanet i dhënë nga Allahu. Pejgamberi ynë ka bërë të ditur se në ahiret, njeriu do të hetohet fillimisht mbi faktin se ku e ka konsumuar trupin dhe ku e ka harxhuar jetën (*Shihni Tirmidhi, Kijame, 1*). Mbrojtja me përkushtim e këtij amaneti është detyra themelore e njeriut. Feja jonë nuk i ka njohur askujt të drejtën e dhënies fund të jetës.



### Le të mendojmë

Përse mbrojtja e shëndetit është një përgjegjësi themelore?

Feja islame ka urdhëruar edhe moskryerjen e të këqijave që dëmtojnë shëndetin e njeriut, të tilla si pirja e alkoolit, kumari dhe prostitucioni. Kur'ani e paralajmëron kështu

këtë situatë: "Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit" (*Bakara, 2/195*), në mënyrë që të përfshihen të gjitha sjelljet e këqija. Pejgamberi ynë nuk e ka miratuar këtë sjellje të një sahabiu, që ia ka kushtuar vetes adhurimin, aq sa ka neglizhuar shëndetin e tij dhe e ka paralajmëruar: "Edhe trupi ka të drejtë tek ti" (*Buhari, Saum, 55*) Shëndeti fizik, aq sa është individual, është i nevojshëm edhe për detyrat dhe përgjegjësitë shoqërore. Pejgamberi ynë, me fjalët: "Besimtari i vërtetë është më i hairit se besimtari i dobët" (*Muslim, Kader, 34*), ka aluduar mbi rëndësinë e forcës materiale dhe shpirtërore në plotësimin ashtu siç duhet të detyrave shoqërore.

Njeriu ka detyra dhe përgjegjësi edhe në lidhje me ekzistencën e tij shpirtërore dhe çështjeve të zemrës. Ajo që e bën të lartë njeriun në univers në krahasim me gjallesat e tjera, janë cilësi të tilla si mendja, zgjuarsia, mendimi, besimi, ndjenja estetike, si dhe dëshira për të kryer mirësi. Edhe mbrojtja e zhvillimi i veçorive shpirtërore është detyrë dhe përgjegjësi e tij ndaj vetë qenies. Njeriu, aftësitë e tij të larta që e bëjnë të privilegjuar dhe të përzgjedhur duhet t'i bëjë efektive dhe produktive në rrugën e mirësisë. Për të qenë një njeri i pjekur dhe i virtytshëm, duhet të punojë dhe të zhvillojë veten.

## 4

### Detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes ndaj njëri-tjetrit

80

Familja është pjesa themelore e strukturës shoqërore. Aq sa do të jetë e fortë struktura familjare, po kaq e shëndetshme dhe e fuqishme do të jetë edhe shoqëria. Njeriu, si domosdoshmëri e krijimtarisë mund të jetë i lumtur brenda një mjedisi familjar. Për këtë arsye, njerëzit, kur vjen koha, martohen dhe formojnë familje. Feja jonë i nxit njerëzit që të martohen dhe të formojnë një fole familjare (*shih Nur, 24/32*). Të krijosh, në mënyrë të fuqishme, një institucion kaq të rëndësishëm shoqëror, ta zhvillosh atë, lind domosdoshmërinë e ndarjes së punëve brenda familjes. Pjesëtarët e familjes kanë detyra dhe përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit. Në mënyrë që familja të vijojë të jetë e shëndetshme, duhet që pjesëtarët e familjes të realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë me dashuri, respekt dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit.

### Detyrat dhe përgjegjësitë e fëmijëve ndaj prindërve

Fëmijët kanë detyra dhe përgjegjësi ndaj prindërve. Ata janë mjet për ardhjen e fëmijëve në jetë, që i ushqejnë, i rrisin, i edukojnë dhe që mundohen t'i bëjnë njerëz të mirë. Feja jonë, menjëherë pas detyrës së robërimit ndaj Allahut, thekson faktin se të genit i respektuar ndaj prindërve dhe sjellja e mirë është një detyrë ndaj Allahut (*shih En'am, 6/151-153; Isra, 17/22-37*). Pejgamberi ynë, kryerjen e mirësive ndaj prindërve e konsideron ndër sjelljet më të bukura që Allahu i sheh të vyera, ndërsa rebelimin ndaj tyre e konsideron ndër gjynahet më të mëdha (*shih Buhari, Edeb, 1*).

Detyrat kryesore të fëmijëve ndaj prindërve mund t'i radhisim kështu: të mundohen të përballojnë nevojat e tyre materiale dhe shpirtërore; të mundësojnë një mjedis jetese ku prindërit të jenë të kënaqur dhe të qetë; t'i paralajmërojnë pa lënduar në situatat ku duhet të paralajmërojnë; të shmangen nga sjelljet që cenojnë respektin kundrejt



të tjerëve; të plotësojnë kërkesën e prindërve në çështjet që nuk janë të ndaluara; t'i ndihmohet ata në realizimin e veprave të mira dhe të adhurimeve; të bëjnë dua për ta kur janë në gjallë dhe pasi të vdesin; të plotësojnë testamentin e tyre pasi të kenë vdekur dhe të bëjnë mirësi e vepra të mira në emër të tyre; të bëjnë atë që nevojitet në çdo çështje që feja dhe tradita e sheh të nevojshme ose të bukur.



### Le të mendojmë

Çfarë detyrash dhe përgjegjësish të tjera mund të kenë fëmijët kundrejt prindërve? Diskutoni me shokët tuaj.

## Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit

Në kuadër të ndarjes së punëve sipas strukturës familjare, bashkëshortët duhet të realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë që kanë ndaj njëri-tjetrit. Në mënyrë që marrëdhëniet mes bashkëshortëve të jenë të mira dhe të shëndetshme, kjo lidhet, së pari, me faktin që dashuria, respekti dhe besimi i ndërsjellë të jenë të konsoliduara. Bashkëshortët duhet të jenë mbështetës ndaj njëri-tjetrit, ta ndihmojnë njëri-tjetrin, t'i përballojnë bashkë nevojat dhe t'i zgjidhin po bashkë problemet.

Shembulli më i bukur në çështjen e detyrave dhe përgjegjësive të bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit është jetesa familjare e Pejgamberit. Ai kurrë nuk ka qenë lëndues dhe ofendues ndaj bashkëshorteve të tij. Është sjellë me mjaft delikatesë dhe butësi ndaj tyre dhe ka urdhëruar kështu: "Më i hairit ndër ju është ai që është më i miri ndaj familjes së tij." (*Buhari, Edeb, 86*). Në Kur'an gjendet kjo këshillë dhe propozim: "Jetoni e silluni mirë me to!" (*Nisa, 4/19*) Sepse marrëdhëniet e bazuara në frikë, presion, kërcënim dhe forcë e shtrëngim, e prishin qetësinë familjare. Cilësi të tilla negative ndikojnë edhe të fëmijët dhe bëhen shkak që ata të rriten jo të qetë dhe me probleme.



### Të flasim bashkërisht

Diskutoni mbi shembujt që tregojnë se si është sjellë Pejgamberi ynë me bashkëshortet e tij.

## Detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve ndaj fëmijëve

Të edukosh fëmijët është një detyrë dhe përgjegjësi e rëndësishme dhe e shenjtë për prindërit. Fëmijët janë burim i madh gëzimi dhe lumturie për familjen. Ushqimi dhe rritja e tyre, edukimi në një formë të mirë, janë detyrat dhe përgjegjësitë më kryesore të prindërve.

Plotësimi i nevojave trupore, të tilla si të ushqyerit, strehimi, veshmbathja dhe mbrojtja e shëndetit, janë detyra kryesore për t'u përballuar. Pejgamberi ynë ka bërë të ditur se ndër ata që njeriu ka harxhuar në rrugën e mirësisë, ai që ka më shumë sevap është ai që ka shpenzuar më shumë ndaj pjesëtarëve të familjes. Ai është shprehur kështu kur e ka cilësuar si shumë të gabuar lënien e pjesëtarëve të familjes në gjendje nevojë:



*"Mjafton si gjynah për një person që të lërë pjesëtarët e familjes në gjendje të mjeruar." (Ebu Davud, Zekat, 45)*

Zhvillimet trupore dhe shpirtërore të fëmijëve duhet të plotësohen bashkërisht. Dashuria dhe dhembshuria ndaj fëmijëve japin kontribute të rëndësishme në të qenit të shëndetshëm të tyre në të dyja aspektet. Pejgamberi ynë ka treguar dashuri, mëshirë dhe dhembshuri ndaj fëmijëve të tij, nipërve dhe të gjithë fëmijëve, i ka mbajtur në gji ata, ka bërë shaka me ta, ka falur gabimet e tyre, madje është bërë pjesë edhe e lojërave të tyre. Ai, dikë që gjykonte afrimitetin e tij me fëmijët, e ka kritikuar duke thënë: "Ç'mund të bëj unë nëse Allahu e ka shkukur mëshirën e dhembshurinë nga zemra jote!" (Buhari, Edeb, 18). Te fëmijët e privuar nga dashuria, nga mëshira dhe nga interesi i prindërve, janë vënë re përshtatjeje dhe tendenca për kryerje faji.

Arsimi dhe edukimi i fëmijës është ndër përgjegjësitë kryesore në familje. Arsimi dhe edukimi fetar, moral dhe profesional i fëmijës, është një detyrë mjaft e rëndësishme dhe e vështirë. Në saje të arsimit dhe edukimit, fëmijët do të edukohen në mënyrë të plotë dhe do të ecin me hapa të fortë e të sigurt drejt së ardhmes. Pejgamberi ynë e ka theksuar me këto fjalë arsimin dhe edukimin e fëmijës:



*"Asnjë baba nuk mund t'i lërë fëmijës një testament më të vyer sesa edukata e bukur." (Taxh, V, 8)*

82



### Le të mendojmë

Çfarë nënkupton fakti, sipas të cilit edukata që i është dhënë fëmijës është testamenti më i vyer?

Për fëmijën, edukata familjare ka një rëndësi të madhe. Edukata e parë që fëmija merr nga familja lë gjurmë të thellë në jetën e tij. Nga fëmijët që janë edukuar në një mjedis të lumtur familjar, janë vënë re sjellje pozitive. Rezultatet e edukimit bëhen më të qarta në periudhën e pjekurisë dhe më pastaj. Për këtë shkak, të qenit prind biologjik duhet të plotësohet edhe me të qenit prind psikologjik dhe edukativ.



### Është radha juaj

Cilat janë dallimet ndërmjet të qenit prind biologjik dhe të qenit prind psikologjik e edukativ?

Prindërit, me sjelljet e tyre, duhet të japin një shembull të bukur ndaj fëmijëve. Ata duhet të zbresin në nivelin e tyre dhe të mundohen t'i kuptojnë ata. Duhet t'u japin mundësinë që ata të luajnë dhe t'i orientojnë drejt lojërave edukative. Duhet të jepen gjithmonë të dhëna të drejta dhe të matura ndaj tyre, duhet të shmangen nga gënjeshtra dhe thënia e gënjeshtrave. Duhet t'i ndihmojnë ata që të dallojnë të mirën nga e keqja dhe të drejtën nga e gabuara. Sepse fëmija, drejtësinë dhe sjelljen e drejtë e mëson në

mjedisin familjar. Fëmija nuk duhet të lejohet të rrijë në mjedise të papërshtatshme me moshën e tij dhe nuk duhet të punojë në punë të tilla.

Prindërit nuk duhet të bëjnë dallim mes fëmijëve. Qofshin vajza, qofshin djem, fëmijët duhen edukuar të gjithë në mënyrën më të mirë. Gjërat materiale dhe shpirtërore që u janë mundësuar atyre, duhet t'i ndajnë sipas parimit të barazisë dhe nuk duhet të mbajnë anën e njërit apo të tjetrit. Këto lloj sjelljesh mund të cenojnë dashurinë, respektin dhe besimin e fëmijëve ndaj prindërve, mund të prishin marrëdhëniet vëllazërore, gjë që bëhet shkak për probleme mes vëllezërve.

## Detyrat dhe përgjegjësitë ndaj të rriturve të familjes



Në familje, krahas detyrave dhe përgjegjësiave ndaj prindërve, kemi detyra e përgjegjësi edhe ndaj të rriturve. Të rriturit e familjes, së pari janë gjyshet, gjyshërit, vëllezërit dhe motrat e mëdha. Edhe xhaxhai, daja, halla dhe tezja janë ndër të rriturit e familjes. Ata janë vëllezërit dhe motrat e nënës dhe të babait tonë, janë në vendin e nënës dhe të babait tonë. Duhet të tregojmë dashuri dhe respekt ndaj tyre, duhet të vijojmë marrëdhëniet me ta, duhet të vrapojmë në ndihmë të tyre kur të kenë nevojë për ne. E njëjta detyrë dhe përgjegjësi është e vlefshme edhe për ata.

Me të rriturit e familjes duhet t'i krijojmë marrëdhëniet në kuadër të dashurisë, respektit dhe tolerancës. Duhet të mundohemi të përfitojmë nga pikëpamjet dhe përvojat e tyre, duhet të marrim parasysh orientimin e tyre ndaj së mirës dhe së bukurës. Kur rritemi dhe krijojmë familje të reja, nuk duhet të harrojmë mirësitë e të rriturve të familjes, të cilët kanë dhënë kontribut të madh në formimin e tyre. Duhet t'i vizitojmë ata me raste të ndryshme, si në raste sëmundjeje dhe t'i mbajmë të gjalla marrëdhëniet. Duhet t'i ndihmojmë dhe t'i mbështesim ata kur kanë nevojë. Kur të vdesin duhet t'i përmendim me mirësi, duhet të vizitojmë varret e tyre. Kjo është përgjegjësia jonë fetare, morale dhe njerëzore. Nuk duhet t'i lëmë të rriturit e familjes të vetmuar dhe të braktisur. Duhet të llogarisim se një ditë edhe ne do të vijmë në të njëjtën pozitë. Nëse e bëjmë këtë, marrëdhëniet me të rriturit e familjes do të vijojnë në mënyrë pozitive dhe do të zhvillohen më tej.





### Pjesë leximi

#### Dashuria dhe respekti i Pejgamberit tonë ndaj të rriturve/më të mëdhenjve

Edhe sjelljet e Pejgamberit tonë ndaj të rriturve janë shembulli më i bukur për ne. Ai i do dhe i respekton shumë të rriturit e familjes, gjë që e tregonte edhe me sjelljet e tij. Gjatë gjithë jetës nuk kishte mundur të harronte nënën, të cilën e pati humbur kur ishte ende në moshë të vogël. Në çdo rast vizitonte varrin e nënës, mallëngjehej dhe qante. Xhaxhai i tij, Ebu Talibi, i kishte bërë mjaft mirësi. Prandaj edhe e donte shumë atë, mendohej ta ndihmonte në çdo punë. Nuk e lëndonte e as nuk e cenonte atë. Përballë këtyre mirësive të Ebu Talibit, edhe ai mori pranë vetes djalin e xhaxhait, Hz. Aliun, kur ky ishte në moshë të vogël. Ndiante dashuri të veçantë ndaj xhaxhallarëve të tij, Abbasit dhe Hamzait. Kur humbi nënën, shërbëtorja e tyre, Ummu Ejmeni, e përqafoi atë me dashurinë e një nëne dhe ia dorëzoi gjyshit të tij. Ai gjatë gjithë jetës nuk e kishte harruar këtë sjellje të përzemërt dhe në çdo vend që e shihte, i drejtohej me fjalën 'nënë'. As nënën e tij të qumështit, Halimenë, nuk e ka lënë pas dore, por e ka respektuar dhe e ka dashur. Kur i erdhi një ditë për vizitë, u ngrit nga vendi duke thënë: "nëna ime, nëna ime e dashur!". Madje, në vendin ku do të ulej ajo, kishte shtruar qilim, i kishte ofruar gosti asaj dhe e kishte përcjellë me dhurata.



### Le të mendojmë

Çfarë detyrash dhe përgjegjësish të tjera kemi ndaj të rriturve të familjes?

84

5

#### Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj të afërmeve, fqinjëve dhe shoqërisë

Ne kemi detyra e përgjegjësi edhe ndaj të afërmeve. Feja jonë i ka kushtuar shumë rëndësi mbajtjes aktive të marrëdhënieve mes të afërmeve. Në kuptimin e përgjithshëm, kemi detyra morale ndaj të afërmeve, të cilët janë pjesë e familjes sonë. Në hadithet e Pejgamberit dhe në literaturën e moralit, duke përmendur afrimitetin dhe marrëdhënien me të afërmit, është vënë theksi mbi nevojën e vijimit të marrëdhënies së të afërmeve.

Në një hadith fisnik është përcaktuar kështu nevoja e marrëdhënies së të afërmeve: "Allahu do të vijojë interesin e tij ndaj robit që vijon marrëdhëniet me të afërmit, ndërsa do të presë interesin ndaj atyre që braktisin të afërmit." (Buhari, Edeb, 13) Pejgamberi ynë e shpreh rëndësinë e farefisnisë në mënyrën: "Më i larti ndër të gjitha virtytet është të krijosh marrëdhënie duke vizituar të afërmin që pret vizitën prej teje." (Musned, III, 438) Përveç kësaj, ka bërë të ditur se vizitat e ndërsjella mes të afërmeve do të shtojnë riskun (Buhari, Edeb, 12), ka bërë të ditur se ai që ndihmon të afërmit do të përfitojë dyfish më shumë sepas krahasuar me përfitimin që vjen si rezultat i ndihmës së të tjerëve (Nesai, Zekat, 82). Madje, në një hadith, ata që ndërpresin marrëdhëniet farefisnore janë renditur ndër ata që nuk do të hyjnë dot në xhennet (Buhari, Edeb, 11).

Të zhvillojmë me dashuri dhe respekt marrëdhëniet farefisnore, të ndihmojmë ata që kanë nevojë, t'u shkojmë për vizitë atyre, të shkëmbejmë dhurata, është një detyrë fetare dhe njerëzore. Edhe fëmijët e xhaxhallarëve, hallave, dajallarëve dhe tezeve

janë si vëllezërit tanë dhe janë të afërmit tanë. Njerëzit më të afërt pas familjes dhe të afërmeve, janë fqinjët që kemi pranë. Njeriu përballet pothuajse çdo ditë me ta, ulet, flet, qëndron bashkë me ta. Marrëdhëniet fqinjësore janë rezultat i të jetuarit bashkërisht. Në mënyrë që kjo marrëdhënie të zhvillohet në aspekt pozitiv, ka disa rregulla që duhet të respektohen. Feja jonë kërkon që të formohen marrëdhënie të mira me fqinjët, që të mirëkuptohemi mjaft mirë. Allahu urdhëron në Kur'an që të bëjmë mirësi ndaj fqinjëve të afërt dhe fqinjëve të largët (*shihni Nisa, 4/36*). Pejgamberi këshillonte që të mos i torturojmë kurrë fqinjët, të sillemi mirë me ta dhe na shmang nga shprehja e sjelljeve të këqija ndaj tyre (*shihni Rijadhu's-Salihin, I, 342-343*).

Pra, kemi detyra dhe përgjegjësi edhe ndaj fqinjëve. Marrëdhëniet me fqinjët duhet t'i ndërtojmë mbi dashuri e respekt. Duhet të jemi buzagaz dhe fjalëbukur ndaj tyre. Nuk duhet t'i lëndojmë ata me fjalët dhe sjelljet tona, duhet të ndajmë gëzimin dhe pikëllimin me ta. Duhet t'i vizitojmë ata kur të sëmuren, të marrim pjesë në xhenazet e tyre kur të vdesin dhe të shprehim ngushëllimet tona. Nuk duhet t'i shqetësojmë ata duke bërë zhurmë, duke folur me zë të lartë apo duke ndotur mjedisin përreth tyre. Duhet t'u japim hua sendet për të cilat kanë nevojë, ushqime etj., si dhe të shkëmbejmë dhurata me ta. Duhet të fitojmë dashurinë, respektin dhe lëvdimet e tyre. Duhet të mundohemi të zgjidhim problemet materiale dhe shpirtërore të tyre.



### Është radha juaj

Shpjegoni kuptimin e fjalisë: "Përpara se të blini shtëpi, së pari kërkonin fqinj".

Njeriu, i cili përkufizohet edhe si një qenie shoqërore, ka detyra dhe përgjegjësi ndaj shoqërisë brenda së cilës jeton. Në mënyrë që njeriu të formojë një shoqëri të qetë dhe të lumtur, duhet që rrethin e tij shoqëror ta themelojë mbi dashuri, respekt, vëllazëri, drejtësi dhe tolerancë. Njeriu duhet të jetë i dashur me shoqërinë dhe të jetojë me drejtësi. Njerëzit që duan njëri-tjetrin mendojnë për dobinë dhe lumturinë e njëri-tjetrit. Vëllazëria dhe miqësia si prodhim i dashurisë, krijojnë vetëdijen e ndihmës së ndërsjellë. Paqja dhe kompromisi shoqëror del në pah si rezultat i marrëdhënieve të mbështetura në dashuri dhe vëllazëri. Nëse individët e një komuniteti janë në përpjekje për kompromis dhe afrimet, kjo bën që shoqëria të forcohet. Pejgamberi ynë ka bërë kompromis dhe afrimet në shtetin dhe shoqërinë që ka krijuar, në saje të dashurisë dhe vëllazërisë që ka vendosur.

Kur'ani ka përcaktuar parime që rregullojnë rrethin shoqëror të njeriut dhe ka kërkuar prej njeriut që të sillet në përputhje me to. Personi duhet ta vendosë mirë ekuilibrin mes të drejtave e lirive dhe përgjegjësisë së rrethit shoqëror. Njerëzit duhet të njohin ekzistencën e njëri-tjetrit, duhet të jenë të respektueshëm dhe modestë ndaj njëri-tjetrit (*Lukman, 31/18*). Duhet të jenë të drejtë ndaj njëri-tjetrit, nuk duhet të gënjejnë dhe duhet të mbajnë fjalën e dhënë (*Xhuma, 61/2; Insan, 76/7*). Duhet të krijojnë pajtim mes njerëzve, nuk duhet të jenë prishës, por rregullues (*Nisa, 4/114*). Në shoqëri duhet të respektohen nevojtarët dhe duhet të japim ndihmë ndaj tyre:



*“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Nisa, 4/92)*

Të jesh altruist, të solidarizohesh në mirësi dhe të qëndrosh përballë të këqijave është një përgjegjësi shoqërore (*Maide, 5/2*). Kurrë nuk duhet të përzgjidhet rruga e dredhisë dhe e mashtrimit (*Mutaffifin, 83/1-3*). Është e ndaluar kategorikisht që t’i vësh syrin jetës, pasurisë (*Bakara, 2/188*) dhe nderit të njerëzve (Nisa, 4/93). Ndër njerëzit duhet të respektohet parimi i drejtësisë: “Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë...” (*Nahl, 16/90*)

Pejgamberi ynë ka këshilluar që të jemi të vetëdijshëm mbi përgjegjësitë ndaj rrethit tonë shoqëror dhe këtë vetëdije e ka përcaktuar në kuadër të besimit. Po në këtë kuadër ka përcaktuar edhe heqjen e një guri nga rruga, i cili është pengesë për kalimin e njerëzve (*Buhari, Iman, 3*). Fjalët e mëposhtme shprehin në mënyrë të përmbledhur përgjegjësinë e njeriut ndaj rrethit të tij:



*“Kushdo prej jush që sheh një sjellje të shëmtuar dhe diçka të pakëndshme, ta rregullojë me dorë atë. Nëse nuk i mjafton forca për ta rregulluar me dorë, ta ndryshojë me gjuhë. Nëse nuk është i aftë edhe për këtë, të distancohet me zemër nga ai veprim ose sjellje, të reagojë ndaj saj. Ky qëndrim i fundit është forma më e dobët e besimit.” (Muslim, Iman, 78)*

86

Të tregosh respekt ndaj të drejtave njerëzore është detyra dhe përgjegjësia jonë shoqërore. Ndër të drejtat kryesore njerëzore vjen e drejta e jetesës. Jeta e çdo njeriu është e denjë për respekt dhe është e paprekshme. Njeriu duhet të tregojë respekt edhe ndaj jetës së tij, por edhe ndaj jetës së të tjerëve. Personi ka të drejtë të mbrojë personalitetin dhe nderin e tij. Feja jonë ka urdhëruar që njerëzit të jenë të respektuar ndaj nderit të njerëzve. Tallja, ofendimi, smira, thashethemet, shpifja, presioni dhe tortura janë qëndrime dhe sjellje lënduese ndaj nderit të njeriut, nga të cilat duhet të shmangemi. Duhet të respektohet dhe të mos zbulohet jeta private e njerëzve. Çdo njeri zotëron lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes. Është e gabuar që njeriu të shtrëngojë dikë në besimin e diçkaje, duke bërë presion mbi ndërgjegjen e njerëzve. Feja jonë ndalon edhe presionin mbi mendimet fetare dhe atyre që lidhen me ndërgjegjen e njerëzve. Individët e shoqërisë duhet të jenë tolerantë ndaj besimeve, mendimeve dhe pikëpamjeve të njëri-tjetrit.



## 6

## Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj rrethit shoqëror



Njeriu ka detyra dhe përgjegjësi ndaj rrethit natyror, brenda të cilit jeton dhe nga i cili përfiton, si dhe ndaj rrethit shoqëror me të cilin jeton. Njeriu duhet të krijojë marrëdhënie me rrethin shoqëror duke qenë i vetëdijshëm për përgjegjësitë, duhet të zhvillojë rrethin e tij natyror dhe shoqëror. Njeriu që paraqet sjellje, të cilat dëmtojnë mjedisin, përballet me probleme dhe vështirësi të mëdha, dëmton si veten ashtu edhe të tjerët. Dëmtimi i mjedisit çon deri në prishjen e llojeve të gjallesave dhe ekuilibrit natyror. Feja jonë synon që t'i udhëzojë të gjithë njerëzit mbi përgjegjësitë ndaj mjedisit. Vetëdija e përgjegjësisë e orienton njeriun që të përdorë në mënyrë të ekuilibruar çdo gjë që zotëron njeriu. Problemet e mjedisit shfaqen si rezultat i prishjes së ekuilibrit që ekziston në natyrë. Njeriu ka përgjegjësi të mbrojë ekuilibrin natyror, të paktën vijimi i jetës së tij është i lidhur me këtë. Të mbrojtë rrethin natyror është detyra më e rëndësishme e gjithë njerëzimit. Prishja dhe ndotja e mjedisit vjen si rezultat i largimit nga vlerat morale universale.

**Le të mendojmë**

Përse duhet ta duam natyrën dhe çfarë duhet të bëjmë për ta ruajtur?

Njeriu, marrëdhëniet me rrethin natyror duhet t'i formojë mbi themelin e dashurisë dhe miqësisë. Sepse natyra është një amanet që i është dhënë njeriut. Njeriu është përgjegjës për mbrojtjen e natyrës, e cila i shërben atij. Fakti që i shërben, nuk do të thotë se njeriu ka të drejtë ta përdorë atë në mënyrë të pavetëdijshme, armiqësore dhe të shfrenuar. Përndryshe, natyra del së shërbyeri ndaj njeriut dhe fillon ta dëmtojë atë. Prishja e ekuilibrit natyror me dorën e njeriut dhe ndotja e rrethit natyror nuk kërcënon vetëm jetën e njeriut, por të gjitha gjallesat në univers. **“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).”** (Rum, 30/41)

**Është radha juaj**

Shpjegoni se si kanë ndikuar gabimet e njeriut në fatkeqësitë natyrore.

Individët dhe shoqëritë që janë indiferentë kundrejt mjedisit dhe që nuk veprojnë me vetëdijene detyrës, gjatë gjithë historisë së njerëzimit janë përballur me problemet e mëdha, fatkeqësi dhe shembje historike. Njerëzit që nuk e plotësojnë detyrën ndaj rrethit natyror dhe shoqëror do të gjykohen para Allahut për përgjegjësi që nuk i kanë marrë përsipër.



## 7

## Detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj shtetit



Individët kanë detyra dhe përgjegjësi kundrejt shtetit, të cilat duhen plotësuar. Shteti nënkupton pavarësinë e institucionalizuar politike; ai u përket njerëzve që jetojnë brenda kufijve të tij dhe është institucioni më i gjerë shoqëror që drejton një shoqëri. Shteti është një strukturë shoqërore dhe politike, i cili parandalon dëmtimin e njerëzve ndaj njëri-tjetrit, i afron ata dhe bën kompromis, si dhe mundëson drejtësi e barazi sipas ligjit. Shteti është një formim që e mbron vendin nga sulmet e armikut, që do të bëjë rregullimet, që do të mundësojë sigurinë e brendshme dhe të jashtme. Detyra e shtetit është të mundësojë që shoqëria të jetojë në mënyrë të rregullt, të përshtatshme, të sigurt dhe të paqtë. Krahas rregullit shoqëror, detyrë e shtetit është edhe ruajtja e fesë së popullit që përfaqëson. Populli është i detyruar t'u bindet atyre që drejtojnë shtetin për të realizuar këto qëllime. Shteti duhet të jetë në themel të shoqërisë, të mundësojë rregullin e saj dhe të sigurojë unitetin e gjallërinë e popullit. Të gjithë janë të detyruar t'u përshtaten ligjeve që ka vënë shteti për të mundësuar rregullin shoqëror.

Shteti përfaqëson forcën, autoritetin dhe vijueshmërinë. Si rrjedhojë, Pejgamberi ynë kur erdhi në Medinë, fillimisht krijoi strukturën dhe mblodhi shoqërinë nën autoritetin e tij politik. Kur'ani e shpreh kështu faktin që një sistem rregullash i shoqërisë bën të nevojshme bindjen ndaj atyre që drejtojnë brenda një sistemi ligjor:



*“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja.” (Nisa, 4/59)*

Edhe Pejgamberi ynë e ka parë të nevojshme bindjen ndaj burrave të shtetit që vënë në funksion punët e popullit (*Tirmidhi, Xhum'a, 81*). Ata që drejtojnë shtetin janë të detyruar të bëjnë çdo lloj përpjekjeje për të fituar dashurinë, respektin dhe mbështetjen e popullit, në përputhje me parimin e drejtësisë. Shoqëria është në pozitë të paralajmërojë brenda kuadrit ligjor burrat e shtetit dhe të politikës që shkelin rregullat e moralit dhe të ligjit, duke bërë kritika strukturoese dhe paqësore. Kjo detyrë bie, së pari, mbi dijetarët dhe ideatorët. Shoqëria ka detyrën e zgjedhjes dhe të kontrollimit të drejtuesve. E drejta e zgjedhjes dhe zgjedhshmërisë përdoret brenda një rregulli ligjor.

Shlyerja e taksave në mënyrë që shteti të vërë në funksion përgjegjësitë e tij është detyrë e nënshtetasve të atij shteti. Të ndihmohet dhe të mbështesësh shtetin në investimet që do të bëjë për të rritur nivelin social dhe ekonomik është një detyrë tjetër. Të mbrosh pasurinë e shtetit është një detyrë dhe përgjegjësi e rëndësishme morale. Të shkosh ushtar me qëllim mbrojtjen e atdheut është një detyrë nacionale

dhe fetare. Forca e shtetit në fushën sociale, ekonomike dhe ushtarake, i bën të respektueshëm individët si brenda, ashtu edhe jashtë shtetit. Ekzistenca e shtetit, jetesa e shoqërisë në rregull, gjallëri dhe paqe, nënkupton vijimin e ekzistencës.



### Le të mendojmë

Cilat janë problemet që lindin në rastet kur nuk kryhet detyra dhe nuk mba-het përgjegjësi ndaj shtetit?



## Përgjegjësi të profesionale



Në jetesën shoqërore, të gjithë kanë një ndarje pune, të cilën janë të detyruar ta vënë në funksionim. Nga kjo pikëpamje, njerëzit zotërojnë një profesion në kuadër të aftësive dhe mundësive që kanë. Çdo profesion ka rregullat e veta të posaçme, të cilat duhet të respektohen. Të zotërosh dijet dhe aftësitë profesionale është detyrë themelore. Profesionistët që zotërojnë dije dhe aftësi janë një forcë e rëndësishme, që mundëson përparimin e shoqërisë. Personat janë të detyruar që të fitojnë dije dhe përvojë në lidhje me fushën së cilës i janë kushtuar, qoftë ajo e punës, artit, tregtisë etj. Krahas kësaj, duhet që personi të nxërë të dhëna fetare dhe morale në mënyrë që të përfitojë fitim të lejuar dhe të shmanget nga harami.

Ushtrimi i profesionit me dëshirë shton cilësinë e produktit dhe jep kontribut në zhvillimin e profesionit. Personi duhet të formohet mirë në profesion, të trajnohet, t'i kushtohet zhvillimit profesional. Edhe formimi i punonjësve që do të vijojnë profesionin në kuadër të marrëdhënies profesionist-punëtor është një përgjegjësi profesionale.

Kryerja e punëve ashtu siç duhet nga personat profesionistë është detyrë dhe përgjegjësi e tyre. Kryerja në mënyrën e duhur dhe të bukur e punës së bërë, mosanimi në rrugën e dredhisë dhe mashtrimit, është një përgjegjësi fetare dhe morale, krahas detyrës dhe përgjegjësisë profesionale.

Ata që e nxjerrin prodhimin me defekte, të kalbur dhe pa cilësi, dëmtojnë jo vetëm njerëzit, por edhe profesionet e tyre. Produktet e prodhuara me defekte, që janë pa cilësi dhe nuk kryejnë funksionin e tyre, bëhen shkak për humbje të mëdha ekonomike. Nga kjo pikëpamje, morali islam i ka kushtuar shumë rëndësi dijes dhe aftësisë profesionale. Për të mundësuar aftësinë profesionale dhe për të fituar besimin e zotëruesve të profesionit, janë marrë masa të ndryshme në çdo periudhë. Janë formuar institucione të esnafëve dhe zanatçinjve, janë përcaktuar parime dhe rregulla. Nëpërmjet njësive të kontrollit nuk është lejuar puna pa mbikëqyrje dhe ata që nuk e kanë pranuar këtë, janë larguar nga profesioni. Edhe në ditët tona, prodhuesit janë marrë nën kontroll me anë të ligjeve. Përveç kësaj, prodhuesi, nëpërmjet dokumenteve të kontrollit, cilësisë dhe garancisë, përpiqet të sigurojë besimin e konsumatorëve ndaj produkteve.



Krahas sanksioneve ligjore dhe shoqërore, feja jonë, me shembullin e njeriut të virtytshëm, ka marrë masa kundrejt sjelljeve të gabuara. Edhe përgjegjësia profesionale formohet vetëm mbi këtë model. Veçori themelore e njeriut të virtytshëm është respekti i përzemërt ndaj Allahut, dashuria e brendshme ndaj njerëzve. Ajo që e mban më këmbë këtë sistem shoqëror dhe ligjor është pikërisht ky virtyt. Pejgamberët, me mesazhet që kanë sjellë, kanë krijuar një ekuilibër në strukturimin material dhe moral të njerëzimit. Në këtë kuadër, ata janë bërë model shembullor edhe për profesionistët dhe janë konsideruar si zbatuesit e parë të profesioneve të ndryshme, si paraprijësit e tyre.



### Të hetojmë - Të studiojmë

Cili Pejgamber është pranuar si prijës i cilit profesion?



### Rregullat e mirësjelljes

Rregullat e mirësjelljes që janë vendosur dhe përvetësuar në një shoqëri dhe që janë shndërruar në traditë, quhen adab-i muasheret, pra, rregullat e mirësjelljes. Njeriu, në saje të këtyre rregullave mëson si të jetonte brenda një shoqërie. Për këtë arsye, të respektosh rregullat e mirësjelljes është një ndër detyrat dhe përgjegjësitë tona të rëndësishme shoqërore. Në mënyrë që marrëdhëniet ndërnerëzore të zhvillohen pozitivisht, duhet të respektojmë këto rregulla. Njeriu duhet të tregojë respekt ndaj rregullave të mirësjelljes që janë vendosur në shoqërinë ku jeton dhe, në përputhje me to, duhet të përshtatë edhe fjalët a sjelljet. Sjelljet e rregullta, të përshtatshme dhe të përbashkëta në shoqëri, shfaqen vetëm me respektimin e këtyre rregullave. Në mbrojtjen e rrethit natyror dhe social, këto rregulla luajnë një rol efektiv, strukturues dhe paralajmërues.

Rregullat e mirësjelljes nuk kanë fuqi strukturimi, ashtu si ligjet e shkruara. Individët që u përshtaten këtyre rregullave vlerësohen, ndërsa ata që nuk u përshtaten, ose që shkojnë kundër tyre, konsiderohen si të pasjellshëm. Duhet të shmangemi nga sjelljet që prishin rregullin shoqëror, që dobësojnë jetesën e përbashkët dhe besimin. Duhet të tregojmë përkujdesje në çështjen e respektimit të rregullave të përgjithshme morale, të rregullave të sjelljes dhe të delikatesës, të cilat janë të vlefshme në vendet e hapura, si në mjetet e transportit publik, xhami, hotele, salla, lokale, parkingje, rrugë etj. Rregullat e mirësjelljes kanë një rëndësi të pazëvendësueshme në kulturën tonë fetare dhe përfaqësojnë një pjesë të pandarë të arsimit tonë.

Rregullat e mirësjelljes formësohen sipas vlerave tradicionale dhe kulturore të çdo shoqërie. Megjithatë thelbi është i njëjtë, rregullat e mirësjelljes nuk janë të njëjta në çdo shoqëri. Në çdonjërin prej tyre ka anë dhe forma që ndërthuren dhe që ndryshojnë. Trafiku, morali i përgjithshëm dhe rregullat e shëndetit bëjnë pjesë të cilësive universale. Ndërsa rregullat që lidhen me mbledhjen, bisedën, gostinë dhe xhemaatin, lidhen kryesisht me cilësitë rajonale.



### Është radha juaj

Renditni çfarë dini mbi rregullat e mirësjelljes.

Feja jonë i kushton rëndësi faktit që njerëzit të jenë në marrëdhënie të mirë me njëri-tjetrin dhe të mirëkuptohen mes tyre. Edhe rregullat e moralit dhe të ligjit synojnë që njerëzit të jetojnë bashkërisht, pa e dëmtuar njëri-tjetrin dhe duke i dhënë mbështetje njëri-tjetrit. Ndërsa mirëkuptimi dhe jetesa e përbashkët në një shoqëri është e lidhur me të qenit e individëve të dashur, të respektueshëm, të sinqertë, modestë, të mirë dhe solidarë me njëri-tjetrin. Në Kur'an, këshillat në marrëdhëniet ndërnjerëzore përfshijnë rregulla të rëndësishme të mirësjelljes. Njëri prej këtyre është: *"O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje e pa i përshëndetur banorët e tyre. Kjo është më e mira për ju. Ndoshta do t'ia vini veshin!"* (Nur, 24/27)



### Të hetojmë - Të studiojmë

Lexoni kuptimin e një ajeti nga Kur'ani, i cili aludon mbi rregullat e mirësjelljes.



### Përmbledhja e kapitullit

Detyrat dhe përgjegjësitë e njeriut janë individuale dhe shoqërore. Përgjegjësia është një koncept me përmasë fetare dhe morale. Megjithatë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Allahut, Pejgamberit dhe vetes sonë janë individuale, këto shtrihen edhe në strukturën shoqërore. Të besosh në Allah, t'i bësh robërim atij dhe t'i bindesh Pejgamberit është detyra themelore e çdo njeriu që beson. Njeriu është përgjegjës për përballimin e nevojave trupore dhe shpirtërore, të tilla si mbrojtja e jetës, të ngrënët, të pirët, strehimi, të menduarit dhe besimi.

Njeriu ka detyra dhe përgjegjësi shoqërore. Detyrat dhe përgjegjësitë e fëmijëve ndaj prindërve, të bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit, të prindërve ndaj fëmijëve, të të rriturve të familjes ndaj njëri-tjetrit, aludojnë mbi rregullat morale që duhet të respektohen në marrëdhëniet e individëve me njëri-tjetrin. Feja jonë ka propozuar një jetesë shoqërore për njeriun dhe ka përcaktuar rregullat që duhet të respektohen.

Marrëdhëniet tona shoqërore duhet t'i zhvillojmë në mënyrë të shëndetshme, të ekuilibruar dhe pozitive. Për këtë arsye, duhet të realizojmë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj të afërmeve, fqinjëve, shoqërisë, rrethit shoqëror dhe shtetit. Njëra prej detyrave tona ndaj shoqërisë është përgjegjësia profesionale, duke kryer në mënyrë më të bukur punën që bëjmë. Në krijimin dhe zhvillimin sa më pozitiv të marrëdhënieve shoqërore, nuk duhet të harrojmë të respektojmë rregullat e mirësjelljes që janë përvetësuar dhe vendosur në shoqëri.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Renditni cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tona individuale e shoqërore.
2. Thoni kuptimin e nga një ajeti që tregon detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj Allahut dhe Pejgamberit.
3. Përse duhet t'í plotësojmë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj vetes?
4. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e fëmijëve ndaj prindërve?
5. Shpjegoni rëndësinë e kryerjes së detyrës së prindërve ndaj fëmijëve?
6. Çfarë problemesh krijohen nëse bashkëshortët nuk realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj njëri-tjetrit?
7. Përse duhet të kemi marrëdhënie të mira me fqinjët? Shpjegojeni.
8. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj shoqërisë? Renditini ato.
9. Çfarë fitojmë dhe çfarë humbasim nëse realizojmë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj mjedisit? Diskutoni me shokët tuaj.
10. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj shtetit?
11. Cilat janë përgjegjësitë tona profesionale? Shpjegojini.
12. Renditni rregullat e mirësjelljes.





## Pyetje vlerësuese



### 1. Në cilën prej fjalive të mëposhtme jepen të dhëna në lidhje me rregullat e mirësjelljes?

- A) Rregullat e mirësjelljes përcaktohen nga ligjet.
- B) Ata që nuk respektojnë këto rregulla dënohen nga ligjet përkatëse.
- C) Rregullat e mirësjelljes janë të njëjta në çdo shoqëri, nuk ndryshojnë.
- D) Ajo që i përcakton këto rregulla, që i përvetëson dhe që i kontrollon, është shoqëria.

### 2. Cili nga veprimet e mëposhtëm nuk shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj vetes?

- A) Të mbrojmë trupin.
- B) Të mbrojmë shëndetin mendor.
- C) Të mbrojmë veçoritë shpirtërore.
- D) Të mbrojmë mjedisin.

### 3. Cila nga alternativat e mëposhtme është veçoria më e bukur që prindërit mund t'u falin fëmijëve si detyrë dhe përgjegjësi?

- A) Profesioni.
- B) Një arsim i mirë.
- C) Morali i bukur.
- D) Fama dhe njohja.

### 4. Cili nga konceptet e mëposhtme shpreh 'vijimin e marrëdhënieve ndërfisnore'?

- A) Kthimi i vizitës.
- B) Mbajtja aktive e marrëdhënieve ndërfisnore.
- C) Rregullat e mirësjelljes.
- D) Përshëndetje me përqaftim.

### 5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është njëra prej detyrave dhe përgjegjësiave tona profesionale?

- A) Të respektosh fushën profesionale.
- B) Të mbrosh të drejtat e konsumatorit.
- C) Të jesh i kujdesshëm në çështjen e cilësisë.
- D) Të mos u mësosh atyre që ke pranë detajet e profesionit.

morali inn  
morali inn



Kapitulli

6





# Dashuria ne moralin islam

1. Dashuria ndaj Allahut
2. Dashuria ndaj Pejgamberit
3. Dashuria ndaj njeriut
4. Dashuria ndaj prindërve
5. Dashuria ndaj kafshëve dhe mjedisit
6. Dashuria ndaj flamurit dhe atdheut
7. Të rënit dëshmor dhe të qenit gazi





### RRETH KAPITULLIT

Dashuria është një ndër forcat shtytëse, që u jep drejtim sjelljeve tona. Në këtë kapitull, ku trajtohet dashuria si pjesë e moralit islam, së pari është analizuar dashuria ndaj Allahut dhe Pejgamberit. Më pas është treguar dashuria ndaj gjallesave të tjera. Pasi shtjellohet dashuria ndaj njeriut, si një ndër dashuritë themelore dhe dashuria ndaj prindërve, citohet edhe dashuria ndaj gjallesave të tjera. Në këtë kuadër është trajtuar dashuria ndaj kafshëve dhe mjedisit. Të gjithë jetojmë në një shtet dhe ndajmë një atdhe. Në këtë kapitull ceket dashuria ndaj atdheut dhe ndaj flamurit, si dhe rëndësia e të rënit dëshmor dhe të qenit gazi.

### SYNIMET E KAPITULLIT

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull, synohet të zotëroni informacionet e mëposhtme:


1. Të shpjegoni rëndësinë e dashurisë në moralin islam
  - Të shpjegoni cilësitë e dashurisë ndaj Allahut
  - Të shpjegoni funksionin e sjelljeve morale në dashurinë ndaj Allahut
  - Të thoni shembuj të sjelljeve që shprehin dashurinë ndaj Allahut
2. Të shpjegoni rëndësinë e dashurisë ndaj Pejgamberit
  - Të shpjegoni funksionin e sjelljeve morale në dashurinë e Pejgamberit
  - Të thoni shembuj të sjelljeve që shprehin dashurinë e Pejgamberit
3. Të shpjegoni rëndësinë e dashurisë ndaj njeriut
  - Të shpjegoni funksionin e dashurisë së njeriut në sjelljet morale
  - Të jepni shembuj nga rrethi shoqëror për dashurinë ndaj njeriut
  - Të tregoni përkujdesje në dashurinë ndaj njerëzve
4. Të shpjegoni rëndësinë e dashurisë ndaj kafshëve dhe mjedisit
  - Të shpjegoni funksionin e dashurisë ndaj kafshëve dhe mjedisit në sjelljet morale
  - Të jepni shembuj nga rrethi shoqëror për dashurinë ndaj kafshëve dhe mjedisit
  - Të tregoni përkujdesje që të doni kafshët dhe rrethin shoqëror
6. Të shpjegoni rëndësinë e dashurisë ndaj flamurit dhe atdheut
  - Të shpjegoni funksionin e dashurisë ndaj flamurit dhe atdheut në sjelljet morale
  - Të thoni shembuj të sjelljeve që shprehin dashurinë ndaj flamurit dhe atdheut
  - Të tregoni përkushtim në dashurinë ndaj flamurit dhe atdheut
7. Të përkufizoni konceptet e të rënit dëshmor dhe të qenit gazi
  - Të shpjegoni rëndësinë e të rënit dëshmor dhe të qenit gazi
  - Të jepni shembuj nga historia jonë për të rënit dëshmor dhe të qenit gazi
  - Të shpjegoni se si mund ta tregojmë dashurinë tonë ndaj dëshmorëve dhe gazinjve
  - Të tregoni përkushtim ndaj demonstrimit të dashurisë kundrejt dëshmorëve dhe gazinjve

### NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

Ndërsa mësoni këtë kapitull:

1. Së pari lexoni tekstin mësimor dhe mundohuni ta kuptoni atë.
2. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me synimet që mendoni se nuk i keni arritur.
3. Realizojini patjetër ushtrimet që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
4. Në fund të kapitullit paraqitet lista e burimeve. Analizoni veprat që mund të siguronit nga kjo listë.

## 1

Dashuria ndaj Allahut 

Në moralin islam, dashuria ka një rëndësi shumë të madhe. Dashuria është një ndjenjë që të orienton të ndiesh interes dhe varësi ndaj diçkaje ose ndaj një personi. Në këtë aspekt, dashuria është forca shtytëse e mjaft sjelljeve. Në dashuri ka interes dhe varësi. Të gjithë ne ndiejmë nevojë të duam dhe të duhemi. Gjallesat zhvillohen dhe zbukurohen me dashuri. Dashuria fal lumturi dhe paqe. Ajo është burimi i jetesës për gjallesat.

Dashuria është një mirësi që Allahu ua fal njerëzve. Njëri prej burimeve të besimit është dashuria. Dashuria është, në të njëjtën kohë, njëri ndër argumentet e ekzistencës së Allahut. **“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”** (Rum, 30/21)

**DASHURIA**

Është dashuria ajo që na bën t'i shërbejmë njeriut.

Është dashuria ajo që na bën të mbjellim fidanë në pranverë.

Është dashuria ajo që na bën të mbjellim pemë nëpër male.

Ajo që hap portat ndaj guximit është dashuria.

Është dashuria ajo që hap udhë, që bën të rrjedhin lumenjtë,

Është dashuria ajo që e bën dijetarin të nxërë dije.

Është dashuria ajo që bën t'i thurim himne së bukurës.

Dashuria është ajo që thur mëndafshin shumëngjyrësh.

Është dashuria ajo që radhit perlat në fillin prej argjendi.

Është dashuria ajo që hedh rrënjët e mirësisë në zemër.

Është dashuria ajo që e bën poetin të shkruajë poezi.

Është dashuria ajo që i jep lapsit bojë.

Mustafa Ruhani (Yakıcı, f. 253)

**Le të diskutojmë**

Duke u nisur nga poezia e mësipërme, tregoni se për çfarë bëhet shkak dashuria? Përse? Diskutojeni.

Allahu i do shumë krijesat e tij. Kjo situatë shprehet kështu në Kur'an: "Kërkoni falje nga Zoti juaj e kthehuni me pendim tek Ai. Me të vërtetë, Zoti im është Mëshirëplotë dhe gjithë dashuri." (*Hud, 11/90*) Një ditë erdhën te Pejgamberi disa njerëz. Ndër këta gjendej edhe një grua. I kishte humbur fëmija dhe po e kërkonte. Kur gruaja e gjeti fëmijën, e përqafoi menjëherë atë. Pejgamberi ynë, i cili pa këtë dashuri dhe mëshirë e dhembshuri të lartë tha: "Ja, Allahu është më i mëshirshëm dhe më i dhembshëm se sa dashuria dhe mëshira që kjo grua ka për fëmijën e saj." (*Buhari, Edeb, 18*) Allahu i do vepërmirët (*Bakara, 2/195*), penduesit dhe të pastrit (*Bakara, 2/222*), të devotshmit (*Al-i Imran, 3/76*) dhe durimtarët (*Al-i Imran, 3/146*).



#### Të diskutojmë së bashku

Përse i do Allahu krijesat e tij? Diskutoni.

Si të krijosh, ashtu edhe të mbash gjallë, është një punë dashurie. Krijimi i gjallesave nga Allahu, ofrimi i mjedisit të nevojshëm për ta është një demonstrim i dashurisë së tij. Për shembull, njëri prej emrave të Allahut është Rahman, ndërsa tjetri Rahim, dhe ne duhet ta duam Krijuesin tonë, i cili na do ne dhe na jep çdo lloj mirësie.

98



#### Të diskutojmë së bashku

Cilat mund të jenë shenjat e dashurisë së Allahut ndaj gjallesave? Diskutoni.



#### Të hetojmë - Të studiojmë

Cilët janë kuptimet e emrave Rahman dhe Rahim? A ka emra të tjerë që tregojnë dashurinë e Allahut? Shqyrtojini.





## DASHURIA NDAJ ALLAHUT

Kush e nxjerr që herët  
diellin, i cili i jep dritë botës sonë?  
Kur lind hëna, e cila në kohë nate  
mbi dete shtrihet, kush e bën këtë?

Kush e gjelbëron pranverën,  
fidanin, të cilin në dimër mendojmë se është i thatë?  
Bilbili cicëron, në pyllin ku ka ndërtuar fole,  
kush ia fal vallë këtë zë atij?

Ndjenjën e dashurisë së nënës ndaj jush,  
zërin që fal shërim në zemrat tuaja,  
ndjenjën që të jemi të drejtë në zemrën tonë,  
kush i fal të gjitha këto?

(Gövsa, f. 11-12)



### Të diskutojmë së bashku

Kush është ai që i jep të gjitha këto? Përse na i jep? Diskutoni.

Njëra prej ndjenjave më të bukura që Allahu i fal njeriut është dashuria. Sipas fesë sonë, i dashuri i vërtetë është Allahu. Allahu, i cili është i mëshirshëm ndaj krijesave, është qenia e vetme dhe më e denja për t'u dashur dhe që duhet të duhet në kuptimin e plotë. Të duash Allahun, të bësh adhurim ndaj tij me dashuri, të tregosh sjellje të bukura, është detyra jonë më themelore.

Besimtarët e duan Allahun, edhe Allahu i do ata. Kjo situatë shprehet kështu në Kur'an: "... Allahu i do ata dhe ata e duan Allahun..." (Maide, 5/54) Dashurinë ndaj Allahut mund ta shprehim duke u sjellë mirë me krijesat e tij dhe duke i bërë adhurim atij. Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat me dashuri dhe me përkushtim. Edhe ne mund ta tregojmë dashurinë tonë duke ruajtur me dashuri dhe përkushtim gjallesat që krijoi Allahu dhe duke qenë të dobishëm për ta. Rruga e të qenit besimtar në kuptimin e plotë, është të sillemi në atë mënyrë që "të duam për Allahun", të fitojmë pëlqimin e tij.



### Është radha juaj

Ç'do të thotë "të duash për Allahun"? Shpjegojeni.

## 2

## Dashuria ndaj Pejgamberit



Dashuria ndaj Pejgamberit ka lidhje me dashurinë ndaj Allahut. Ai që do Allahun, do edhe të dërguarin e tij. Duke qenë se Pejgamberi është i dërguari i Allahut, ne tregojmë dashuri dhe respekt ndaj tij.



“Thuaju (o Muhammed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë’.” (Al-i Imran, 3/31)

**Është radha juaj**

Përse e fiton dashurinë e Allahut një person që do Allahun dhe që ndjek rrugën e tij? Shpjegojeni.

Allahu ua ka përcjellë njerëzve mesazhet e tij nëpërmjet pejgamberëve. Pejgamberët janë robërit e dashur të Allahut dhe të dërguarit e tij. Ata kanë punuar për t’ua përcjellë njerëzve mesazhet e Allahut dhe për t’i përhapur ato. Pejgamberët, duke ua përcjellë njerëzve mesazhet e Allahut, kanë punuar për t’i udhëzuar njerëzit në shpëtim dhe në lumturi. Në këtë rrugë kanë hasur mjaft probleme dhe vështirësi. Ne e mësojmë fenë tonë nëpërmjet pejgamberëve. Paralajmërimi i njerëzve nga pejgamberët, roli i tyre si udhërrëfyes, në mënyrë që ata të drejtohen në rrugë të drejtë, është një demonstrim i dashurisë së tyre. Pejgamberi ynë është dërguar si mëshirë për botët. Allahu e shpreh kështu në Kur’an dashurinë e pejgamberit ndaj nesh:



“Tasmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të ndiqni rrugën e drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 9/128)

**Të diskutojmë së bashku**

A mund të konsiderohet përcjellja e mesazheve të Allahut te njerëzit nëpërmjet pejgamberëve si demonstrim i dashurisë ndaj njerëzve? Përse? Diskutoni.

Pejgamberët, si të dërguar që Allahu i ka zgjedhur, janë nga një shembull për ne. Ne i marrim si shembull ata kur vijojmë jetesën tonë. Në Kur’an bëhet e ditur se Hz. Muhammedi është shembull për njerëzit:



“...Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë...” (Shura, 42/52)

“O Pejgamber! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” (Ahzab, 33/45-46)

Prandaj, Allahu i Lartmadhëruar kërkon që të marrim si shembull Pejgamberin tonë të dashur.



Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe te dita e fundit dhe e përmend shumë Allahun." (Ahzab, 33/21)

Jetesa e Hz. Muhammedit, pra sunneti i tij, është shembull për ne.



### Të diskutojmë së bashku

Çfarë nënkupton fakti që Hz. Muhammedi është shembull për ne? Diskutoni.

Të njohim Pejgamberin, si shembulli më i bukur për ne, të kuptojmë jetesën e tij dhe të mësojmë prej saj, është detyra jonë më themelore. Kështu mund të shprehim dashurinë tonë ndaj Pejgamberit. Nga njëra anë duhet ta duam atë, nga ana tjetër duhet të mundohemi të fitojmë dashurinë e tij. Po ashtu, duhet të përpiqemi të bëjmë një jetë, të cilën ai do ta dojë. Që nga ditët e para të Islamit e deri në ditët e sotme, besimtarët e kanë shprehur në mënyra të ndryshme dashurinë e tyre ndaj Pejgamberit.

### LUTJA

Ata që trokasin në portën tënde, o Muhammed,  
-nga larg apo nga afër-  
u kthyen si besimtarë nga porta jote...

Bismilaja ishte begatia e ushqimit tonë;  
në të dy botët populli i nderuar,  
është populli i Pejgamberit Muhammed...

U ulshin përsëri parvazeve pëllumbat!  
Me thirrjet Hu-Hu u përzjefshin aminet!  
Mbrëmje e bekuar është:  
Ejani Fatihatë, Jasinet!  
.....

Të derdhen nga zemrat  
përsëri besimet!  
Itriu qoftë ai që do të kompozojë tekbinin  
tënd; Kur'anin evlijatë ta këndojnë...  
Dhe e shtofshin me dritën e syrit,  
Kur'anin, kaligrafë si Kajishzadi Osman...  
Lutjen tënde le ta shkruajë Galibi,  
ndërsa mevludin Sulejmani...  
Le të rikthehen përsëri Sinanët  
me shtyllat, brezat dhe me kupolat...  
Të dënohen nga ashku hyjnor,

ata që u prijnë namazeve të xhenazes, me  
nijetin e së vërtetës!

Ndërgjegjja është e paplotë  
pa dalë ende në të nesërmen, o  
Muhammed!  
Eja me mirësi, eja me bukuri  
te bijtë e Ademit...

Eja o Muhammed!  
Erdhi pranvera!  
Pas buzëve të fshehura i kemi  
thirrjet "amin"...  
Kthehu ashtu siç kthehesh nga haxhi.  
Kthehu ashtu siç zbret nga Miraxhi.  
Po presim prej vitesh!

Arif Nihat ASYA





### Të diskutojmë së bashku

Si tregohet në poezinë e mësipërme dashuria ndaj Pejgamberit tonë? Diskutoni.



### Të diskutojmë së bashku

Çfarë bëjnë njerëzit që keni përreth për të treguar dashurinë që ndiejnë për Pejgamberin? Diskutoni.

## 3

### Dashuria ndaj njeriut

Sipas fesë sonë, njeriu është një qenie e denjë për t'u dashur, për shkak të të qenit rob i Allahut dhe të krijimit të tij në formën më të bukur.

102



“Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.” (Tin, 95/4)



“Allahu nuk tregon mëshirë ndaj atij që nuk tregon mëshirë ndaj njerëzve.” (Muslim, Fedail, 66)



### Është radha juaj

Shpjegoni fjalinë “Dashuria sjell dashuri”.

Ka një marrëdhënie mes dashurisë ndaj njerëzve dhe dashurisë ndaj Allahut. Njëra prej situatave, nëpërmjet së cilës mund të shprehim dashurinë ndaj Allahut është të ndihmojmë njerëzit që ka krijuar ai, të tregojmë mëshirë ndaj tyre. Kjo situatë tregohet kështu në një hadith:



“Në ditën e kiametit Allahu do të urdhërojë kështu: “O biri i Ademit! Unë u sëmura, nuk erdhe të më vizitosh.”

Robi do të thotë: “O Zoti im, kur ti je Zoti i botëve, si mund të të vizitoj unë ty?”

Zoti i Lartmadhëruar do të thotë: “A nuk e di se një robi im u sëmur, por ti nuk i vajte për vizitë, a nuk e di? Po të kishe vizituar atë, do të më gjeje mua pranë tij.”

Zoti i Lartmadhëruar do të thotë: “O biri i Ademit, unë kërkova ushqim nga ti, por ti nuk më dhe ushqim mua!”

Robi do të thotë: “O Zoti im, si mund të të jap unë ty ushqim. Ti që je Zoti i botëve?”

Zoti i Lartmadhëruar do të thotë: “Një robi im kërkoi ushqim prej teje. Dhe ti nuk e ushqeve atë. A nuk e di ti se, nëse do t’i jepje ushqim atij, do të më gjeje mua pranë tij?”

Zoti i Lartmadhëruar do të thotë: “O biri i Ademit, unë kërkova ujë prej teje, por ti nuk më dhe!”

Robi do të thotë: “O Zoti im, si mund të të jap ujë ty, që je Zoti i Botëve!”

Zoti i Lartmadhëruar do të thotë: “Filan robi im kërkoi ujë prej teje. Ti nuk i dhe ujë atij. A nuk e di, po t’i kishe dhënë ujë atij, mua do më gjeje pranë vetes!” (Muslim, Bir, 43)



#### Të diskutojmë së bashku

Cili është treguesi i dashurisë ndaj Allahut në hadithin e mësipërm? Diskutoni.



#### Është radha juaj

Shpjegoni fjalinë “E duam krijesën për shkak të Krijuesit”.

Në përgjithësi, feja jonë i këshillon të gjithë njerëzit, këshillon veçanërisht muslimanët që të jenë vëllezër, të duan njëri-tjetrin.



“Mos u ftohni nga njëri-tjetri, mos ndjeni smirë për njëri-tjetrin, mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit, o bijtë e Allahut, jini vëllezër.” (Buhari, Edeb, 57)

Po ashtu, njëra prej domosdoshmërive të besimit është dashuria ndaj njeriut.



“Askush prej jush nuk konsiderohet se ka besuar vërtet, për sa kohë nuk do për vëllanë besimtar atë që do edhe për vete.” (Buhari, Iman, 7) “Beto-hem në Allah se, për sa kohë nuk besoni, nuk hyni në xhennet, për sa kohë nuk doni njëri-tjetrin, nuk arrini në besim në kuptimin e plotë. A t’ju them diçka që, nëse e bëni, do të doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin mes jush.” (Muslim, Iman, 93)

Njëri prej treguesve më të rëndësishëm të dashurisë është të përballosh nevojat e njerëzve, të bësh atë që mundesh për t'i shpëtuar ata nga vështirësitë dhe problemet. Pejgamberi ynë urdhëron kështu:



*“Kushdo që përballon një nevojë të vëllait të tij besimtar, Allahu ia plotëson nevojën atij. Kushdo që e shpëton muslimanin nga vështirësia për këtë shkak, Allahu e shpëton atë nga njëra prej vështirësive në ditën e kiametit. Kushdo që mbulon një mangësi të muslimanit, në ditën e kiametit Allahu mbulon një mangësi të tij.” (Buhari, Mezalim, 3)*

Dashuria është një ndjenjë që i lidh njerëzit me njëri-tjetrin, për sa kohë që ajo përhapet. Kjo situatë shprehet kështu në një hadith:



*“Besimtarët, sa i përket dashurisë ndaj njëri-tjetrit, shprehjes së dhembshurisë ndaj njëri-tjetrit dhe mbrojtjes së njëri-tjetrit, janë si një trup. Nëse sëmuret çdonjëri prej organeve trupore, edhe organet e tjera do të kenë temperaturë dhe personi mbetet pa gjumë.” (Buhari, Edeb, 19)*



#### Është radha juaj

Shpjegoni konceptet “vëllazëria e njeriut” dhe “vëllazëria e besimtarit”.



#### Është radha juaj

Në hadithet e mësipërme shpjegohet se si mund të arrihet në vëllazëri. Shpjegojeni.

## 4

### Dashuria ndaj prindërve

Një pjesë e rëndësishme e jetës sonë kalon pranë familjes. Nga familja jonë mësojmë shumë gjëra. Në zhvillimin, rritjen dhe përgatitjen për jetesë, familja ka një rëndësi të madhe. Ajo përbëhet nga nëna, babai dhe fëmijët.

Feja jonë i ka kushtuar shumë rëndësi familjes. Këshillohet që në familje të krijohet një mjedis dashurie, lumturie, mëshire, paqeje dhe qetësie. Të krijojnë një mjedis të tillë është detyrë e të gjithë pjesëtarëve të familjes.



#### Të diskutojmë së bashku

Cilat janë detyrat që bien mbi pjesëtarët e familjes për të krijuar një mjedis dashurie të lumtur dhe të qetë në familje? Diskutoni



Nëna dhe babai janë themeli i familjes. Ato bëjnë sakrificat të mëdha në formimin e familjes, në vijueshmërinë dhe zhvillimin e saj.



“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.”  
(Lukman, 31/14)

“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm me prindërit e vet.”  
(Ahkaf, 46/15)



### Pjesë leximi

#### FËMIJA QË VJEN NË BOTË

Na ishte njëherë një fëmijë që po përgatitej për të ardhur në këtë botë.

Fëmija tha:

- Allahu im, më thanë se nesër do të më dërgosh në një vend të quajtur botë. Por, unë jam aq i vogël dhe i pafuqishëm, sa nuk di si do të jetoj atje.

Fëmija dëgjon një zë që i thotë:

- Nga mesi i melekëve zgjodha njërin prej tyre, ata do të të presin ty dhe do të të mbrojnë. Kështu, ti do të jesh i lumtur me dashurinë e tyre.

- Po si do t’i kuptoj ata atje? Unë nuk e di gjuhën e tyre?

- Ata do të të thonë ty fjalët më të ëmbla dhe më të bukura që mund të dëgjosh në botë. Do të të mësojnë ty që të flasësh me dashuri.

- Po ç’do të bëj unë, nëse do të dua të flas me ty?

- Melekët do të të mësojnë ty të hapësh duart e të bësh dua, do të të mësojnë edhe udhën që të sjell tek unë.

- Dëgjova se në botë ka edhe të këqij. Kush do të më ruajë prej tyre?

- Ata do të të ruajnë ty nga çdo lloj rreziku, edhe sikur kjo t’u kushtojë jetën atyre.

Fëmija i bëri edhe një pyetje të fundit:

- Po kush do të më presë mua në botë?

- Meleku që do të të presë ty në botë, ti do t’i thirrësh nënë.



### Të diskutojmë së bashku

Cilat janë sakrificat që prindërit bëjnë për fëmijët e tyre? Diskutoni.



Prindërit tregojnë dashuri dhe mëshirë të madhe ndaj nesh. Ata bëjnë sakrifica që ne të rritemi e të zhvillohemi. Bëjnë përpjekje që ne të jemi njerëz të mirë. Në këmbim të kësaj, ajo që presin është vetëm dashuri. Allahu i Lartmadhëruar kërkon që ne ta shprehim dashurinë dhe mëshirën tonë ndaj prindërve.



*"Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: 'O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!'" (Isra, 17/24)*

Edhe Pejgamberi ynë urdhëron kështu:



*"Pëlqimi dhe kënaqësia e Allahut është te pëlqimi dhe kënaqësia e prindërve." (Tirmidhi, Bir, 3)*



### Pjesë leximi

#### KËMBIMI I DASHURISË

Merjem Xheren ishte një vajzë e vogël, e cila vazhdonte shkollën fillore. Sapo kishte filluar të lexonte. Atë ditë, pasi pati lexuar në gazetë shkrimin me titull "Çdo shërbim ka një shpërblim", mendoi: "Disa punë të shtëpisë i bëj unë. Pra, më duhet të marr pagesën kundrejt këtij shërbimi." Filloi të bëjë një listë të punëve që kishte bërë dhe të shpërblimeve përkatëse:

- Të hedh mbeturinat
- Të marr bukë
- Të ndihmoj në punët e shtëpisë...

Duke menduar se kishte bërë edhe pak ulje në çmim, vendosi që pagesa ditore të ishte 2 Lira. Kur e vendosi listën në çantën e nënës, i shndrisnin sytë.

Ditën tjetër, te koka e krevatit gjeti 5 Lira, bashkë me një letër të vogël. Në këtë letër, e cila ngjante me listën që ajo kishte përgatitur dhe që ishte shkruar nga e ëma, thuhej kështu:

*"Bija ime e dashur!*

*Shpërblimi për lindjen tënde, qoftë edhe nëse do të më kushtonte jetën, shpërblimi për qëndrimin pa gjumë vite me radhë, për ushqimin dhe rritjen tënde me një mijë e një mundime, është vetëm dashuria dhe një puthje që do të marr nga faqja jote. Harxhoje në ditë të mirë paranë e fituar, bija ime e dashur!"*



#### Të diskutojmë së bashku

Duke u nisur nga pjesa e mësipërme e leximit, tregoni se ç'mund të jetë shpërblimi i dashurisë dhe si mund të tregohet ai.



### Të diskutojmë së bashku

Cilat janë sakrificat që bëjnë prindërit për ne? Diskutoni.



### Është radha juaj

Shpjegoni kuptimin e hadithit "Xhenneti është nën këmbët e nënave" (Nesai, Xhihad, 6).

Duhet të tregojmë dashuri dhe respekt ndaj prindërve. Ata e meritojnë më shumë se kushdo tjetër këtë dashuri, për shkak të sakrificave që kanë bërë për ne. Një burrë e pyeti Pejgamberin, "Ndaj kujt duhet të bëj mirësi?" Ndërsa Pejgamberi iu përgjigj: "Nënës, përsëri nënës, pastaj përsëri nënës bëji mirësi." Burri e pyeti: "Po më pas?" Pejgamberi iu përgjigj: "Bëji mirësi babait." (Ebu Davud, Edeb, 129, 5141). Edhe Pejgamberi gjithmonë ka treguar dashuri dhe respekt ndaj nënës së tij biologjike dhe asaj të qumështit. Gjatë gjithë jetës nuk e ka harruar nënën që e humbi në moshë të vogël, herë pas here ka vizituar varrin e saj dhe ka përjetuar çaste mallëngjyese.



### Të diskutojmë së bashku

Si e tregojnë dashurinë ndaj fëmijëve nëna dhe babai? Diskutoni.



Prindërit kanë për detyrë të bëjnë që dashuria të ndihet në familje. Duhet të duan fëmijët e tyre, tua tregojnë atyre dashurinë. Pejgamberi i ka thënë kështu dikujt që e gjykoi për faktin se donte fëmijët: "Nëse Allahu e ka shkukur mëshirën e dhembshurinë nga zemra jote, ç'mund të bëj unë?" (Buhari, Edeb, 18) Përveç kësaj, Pejgamberi ynë thotë: "Ai që nuk tregon mëshirë e dhembshuri ndaj të vegjëlve, që nuk tregon respekt ndaj të rriturve, nuk është prej nesh." (Tirmidhi, Bir, 15) Edhe ai vetë i donte shumë, qoftë fëmijët e tij, ashtu edhe fëmijët e tjerë. Luante me nipërit, Hasanin dhe Hysejnin.







### Të diskutojmë së bashku

Si e tregojnë dashurinë ndaj fëmijëve nëna dhe babai? Diskutoni

Prindërit janë përgjegjës për të rritur fëmijët, për t'i zhvilluar dhe për t'i edukuar ata. Ngaqë familja është themeli i shoqërisë, si rezultat, edhe bërthama e formimit të familjeve të tjera hidhet këtu. Arsimi dhe edukimi i marrë në familje ndikon mbi njeriun gjatë gjithë jetës. Pejgamberi ynë urdhëron kështu:



*"Asnjë baba nuk mund t'i japë fëmijës një dhuratë më të lartë sesa edukata e bukur."* (Tirmidhi, Bir, 33)



### Të diskutojmë së bashku

Ç'duhet të bëjmë për të edukuar fëmijët? Çfarë mjedisi familjar duhet të krijojmë? Diskutoni.

108

5

## Dashuria ndaj kafshëve dhe mjedisit

Ne jetojmë në të njëjtin mjedis me gjallesa frymore dhe jofrymore, ndajmë të njëjtin univers me to. Këtë mjedis e përdorim në formë të përbashkët me kafshët dhe bimët. Për këtë arsye, në mjedisin brenda të cilit gjendemi duhet të sillemi me dashuri dhe mëshirë ndaj kafshëve dhe gjallesave të tjera.

Feja jonë këshillon që të sillemi me mëshirë ndaj të gjitha gjallesave. Allahu i ka krijuar kafshët për njerëzit.



*"Vallë, a nuk e shohin ata se, ndër gjërat që duart tona kanë krijuar për ta, janë bagëtitë që ata kanë?!"* (Jasin, 36/71)

*"Ai, që ka krijuar çifte për çdo lloj krijese, që ka bërë anije e kafshë që t'i shaloni e të mbaheni fort mbi to, e pastaj t'i kujtoni dhuntitë e Zotit tuaj dhe të thoni: 'Qoftë lavdëruar Ai që i nënshtroi këto për ne, se vetë ne nuk do të mund t'i kishim nën pushtet dhe, me siguri, do të kthehemi te Zoti ynë!'"* (Zuhruf, 43/12-14)



### Të diskutojmë së bashku

Në ç'mënyrë ndihmohen njerëzit prej kafshëve? Diskutoni.

Nuk duhet të torturojmë kafshët përreth, të cilat janë krijuar për ne, por duhet t'i mbrojmë ata. Duhet të jemi të vetëdijshëm se edhe ata zotërojnë të drejtën e jetesës. Një ditë Pejgamberi ynë u tregoi shokëve një ndodhi të tillë: "Një burrë, ndërsa ecte rrugës, filloi të kishte shumë etje. Ndërkohë rastisi në një pus. Zbriti në të dhe shoi etjen. Kur doli nga pusi pa një qen të tharë nga etja, i cili po lëpinte dheun e lagur. Burri mendoi: "Edhe këtë qen e paska zënë etja" dhe zbriti sërish në pus. E mbushi këpucën me ujë, doli nga pusi dhe ia dha qenit. Allahu mbeti i kënaqur nga kjo sjellje e tij."

Disa prej atyre që ishin pranë Pejgamberit, e pyetën: "O i Dërguari i Allahut! Kështu quhen sevap edhe mirësitë që bëjmë ndaj kafshëve?" Pejgamberi ynë u përgjigj: "Po, çdo mirësi që bëni ka një sevap." (Buhari, Edeb, Shirb, 9)



#### Të diskutojmë së bashku

Si mund ta tregojmë dashurinë ndaj kafshëve që kemi përreth? Diskutoni.

Ashtu siç ka njerëz që sillen me mirësi ndaj kafshëve, ka edhe të tillë që i torturojnë ata. Nuk duhet t'i torturojmë kafshët. Pejgamberi ynë ka lajmëruar se një person që lë macen të uritur dhe bëhet shkak që ajo të ngordhë, do të dënohet në ahiret (Buhari, Bed'ul Halk, 17).



#### Le të diskutojmë

Si mund t'i parandalojmë sjelljet e këqija që bëhen ndaj kafshëve? Diskutoni.

Dashuria ndaj Allahut shprehet edhe duke dashur krijesat e tij. Duke dashur krijesat, tregojmë edhe dashurinë që kemi ndaj Allahut. Nëse i duam krijesat, nëse mundohemi për të mirën e tyre, edhe Allahu na do ne. Prandaj duhet të sillemi mirë ndaj të gjitha gjallesave.



"Ndaj atyre që tregojnë mëshirë edhe Allahu tregon mëshirë." (Tirmidhi, Bir, 16)



#### Të diskutojmë së bashku

Si e duam Allahun duke dashur kafshët dhe mjedisin? Diskutoni.

Mjedisi ku jetojmë, i cili është krijuar sipas një ekuilibri dhe harmonie të caktuar, është një mirësi e Allahut për ne. Duke qenë të ndërgjegjshëm për këto mirësi, duhet të falënderojmë Krijuesin e tyre dhe t'i përdorim këto mirësi me kriter.



“Ai e ka bërë Tokën për krijesat, aty ka fruta të llojlojshme dhe palma hurmash me frutat si bistakë, ka drithëra me gjethe e kërcj dhe bimë me erë të mirë. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!” (*Rahman, 55/10-13*)

“Ai jua ka bërë Tokën të përdorshme, andaj ecni nëpër viset e saj dhe ushqehuni me atë që ju ka dhënë Ai. Si të ringjalleni, do të ktheheni tek Ai.” (*Mulk, 67/15*)



#### Është radha juaj

Shpjegoni fjalinë “Mjedisi është një mirësi për ne”.

110

Dashurinë ndaj mjedisit mund ta tregojmë duke e mbrojtur dhe zhvilluar atë. Punët që do të bëjmë për të zbukuruar mjedisin, ndihmojnë edhe në zhvillimin e gjallesave të tjera. Për shembull, pemët e mbjella përballojnë nevojën për strehim dhe ushqim të kafshëve të tjera. Prandaj Pejgamberi ynë urdhëron kështu:



“Nga pema që mbjell një musliman, ose nga prodhimi i atyre që mbjell, gjërat që ha njeriu, kafshët dhe zogjtë, janë nga një sadaka për atë musliman.” (*Buhari, Edeb, 27*)



#### Të diskutojmë së bashku

Përse konsiderohen si sadaka ato që citohen në hadith? Diskutoni.

Njeriu e zbukuron mjedisin, brenda të cilit jeton. Kur merret parasysh fakti që në shtetin tonë ka pak fusha pyjore, gjë që bën të lindin probleme të ndryshme, kjo e bën më të dukshme rëndësinë e kësaj fjale të Pejgamberit:



“Kur të nisë kiameti, nëse dikush prej jush ka në dorë një degë hurme dhe arrin ta mbjellë këtë pa nisur kiameti, duhet ta mbjellë me siguri atë, të mos e lërë pa mbjellë.” (*Buhari, Edebu'l-Mufred, 168*)





### Të diskutojmë

Çfarë punësh kryhen për pyllëzimin dhe përpjekjen kundër erozionit? Si mund të ndihmoni ju në këtë çështje? Diskutoni.

Të mbrojmë mjedisin dhe botën brenda së cilës jetojmë është detyra jonë si muslimanë. Mirëpo, vëmë re se në botën tonë kanë filluar të shfaqen disekuilibra të ndryshëm. Këta disekuilibra kërcënojnë jetën e të gjitha gjallesave. Në Kur'an, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron kështu:



“Shkatërimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që (Allahu) do t'i bëjë “të shijojnë” pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen (në përmirësim).” (Rum, 30/41)



### Të diskutojmë së bashku

Cilët janë disekuilibrat e shfaqur në botën dhe në mjedisin tonë? Cilët janë faktorët që bëhen shkak për realizimin e këtyre.



### Le të diskutojmë

Diskutoni se ç'mund të bëjmë për të eliminuar këta disekuilibra.



## Dashuria ndaj flamurit dhe atdheut



Flamuri dhe atdheu qëndrojnë në krye të vlerave që e formësojnë një popull. Flamuri dhe atdheu janë simbolet e lirisë dhe të pavarësisë. Atdhe nuk quhet vetëm një copë tokë. Është një vend ku jeton populli ynë, mbi të cilin paraqitet kultura jonë dhe ku zhvillohet ajo. Populli mbledhet rreth flamurit dhe në tokën që përbën atdheun nëpërmjet vlerave të përbashkëta.

*“Mos e quaj thjesht tokë atë që shkel, por njihe atë.*

*Pa mendoji ata mijëra të vdekur pa qefinë që shtrihen nën tokë.”*

**Mehmet Akif ERSOY (Safahat, f. 447)**



### Le të mendojmë

Duke menduar edhe rreshtat e mësipërm, diskutoni mbi rëndësinë e atdheut.

Vlerat që mbajnë më këmbë popujt, që mundësojnë unitetin mes individëve janë dashuria e atdheut dhe e flamurit.

### FLAMURI

*Hëna dhe ylli i qiejve,  
I paskan shkuar shumë për shtat ngjyrës tënde.  
Djemtë dhe vajzat e këtij vendi,  
për ty paskan luftuar.*

*Flamuri i këndshëm dhe i bukur,  
që na mbeti nga të parët,  
valëvitu në qiellin tim  
duke fluturuar krejt delikatesë.*

*Melahat Uğurkan*



#### Le të diskutojmë

Duke u nisur nga poezia e mësipërme, diskutoni mbi rëndësinë që ka flamuri.

112



Atdheu dhe flamuri ynë janë secili një amanet që na e kanë lënë të parët tanë me përkushtim të madh. Është detyrë e jona thelbësore të mësojmë se me çfarë vështirësish janë fituar këto amanete, të cilat duhet t'i mbrojmë dhe t'i zhvillojmë. Të bëjmë çdo gjë për lartësimin e atdheut dhe të popullit është një tregues i dashurisë ndaj tyre.



#### Të diskutojmë së bashku

Si mund ta tregojmë dashurinë ndaj atdheut? Diskutoni.



### Le të diskutojmë

Duke realizuar detyrat që bien mbi ne për zhvillimin e atdheut, a e tregojmë në këtë mënyrë dashurinë që kemi për të? Diskutoni

Flamuri ynë është simboli i lirisë, i pavarësisë dhe i sovranitetit. Është një ndër vlerat themelore të të qenit popull. Flamuri ynë e ka marrë ngjyrën nga gjaku i dëshmorëve. Prandaj edhe duhet të tregojmë respekt gjithnjë për të. Flamurin duhet ta mbajmë gjithmonë lart, në qiejt për të cilët është i denjë.

## 7

### Të rënit dëshmor dhe të qenit gazi



Vlera si atdheu dhe flamuri zotërojnë një vend shumë të rëndësishëm në jetesën e një populli. Herë pas here popujt mbeten në pozitë të mbrojnë atdheun dhe flamurin, të pengojnë sulmet e bëra kundrejt tyre. Të mbrosh atdheun është një domosdoshmëri e dashurisë ndaj atdheut.



### Të diskutojmë së bashku

Në cilat situata është e nevojshme ruajtja e atdheut? Flisni.

Përballë sulmeve të bëra ndaj atdheut dhe vlerave nacionale, të gjithë qytetarët i plotësojnë me dëshirë detyrat që u bien në ruajtjen e pavarësisë. Ja, pra, niveli më i madh i fituar në mbrojtjen e atdheut është të rënit dëshmor dhe të qenit gazi.

Të rënit dëshmor dhe të qenit gazi është një ndër nivelet më të mëdha që mund të përfitojë njeriu. Në Kur'an, dëshmorët janë përmendur bashkë me pejgamberët, të drejtët dhe ata që kryejnë vepra të mira.



“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata, të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me pejgamberët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!” (Nisa, 4/69) “Dhe mos thoni për ata që vriten në rrugën e Allahut se janë të vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, ndonëse ju nuk e ndieni!” (Bakara, 2/154) “Kurr-sesi mos i quani të vdekur ata që janë vvarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë dëshmorë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).” (Al-i Imran, 3/169-170)



Në fenë tonë, të rënit dëshmor është njëri prej makameve dhe niveleve më të larta. Hz. Pejgamberi na lajmëron se, përveç cenimit të së drejtës së robit, të gjitha gjynahet e dëshmorëve do të fshihen." (Muslim, Imaret, 118)

*"O dëshmor, biri i dëshmorit, mos kërko nga unë të ardhme;  
e ka hapur Pejgamberi pëllëmbën, dhe ty po të pret."*

Mehmet Akif Ersoy (Safahat, f. 74)



### Është radha juaj

Çfarë nënkupton fakti që dëshmorët do të jenë bashkë me pejgamberët? Shpjegojeni.

Populli ynë (populli turk), në një kohë të afërt ka bërë sakrificat të ndryshme për të mbrojtur atdheun, ka dhënë me mijëra dëshmorë. Shembujt më të afërt të kësaj janë shembujt e luftës së Çlirimit dhe të Çanakalasë. Në këto luftëra ka dalë në pah historia e rigjallërimit të një populli të varfër.



114



### Le të mendojmë

Vlerësoni si klasë ngjarjet që u përjetuan në luftën e Çlirimit dhe në luftën e Çanakalasë.



### Të diskutojmë së bashku

Si e tregojmë respektin ndaj dëshmorëve tanë? Diskutoni.

Ashtu siç ka dëshmorë që humbin jetën në mbrojtje të atdheut, ka edhe gazinj që mbeten gjallë. Gazinjtë janë persona që tregojnë aftësi të jashtëzakonshme në mbrojtjen e atdheut. Pasi sheshbeteja e Sakarjas rezultoi me fitore, Parlamenti i Madh Turk, me një ligj të miratuar më 19 shtator 1921, në shenjë falënderimi të popullit turk ndaj Mustafa Kemal Atatürkut, bashkë me rytben e marshallit, atij iu dha edhe niveli i gaziut. Për të jetuar bukur dhe në mënyrë të paqtë në shtetin tonë, përmendim me mëshirë të gjithë dëshmorët tanë dhe tregojmë respekt ndaj gazinjve tanë.



### Është radha juaj

Si mund ta tregojmë respektin dhe dashurinë ndaj gazinjve? Shpjegojeni.

Themeluesi i republikës turke, Mustafa Kemal Atatürk, e ka shprehur kështu falënderimin ndaj ushtrisë turke: "Në asnjë ushtri të botës nuk është rastisur në një ushtar më të pastër, më të fortë se ti. Bërthama e çdo fitoreje është tek ti. Pjesa më e madhe e çdo fitoreje është e jotja. Ndiej si detyrë të shpreh borxhin dhe falënderimin e përzemërt për përpjekjen e madhe të popullit, i cili me gjykimin, besimin, bindjen dhe me zemrën e hekurt e të pamposhtur prej asnjë frike, arriti më në fund të sfidojë armikun." (Ilhan, 198)

Populli ynë anon nga paqja. Si në marrëdhënien brenda shtetit të tij e si në marrëdhënien me shtetet e tjera ka një parim themelor, që është paqja dhe qetësia. Thënia e Atatürkut në formën "Paqe në vend e paqe në botë", është shprehja më e bukur e kësaj.



### Përmbledhja e kapitullit



Në moralin islam, dashuria ka një rëndësi shumë të madhe. Dashuria është një mirësi që Allahu ua dha njerëzve. Po ashtu, ajo është një ndër argumentet e Allahut. Sipas fesë sonë, i dashuri i vërtetë është Allahu. Ai i do shumë krijesat e tij. Është detyra jonë themelore ta duam Allahun, t'i bëjmë adhurim atij me dashuri dhe të tregojmë sjellje të bukura ndaj tij.

Pejgamberët janë persona që përhapin mesazhin e Allahut, por edhe që e jetojnë atë. Ne e mësojmë fenë nëpërmjet pejgamberëve. Prandaj, Allahu i Lartmadhëruar kërkon që të marrim si shembull Pejgamberin tonë të dashur. Dashuria ndaj Pejgamberit është e lidhur me dashurinë ndaj Allahut. Ai që do Allahun, do edhe të dërguarin e tij. Duhet të tregojmë respekt dhe dashuri ndaj të dërguarit të Allahut.

Sipas fesë sonë, njeriu është një qenie e denjë për dashuri, për shkak se është rob i Allahut dhe se është krijuar në formën më të bukur. Ka një marrëdhënie ndërmjet dashurisë ndaj njerëzve dhe dashurisë ndaj Allahut. Njëra prej situatave që shprehin dashurinë ndaj Allahut është të ndihmosh njerëzit, që janë krijesa të tij, dhe të shprehësh mëshirë ndaj tyre. Dashurinë ndaj njerëzve mund ta tregojmë duke shfaqur respekt ndaj të drejtave të tyre.

Feja jonë i ka kushtuar shumë rëndësi familjes. Këshillohet që në familje të krijohet një mjedis dashurie, lumturie, mëshire dhe paqeje. Për krijimin e një mjedisi të tillë kanë përgjegjësi të gjithë anëtarët e familjes. Prindërit tregojnë dashuri dhe mëshirë të madhe ndaj nesh. Ata bëjnë shumë sakrifica për rritjen dhe zhvillimin tonë. Bëjnë përpjekje që ne të jemi njerëz të mirë. Në këmbim të kësaj, ajo që presin nga ne është vetëm dashuri. Allahu i Lartmadhëruar kërkon që të tregojmë dashuri dhe mëshirë ndaj prindërve.

116

Në mjedisin ku gjendemi duhet të sillemi me dashuri dhe respekt ndaj kafshëve dhe gjallesave të tjera përreth. Nëse i duam krijesat dhe përpiqemi për të mirën e tyre, edhe Allahu na do ne. Feja jonë këshillon që të sillemi me mëshirë ndaj të gjitha gjallesave. Nuk duhet t'i torturojmë kafshët përreth, të cilat janë krijuar për ne, por duhet t'i ruajmë ata. Dashurinë ndaj mjedisit mund ta tregojmë duke mbrojtur dhe zhvilluar mjedisin tonë. Punët që bëjmë për të zbukuruar mjedisin tonë ndihmojnë edhe në zhvillimin e gjallesave të tjera.

Ajo që i mban më këmbë popujt, vlerat që mundësojnë unitetin e individëve, janë dashuria për atdheun dhe flamurin. Atdheu dhe flamuri ynë janë secili një amanet që të parët na e kanë lënë duke e fituar me përkushtim të madh. Detyra jonë themelore është të mësojmë se me çfarë vështirësish janë fituar këto amanete, t'i ruajmë dhe t'i zhvillojmë ato. Të bëjmë çdo gjë të nevojshme për lartësimin e atdheut dhe të popullit tonë është një tregues i dashurisë që kemi ndaj tij. Të mbrojmë atdheun është një domosdoshmëri e dashurisë ndaj tij. Rytbja më e madhe e fituar në mbrojtjen e atdheut është të rënit dëshmor dhe të qenit gazi. Përmendim me mëshirë të gjithë dëshmorët tanë që humbën jetën, në mënyrë që ne të jetojmë paqësisht dhe qetësisht në shtetin tonë të bukur dhe shprehim respekt ndaj gazinjve.





## Të rishikojmë kapitullin



1. Si mund ta tregojmë dashurinë që kemi ndaj Allahut?
2. Shpjegoni marrëdhënien mes dashurisë ndaj Allahut dhe dashurisë ndaj Pejgamberit.
3. Si mund ta tregojmë dashurinë tonë ndaj njerëzve?
4. Përse duhet t'i duam prindërit?
5. Ç'duhet të bëjmë për të mbrojtur kafshët dhe rrethin tonë shoqëror?
6. Si mund ta tregojmë dashurinë ndaj atdheut dhe flamurit tonë?







## Pyetje vlerësuese



**1. Cila nga alternativat e mëposhtme cilësohet si burim i jetesës së gjallesave?**

- A) Shpresa.                                 B) Dashuria.  
C) Drejtësia.                               D) Urrejtja.

**2. Për çfarë flitet në ajetin “Zoti im është shumë i mëshirshëm”?**

- A) Për dashurinë ndaj Allahut.         B) Për dashurinë ndaj Pejgamberit.  
C) Për dashurinë ndaj njeriut.         D) Për dashurinë ndaj atdheut.

**3. Cila është dashuria më themelore në moralin islam?**

- A) Dashuria ndaj prindërve.         B) Dashuria ndaj Pejgamberit.  
C) Dashuria ndaj kafshëve.         D) Dashuria ndaj Allahut.

**4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është tregues i dashurisë ndaj prindërve?**

- A) Të duash prindërit.                 B) Të bësh mirësi ndaj tyre.  
C) T’i urresh ata.                         D) Të të marrë malli.

**5. Cila nga kategoritë e mëposhtme konsiderohet se është gjallë, pavarësisht se ka vdekur?**

- A) Fëmija.                                 B) Bima.  
C) Dëshmori.                               D) Gaziu.





Kapitulli

7








# Sjelljet model të personaliteteve shembullore

1. Ahmet Jesevi: Dashuria për shërbim
2. Junus Emre: Dashuria
3. Mimar Sinan: Përgjegjësia profesionale
4. Mevlana: Toleranca
5. Haxhi Bektash Veliu: Dashuria ndaj njeriut
6. Mustafa Kemal Atatürku: Dashuria ndaj atdheut





### RRETH KAPITULLIT

Historia jonë kulturore është aq e pasur, sa ia vlen të lëvdohemi. Në formimin e kësaj kulture të pasur kanë dhënë kontributin e tyre shumë personalitete të rëndësishme. Qasjet morale-fetare që kanë zhvilluar këta persona vijojnë të ndikojnë ende në jetën dhe shoqërinë e sotme.

Ndihemi krenarë me veprat e këtyre personaliteteve, që mund t'i quajmë si dinamikat kulturore të shoqërisë sonë. Dashuria, përkushtimi ndaj detyrës, përgjegjësia profesionale, toleranca, dashuria ndaj njeriut, dashuria ndaj atdheut, të cilat njihen si vlera universale dhe që përbëjnë thelbin e kulturës sonë, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në formimin e trashëgimisë kulturore. Të njohim këta persona do të thotë të jemi të vetëdijshëm për trashëgiminë tonë kulturore.

122

### SYNIMET E KAPITULLIT

Pasi të keni mësuar këtë kapitull, ju do të mund:

1. Të thoni disa nga emrat e personaliteteve shembullore
2. Të përmendni disa nga sjelljet modele të personaliteteve shembullore
3. Të përvetësoni sjelljet e mira të personaliteteve shembullore
4. Të shpjegoni përse duhet të përfitojmë nga modelet e sjelljeve të personaliteteve shembullore

### NDËRSA MËSOJMË KËTË KAPITULL

1. Rishikoni nëse i keni arritur synimet e cituara në fillim të këtij kapitulli. Rilexoni çështjet që lidhen me synimet, të cilat mendoni se nuk i keni arritur.
2. Realizojini patjetër ushtrimet që jepen brenda kapitullit dhe veprimtaritë studimore.
3. Studioni veprat, informacionet e të cilave mund t'i siguron nga bibliografia në fund të librit.



1

## Ahmet Jesevi: Dashuria ndaj shërbimit



Njëri prej atyre që luajti rol të madh në muslimanizimin e Anadollit, në përvetësimin e Islamit nga turqit dhe në formimin e strukturës socio-kulturore që vijon ende sot, është Ahmed Jeseviu (?-1161). Lindi në gjysmën e dytë të shekullit 11, në qytezën Sajram, e cila shtrihet brenda kufijve të Kazakistanit. Jeseviu, i cili në moshë të vogël humbi nënën dhe më pas edhe babanë, mbeti jetim dhe u rrit pranë motrës së madhe. Më pas, bashkë me motrën u vendosën në Jesi. Emrin Jesevi e ka marrë nga Jesi, ku kreu shkollën

fillore dhe që pati ndikim në mendimet e tij. Më pas vajti në Buhara, e cila gjendet brenda kufijve të Uzbekistanit të sotëm dhe e vijoi atje arsimimin e tij.

Hoxha Ahmet Jeseviu lindi në një mjedis familjar të ditur dhe me sjellje të mirë. Ka marrë një arsim të mirë, ka mësuar shkencat fetare në Medresenë Buhara, si një qendër dijeje e zonës, por edhe shkencat e tjera të kohës. Ka marrë mësim "Tasavvufi" nga një dijetar i madh i kohës, Jusuf Hamedani. Më pas u kthye në Jesi dhe qëndroi atje deri në fund të jetës. Atje ka edukuar dhjetëra mijëra nxënës, i ka zhvilluar atje doktrinat e bazuara në Kur'an dhe sunnet. Pavarësisht se Ahmet Jeseviu e njihete



mirë persishten dhe arabishten, shprehjet e quajtura "Hikmet" i ka shkruar me një gjuhë të thjeshtë në turqisht, me qëllim që të kuptohen nga masat e gjera të popullit.

Dervishët që ka edukuar Ahmet Jeseviu kanë luajtur rol të rëndësishëm në muslimanizimin e Turkistanit; duke shtegtuar në perëndim, kanë mundur kalimin e dijes islame nga Turkistani në Anadoll. Islamizimin e Anadollit e kanë realizuar dervishët që ka edukuar Jeseviu dhe që njihen si "të arriturit/të përkorët e Anadollit". Dervishë si Junus Emre dhe Haxhi Bektash Veliu janë në pozitën e myridëve shpirtërorë të Jeseviut. Ngaqë ka edukuar nxënës të shumtë, i është dhënë nofka "Hoxha", e cila ka kuptimin edukues. Metoda e "Thirrjes në Islam" e Hoxha Ahmed Jeseviut dhe e ndjekësve të tij



123

emërohet si “Hikmet” (Urtësi). Kjo metodë, e cila zbukurohet me shprehje, thënie dhe tregime, është një metodë e këndshme, plotësuese, nxitëse, shtuese e forcës së tyre shpirtërore, përhapëse e shpresës, metodë që përfshin edhe të qenit buzagaz. Bëhet e ditur se Ahmet Jeseviu u ka dhënë emrin Hikmet poezive të tij, duke u frymëzuar nga ajeti: “Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur.” (Nahl, 16/125) Kjo metodë është edhe domosdoshmëri e parimit të thirrjes Kur’anore, ku theksohet se duhet t’u drejtohem njerëzve në përputhje me shpirtin e Kur’anit dhe sipas mendjeve e botëkuptimeve të tyre.

Ndjeshmërinë e tij mbi këtë çështje e tregon shprehja në trajtën:

*“Ata që nuk njohin ashkun, nuk kanë as shpirt dhe as besim;*

*thashë fjalën Rasulallah, po kuptimin e kësaj kush e di?*

*Sikur të them shumë fjalë, a do të ketë dëgjues dhe njerëz që i kuptojnë ato?*

*Nëse i them atij që nuk ka dije për këtë, o miqtë e mi, i ngurtësohet zemra!”*

Sipas tij, në Islam, besimi në Allah dhe orientimi drejt tij, tregon se çdo gjë është fokusuar te besimi në Allah. Pjekuria e besimit pasqyrohet në praktikat e dobishme të individit dhe të shoqërisë. Beson se qetësia dhe lumturia individuale e shoqërore mund të bëhet e mundur vetëm duke u lidhur, në nivelin e ashkut, me Allahun.

124



#### Le të mendojmë

Sipas Jeseviut, muslimanizmi i personit duhet të jetë i pastruar nga interesi botëror dhe pritshmëritë, duhet të jetë i sinqertë dhe pa pritur shpërblim. E gjitha kjo quhet ihlas. Një musliman i pajisur me ihlas (përsheptshmëri), duhet të zotërojë një personalitet jo të sipërfaqshëm, që nuk do të duket dhe nuk është i dhënë pas interesit material.

Ahmet Jesevi këshillon që, pa bërë dallim gjuhe, feje, race dhe gjinie ndaj njerëzve, t’u afrohem atyre me gjuhë të ëmbël, buzagaz dhe tolerancë. Shërbimi ndaj njeriut është urdhri i Islamit. Sepse njeriu është më i larti i krijesave. Dashuria ndaj njeriut zhvillohet në mënyrë të lidhur me dashurinë ndaj Allahut. Njeriu që beson në Allah me ashk dhe dashuri, edhe ndaj njerëzve afrohet me të njëjtën ndjenjë.

Sipas Ahmet Jeseviut, krahas detyrave ndaj Allahut, ngjitja e njeriut në nivelin më të lartë të mundshëm, pra, njohja e vetvetes, mund të arrihet me njohjen e vendit, nivelit dhe përgjegjësisë ndër njerëzit.

*Sa e habitshme, kushdo qoftë ai rob që pyet për jetimët,*

*krijuesi është i kënaqur me të.*

*(Develi, f. 71)*

Ahmet Jesevi, duke u nisur nga parimi që sjell Islami sa i përket barazisë së të drejtave dhe përgjegjësisë ndërmjet gruas dhe burrit, i ka kushtuar rëndësi të veçantë arsimimit

të femrave. Fakti që i kushtonte rëndësi të veçantë barazisë mes gruas dhe burrit në punë, prodhim, drejtim, në të drejtat sociale, në aktivitete dhe në pjesëmarrjen e grave në mësim, bëri që të shndërrohej edhe në çështje kritike te sulltani i kohës.

Sipas Jeseviut, njëra prej veçorive më të rëndësishme që duhet të zotërojë një musliman është dashuria ndaj shërbimit: njeriu duhet t'i fitojë me mund të ardhurat e jetesës, por duhet të mundohet edhe të punojë në dobi të shoqërisë. Cenimi i së drejtës së njeriut dhe së drejtës publike, përbalimi i jetesës në kurriz të dikujt tjetër, janë ndër të drejtat që Allahu nuk i fal.

Kur lexohen poezitë e Ahmet Jeseviut shihet se ai ishte i lidhur në mënyrë të plotë ndaj sunnetit të Pejgamberit tonë, Hz. Muhammedit. Ahmet Jeseviu i ka kushtuar rëndësi të veçantë përvetësimit të moralit të bukur të Pejgamberit tonë. Jeseviu, i cili i kushtonte mjaft rëndësi altruizmit, përkujdesjes për të drejtat dhe dobitë e të tjerëve, i sheh si shumë të rrezikshme sjelljet egoiste. Ai ishte shumë i lidhur ndaj parimeve morale, të tilla si të ndihmsh të shtypurit, të jesh falës, të jesh i mëshirshëm, të mos jesh zemërgur.

*Kudo që të shohësh një zemërthyer bëhu melhem për të.*

*Kudo të jetë një i nëpërkëmbur i tillë, bëhu shok me të.*

*Ji mahrem ndaj bukurisë tënde ditën e mahsherit.*

*Ja, pra, i tejkalova ata që thonë 'unë' e 'ti'.*

*(Develi, faqe 67)*

Sipas Ahmet Jeseviut, urtësia më e madhe është dashuria ndaj Allahut. Ky është thelbi i Islamit. Për të qenë ask, së pari duhet të harrosh veten tënde, të largohesh nga interesat dhe të mirat personale, duhet të mendosh të tjerët. Dashuria dhe ashku janë të mundura vetëm me këtë mënyrë. Mirëpo, për të arritur në dashurinë e Allahut duhet të kalojmë nga disa nivele. Këto janë nivelet e pjekurisë morale. Rruga kryesore e arritjes në këtë pjekuri kalon nga shërbimi ndaj njerëzve, kujdesi ndaj tyre, nga perceptimi i rëndësisë së solidarizimit social.

Ahmet Jeseviu e konsideron si detyrë fetare dhe morale që të shpëtojme nga egoizmi i nefsit, të angazhohemi me hallet dhe problemet e njerëzve. Në poezitë e tij trajton disa veçori themelore të jetesës shoqërore, të tilla si të ndihmsh ata që janë të shtypur, ata që ndodhen në gjendje të vështirë, të jesh i matur, të marrësh shpërblimin e punës, të kthesh fytyrën nga pasuria e botës dhe ndaj atyre që magjepsen pas këtyre, të mos hash të drejtën e robit, të bësh gjithmonë mirësi.

*Këdo shihja, rob bëhesha për të dhe i shërbeja;*

*bëhesha udhë ashtu si dheu në rrugët e tij.*

*Bëhesha hi që digjja ashikët dhe shuhesha.*

*Ja, pra, melhem u bëra dhe hyra nën tokë.*

*(N.S. Banarlı, 281)*

Organizata Ahite e ka përvetësuar filozofinë themelore nga Ahmed Jeseviu. Esnafët që frymëzoheshin nga Ahmet Jeseviu mbledheshin çdo mëngjes para se të hapnin dyqanet dhe në mbledhje premtorin se do të zbatonin parimet morale të shitblerjes.





## 2

## Junus Emre: Dashuria



Kur thuhet fjala dashuri, ajo që të vjen fillimisht në mendje është Junus Emre. Junus Emre (1241/1239-1320/21) është një dervish turkmen, i cili ka jetuar në shekullin XIII.



Në disa vende të ndryshme gjenden varre që thuhet se i përkasin Junus Emresë, i cili ndërroi jetë në moshën 80-vjeçare. Junus Emre erdhi në jetë në një periudhë kur në Anadoll qe prishur autoriteti i shtetit për shkak të pushtimit mongol, kur njerëzit patën rënë në pesimizëm. Me poezitë e tij ka formuar një rrëke dashurie, ka treguar se nga mungesa e shpresës dhe nga kaosi mund të shpëtojmë nëpërmjet vlerave të tilla si qetësia, dashuria dhe toleranca.

Dashuri do të thotë të duash Allahun, të duash të gjithë njerëzimin dhe ekzistencën. Dashuria nevojitet që të jesh i respektueshëm ndaj të tjerëve. Për shkak të dashurisë, në shoqëri

formohet një lidhje natyrore e përzemërt dhe një zinxhir miqësie i fuqishëm. Dashuria është punë zemre. Vlerën e kësaj e kupton vetëm ai që ka dashuri në zemër. Në dashuri nuk ka shpërblim. Dashuria formohet pa pritur shpërblim nga personi apo nga qenia që duam. Ajo që i lidh të gjitha llojet e gjallesave me njëra-tjetrën është dashuria.

Mungesa e dashurisë bëhet shkak për formimin e ndjenjave negative të njerëzimit. Mllëfi, lëndimi, moskuptimi, dobësimi i lidhjeve vëllazërore buron nga mungesa e dashurisë.

**Le të mendojmë**

Fjalët që Junus Emre përdor më shpesh në poezitë e tij janë dashuri dhe ashk; dashuria është një afrimitet që ndihet ndaj Allahut dhe të gjitha gjallesave që ka krijuar. Dashuria është një ndjenjë që e orienton njeriun të ketë interes dhe varësi ndaj diçkaje ose ndaj dikujt.

Në mendimin e Junus Emresë, çdo gjë është themeluar mbi dashuri. Në saje të kësaj ndjenje, lidhjet vëllazërore mes njerëzve, uniteti dhe bashkimi forcohen. Synimi parësor i dashurisë është dashuria ndaj Allahut. Tek Allahu arrihet vetëm me dashuri. Njerëzit dhe qeniet e tjera janë të denja për dashuri ngaqë janë krijesat e Allahut në sipërfaqen e tokës.

Sipas Junusit, dija e thatë dhe e pabazë, në aspektin shpirtëror, nuk ka dobi për asnjë. Si dija, ashtu edhe adhurimi, duhet ta shpëtojë njeriun nga nefsi i tij. Ajo që bëhet pengesë që njeriu të arrijë në këtë pjekuri është krenaria, mburrja dhe mllefi. Junusi, i cili hap luftë ndaj mburrjes dhe mllefrit, thotë:

*“Dituria është të dish, është veten ta kuptosh;  
nëse ti se kupton dot veten, ç’të duhet të lexosh?”*

Zemrat e mbushura me dashurinë ndaj Allahut janë të denja për respekt. Të thyesh zemrën e një njeriu, ta mërzisësh atë, do të thotë të mërzisësh Allahun. Zemra e njeriut është një vend hyjnor, në këtë vend respekti duhet të jetë i pafund. Për këtë arsye, Junusi thotë:

*“E pamë të afërt krijesën,  
për shkak të Krijuesit...  
Në ke shembur një herë një zemër,  
ky që fal s’është namaz!  
Zemra, fron i Zotit,  
Zoti në zemër vështroi...  
Fatkeq i dy botëve  
kush një zemër rrënoi...”*

Orientimi i njeriut ndaj Allahut dhe gjallërimi i ndjenjave buron nga dashuria. Sepse Allahu e ka krijuar njeriun si më të ndershmin e sipërfaqes së tokës. Ajo që e bën njeriun njeri është dashuria. Dashuria e bën të përjetshëm njeriun. Shndërrimi në legjendë i Mexhnunit, vendosmëria e Emrahut, forca e Keremit, çarja e maleve nga Ferhati dhe vendosja e qindra heronjve të dashurisë në zemrat e popullit, vjen nga fakti se shpirtrat janë të mbushur me dashuri.

Aq sa shkretëtirat, malet dhe farat nën tokë kanë nevojë për shi, po aq edhe njeriu ka nevojë për dashuri. Foshnjat, që nga çasti kur lindin, ndiejnë shumë nevojë për dashurinë e nënës, që të rriten, të zhvillohen dhe të piqen me këtë dashuri. Zhvillimet e personaliteteve të privuara nga dashuria mbeten të paplota.

Junus Emre e kupton dashurinë si një afërsi dhe prirje për të pasur ndjenja kundrejt Allahut dhe krijesave të tij. I mirëpret nga zemra njerëzit, qëndis dashurinë në zemra duke thënë:

*“Ejani të njihemi,  
punën ta lehtësojmë,  
të duam, të duhemi,  
botën s’do ta trashëgojmë!*

*Unë s’erdha për dava;  
puna ime për dashuri...  
Shtëpia e mikut janë zemrat;  
të ndërtoj zemra, erdha...*

Vetëm këto dy katërvargësha mjaftojnë për të treguar qasjen e tij ndaj botës dhe dashurinë ndaj njerëzimit.

Poezia e tij na tregon se ai nuk bën dallim mes njerëzve dhe kërkon që të gjithë popujt të shihen me një sy. Nënkupton se ata që bëjnë dallim ngjyre, feje, gjuhe dhe race, edhe pse duken si muslimanë, do të konsiderohen si të rebeluar ndaj Allahut.

Junusi është i dashur. Aq sa mendon se me ashk do të marrin fund të gjitha problemet:

*“Ashku do të vijë, të metat do mbarojnë!”  
“Më dëgjoni, o ashikë, ashku ngjan me një diell,  
zemra që nuk ka ashk ngjan me gurin e zi.  
Ai që ka ashk i digjet zemra, digjet e shndërrohet në qiri,  
janë nxirë zemrat e gurta e ngjajnë me dimrin e zi.”*

Sipas Junus Emresë, ajo që e privon njeriun për të qenë i tillë është mungesa e dashurisë dhe mllefi. Ai shpall se bën përpjekje në këtë çështje, kur thotë:

*“Miskinë quhemi ne,  
mllefi është armiku ynë,  
ndaj askujt mëri nuk mbajmë,  
për ne gjithë bota është një.”*

Bota e Junusit është dashuria, që do të thotë se edhe urtësia e jetës është dashuria. Këtë dashuri, njeriu e vështron në gjithësi te çdo qenie. Prandaj, edhe në botën personale të Junusit, krijesat zënë një vend të rëndësishëm. Në veçanti, lulet ndërmjet bimëve dhe pranvera ndërmjet stinëve zënë një vend të posaçëm tek ai.

“DASHURIA”, e cila e përqafton njeriun nga brenda që nga koha e Hz. Ademit, deri në ditët tona, me ndikimin e vet hyjnor është bërë zgjidhje për hallet, shërim për të



sëmuret, burim mirënjohjeje për ashikët. Për sa kohë, deri në kiamet, dashuria do të jetë dinamizmi i jetës, nuk do të ketë dhimbje, halle, luftëra dhe grindje, por do të ketë shoqëri ku dominon paqja sociale, e cila krijohet nga individë të lumtur dhe të qetë.




## Mevlana: Toleranca



Mevlana lindi më 30 shtator 1207, brenda kufijve të Afganistanit të sotëm, në qytetin Belh të zonës Horasan. Ndërroi jetë në Konja, në vitin 1273, në moshën 66-vjeçare dhe u varros në tyrben me emrin e tij, që gjendet në po të njëjtin qytet. Babai i Mevlanës është Bahaeddin Veledi, i cili ishte ndër krerët e qytetit të Belhit dhe që kur qe gjallë pati marrë nofkën 'Sulltani i dijetarëve'. Ndërsa nëna e tij është Mumine Hatun, vajza e prijësit të Belhit, Rukneddinit.

Babai i Mevlanës, Bahaeddin Veledi, në vitet 1212-1213 u detyrua të largohej nga Belhi bashkë me pjesëtarët e familjes dhe miqtë e afërt, për shkak të disa ngjarjeve politike dhe të pushtimit mongol. Vendqëndrimi i parë i Bahaeddin Veledit ishte Nishaburi. Në qytetin e Nishaburit takohet me mutasavvifin Feriduddin Attarin. Nga atje vajti



në Bagdad dhe më pas u nis drejt Mekës duke ndjekur rrugën e Kufes. Pasi realizoi farzin e haxhit, në kthim kaloi në Damask, pas Damaskut erdhi në Karaman, duke kaluar nga Malatja, Erzinxhan, Sivas, Kajseri dhe Nigde. Gjatë këtyre pesë viteve, një pjesë e madhe e Anadollit ishte nën sovranitetin e shtetit Selçuk. Shteti anadollak selçuk po jetonte periudhën më të ndritur. Sovrani i shtetit selçuk, Alaeddin Kejkubad, e ftoi Bahaeddin Veledin nga Karamani në kryeqytetin Konja dhe kërkoi prej tij që të vendosej këtu. Kur erdhën në Konja, Mevlana ishte 22 vjeç.



Në shekullin e 13-të, në të cilin jetoi Mevlana, Anadollit gjendej në një atmosferë problematike dhe jo të qetë. Për shkak të pushtimeve mongole kishin filluar bastisjet, sulmet, luftërat, populli ishte në një vështirësi të madhe. Në këtë periudhë ashikët e Hakut (Krijuesit), që quhen "Të arriturit e Horasanit", të cilët erdhën nga Azia e Mesme e u vendosën në Anadoll, këshilluan që të krijohej një unitet ndërmjet popullit të Anadollit, me qëllim që të shpëtonte nga gjendja ku ndodhej, të donin njëri-tjetrit, dhe u kanë treguar atyre parimet morale universale të fesë.

Mevlana mori mësim edhe nga Sejjid Burhaneddini. Ai ishte ndër dijetarët më të mëdhenj të periudhës, i cili erdhi nga qyteti Termez dhe u vendos në Kajseri, më pas vajti sërish në Halep dhe në Damask, si qendra të rëndësishme të fushës së dijes në këtë periudhë, ndërsa pas afërsisht një arsimit 5-vjeçar, u kthye përsëri në Konja.

Mevlana, i cili arriti në një nivel të rëndësishëm në tasavvufin islam, e fton gjithë njerëzimin në dashuri dhe në tolerancë, u hap portën të gjithëve; bëhet udhërrëfyes ndaj gjithkujt që takohej e njihej me të, cilësdo fe, medh'heb dhe populli t'i përkisnin.

*Ne nuk erdhëm për të ndarë, por për të bashkuar,*

*nga uniteti dhe bashkësia buron mëshirë, ndërsa nga ndarja dënim.*

130

Toleranca e Mevlanës buron nga vlera që i jep njeriut. Sipas Mevlanës, njeriu është krijesa më e përsosur që ka krijuar Allahu. Duke u nisur nga kjo qasje, ai ka luajtur një rol bashkues dhe plotësues mes njerëzve; nuk ka krijuar grupe të ndara në "ne" dhe "ata", por i ka parë të gjithë njerëzit si një tërësi, pa bërë dallim feje, gjuhe, race dhe medh'hebi. Në këtë kuadër ka vepruar sipas konceptimit të përgatitjes së mjedisit të jetesës së disa grupeve e kulturave të ndryshme, në një shpirt tolerance. Fjala e tij në trajtën: "Çdo pejgamber, çdo veli ka një profesion. Por ja që të gjithë këta e përçojnë popullin te Krijuesi" (Mesnevi, I, 40) përputhet me parimin themelor të fesë islame, në trajtën: "Në unitet ka mëshirë, në ndarje ka dënim." Nxënësit e Mevlanës nuk ishin vetëm nga mesi i muslimanëve, por përbëheshin nga të gjitha fetë dhe kulturat që jetonin në atë kohë në Anadoll.

Në veprën e Mevlanës, me titullin Mesnevi, ndërkohë që dashuria, dhembshuria, mirësia, toleranca, modestia dhe vëllazëria konsiderohen ndër veçoritë e njerëzimit, mllefi dhe urrejtja shihen si një sjellje që nuk i shkon për shtat njeriut (Mesnevi, I, 195). Një ndër konceptet e tij sa i përket kësaj çështjeje është si më poshtë:

***Bëhu si ujëvarë në bujari dhe ndihmë!***

***Bëhu si diell në dhembshuri dhe mëshirë!***

***Bëhu si natë për t'i mbuluar të metat e të tjerëve!***

***Bëhu si i vdekur në nervozizëm dhe zemërim!***

***Bëhu si dhe në thjeshtësi dhe përlësi!***

***Bëhu si det në mirëkuptim!***

***Ose duku siç je, ose bëhu siç dukesh!***

Mevlana është munduar të sjellë një konceptim tolerance që përfshin jo vetëm muslimanët, por të gjithë njerëzimin. Mendimet dhe filozofia e Mevlanës, kur shprehet: “Eja, prapë eja, përsëri eja, sido që të jesh. I pafe qofsh, zjarradhurues qofsh. Njëqind herë në je penduar, njëqind herë në e ke prishur pendimin. Kjo nuk është portë e pashpresës, si do që të jesh, ashtu eja!..”, sot gëzojnë përkrahje të gjerë në mjaft shtete. Perëndimorët sa vijnë e më shumë tregojnë interes ndaj botës së mendimit të Mevlanës. Mesnevi, vepra e Mevlanës, e cila është simboli më i madh i tolerancës në Turqi, është përkthyer në disa gjuhë të botës. Fjala e tij në trajtën:

***“Shtatëdhjetë e dy popuj e dëgjojnë nga ne sekretin,  
ne jemi si neji, flasim në një gjuhë me popullin e dyqind medh’hebeve”***

tregon se ai është në gjurmë të një të vërtete universale.

Në botën e sotme, ku njerëzit e kulturave dhe feve të ndryshme janë të detyruar të jetojnë së bashku, toleranca dhe dashuria, të cilat njerëzit i kanë të nevojshme për të jetuar në paqe dhe besim, formojnë thelbin e mendimit të Mevlanës dhe njeriu i sotëm sa vjen e ndien më shumë nevojë për udhërrëfimin e personave si Mevlana dhe të njerëzve të ngjashëm me të në urtësi.

## 4

### Haxhi Bektash Veliu: Dashuria ndaj njeriut

Haxhi Bektash Veliu lindi rreth vitit 1248 në qytetin Nishabur të Horasanit. Arsimin fillor e mori në Nishabur, si një ndër qendrat më të rëndësishme të dijes së asaj kohe. Pasi u largua nga Horasani erdhi në Haxhibektash, me emrin e vjetër Sulucakarahöyük, duke ndjekur një itinerar që përfshinte qytetet Nexhef, Mekë, Medine, Kudus, Halep, Elbistan, Sivas, Kajseri dhe të Kirşehir, ku edhe u vendos në këtë të fundit. Haxhi Bektash Veliu, i cili erdhi në Anadoll në vitin 1281, ndërroi jetë në Kirşehir (Sulucakarahöyük), në vitin 1373, kur ishte në moshën 92-vjeçare. Varri i tij gjendet në provincën Haxhi Bektash, provincë kjo e varur nga qyteti Nevshehir, ku edhe kaloi pjesën më të madhe të jetës.





Pranohet se është ndikuar mjaft nga Ahmet Jeseviu dhe se ka shprehur mendimin e tij në Anadoll. Për shkak të pushtimit të Anadollit nga mongolët dhe të shembjes së shtetit selçuk të Anadollit, ai erdhi në Anadoll në një periudhë ku problemet politike dhe socio-ekonomike e kishin mjeruar popullin. Më pas, me shkollën që ndërtoi arriti t'i bashkonte me sukses zemrat e njerëzve. Ka luajtur një rol të rëndësishëm në Anadoll, sidomos në zonat rurale, ku nuk dihej gjuhë tjetër veç turqishtes. Po ashtu, ka pasur një rol po aq të rëndësishëm edhe në

jetesën e përbashkët dhe në unitetin e popullit të Anadollit. Organizatat "Gazijan-i Rum, Ahijan-i Rum, Abdalan-i Rum dhe Baxhijan-i Rum", të cilat në Anadollin e asaj kohe njiheshin secila si përfaqësuese e institucioneve sociale, janë formuar dhe zhvilluar nën udhërrëfimin e tij. Duke u nisur nga ai, sistemi i mendimit që formoi mori emrin Bektashizëm. Vepra më e rëndësishme e Haxhi Bektash Veliut, i cili ishte i lidhur përzemërsisht me Kur'anin dhe sunnetin e Hz. Muhammedit, është Makalati.

Haxhi Bektash Veliu, cilado qoftë feja, gjuha apo medh'hebi, duke i bashkuar njerëzit me anë të dashurisë dhe tolerancës, ka punuar për të formuar një shoqëri të qetë dhe të paqtë. Fjalja "Edhe nëse lëndohesh, mos lëndo" i përket pikërisht atij.



#### Le të mendojmë

Sipas Haxhi Bektash Veliut, në themel të feve është dashuria, ndërsa dashuria e merr burimin nga zemra e njeriut. Ai ka mbrojtur faktin se pa qenë një njeri i mirë, nuk mund të jesh një musliman i mirë. Ndërsa themelin e të qenit njeri i mirë e shpreh në thënien e tij: "Dili zot dorës, belit dhe gjuhës."

Sipas tij, "Dashuria dhe dhembshuria janë tipar i njerëzimit, ndërsa zemërimi dhe epshi janë cilësi e shtazërisë."

Haxhi Bektash Veliu flet në poezitë e tij për parimet morale. Tregon nëpërmjet shembujsh nga ajetet dhe hadithet se sa të rëndësishme dhe të nevojshme janë në pikëpamje të jetesës individuale dhe shoqërore parime të mira morale, të tilla si durimi, maturia, turpi, bujaria dhe fitimi i lejuar, si dhe se sa të këqija janë sjelljet negative, të tilla si mburrja, smira, gënjeshtria, veprimet sa për t'u dukur, thashethemet dhe fitimi i ndaluar.

Haxhi Bektash Veliu, sa ishte gjallë, me këto veçori ku përvetëson dashurinë dhe tolerancën, ka fituar pëlqimin e njerëzve dhe është bërë shembull për ta. Ndërsa bën të ditur se këtë konceptim e ka mësuar nga hadithi i Hz. Muhammed Mustafait (s.a.s.) në formën: "Unë u dërgova për të plotësuar moralin e bukur." Haxhi Bektash Veliu, virtytin e tolerancës e shpjegon si cilësinë e të qenit falës, fjalëplotë, fjalëmbël, buzagaz, i mbushur me dashuri. Dashuria, toleranca dhe paqja shoqërore përbën thelbin e filozofisë së Haxhi Bektash Velikut.

Fjalët e Haxhi Bektash Velikut, të cilat kanë mbërritur deri në ditët e sotme, njihen gjerësisht në popull. Në shumicën e rasteve ato i tha duke u frymëzuar nga ajetet dhe hadithet. Në thelb, ato këshillojnë dashurinë ndaj njeriut dhe janë si më poshtë:

*"Një të jemi, të fortë dhe të zhvilluar.*

*Jo, nuk është prej nesh ai që pa punë jetën e kalon.*

*Portë miku është drejtësia.*

*Faqebardhë të nxjerr ajo.*

*Edhe armiku yt, njeri është, mos harro.*

*Asnjë popull dhe njeri mos turpëro.*

*Edhe nëse lëndohesh, ti prapë mos lëndo.*

*Arsimoheni femrën, ti gruan eduko.*

*Mos kërko nga dikush, atë që ty rëndë të vjen.*

*Nefsin, zemërimin, dorën, belin dhe gjuhën kontrollo.*

*Pastroje vendin ku ulesh, meritoje paranë që fiton.*

*Rrugëtimi ynë themelohet mbi dashurinë ndaj dijes, irfanit dhe njerëzimit."*





## 5

## Mimar Sinani: Përgjegjësia profesionale



Arkitekti Mimar Sinani është një ndër artistët strukturorë më të mëdhenj në botë. Lindi në vitin 1489, në qytezën Ağırnas të qytetit Kajseri. Vdiq në Stamboll, në vitin 1588, kur ishte në moshën 99-vjeçare. U varros në tyrben që u ndërtua në Sulejmanije në emër të tij.

Mimar Sinani, i cili punoi për një kohë si oficer në ushtrinë osmane, pas vdekjes së Mimar Axhem Aliut u bë kryearkitekti i Sarajit. Këtë detyrë, e cila në ditët e sotme është e ngjashme me Ministrinë e Punëve Publike, e vijoi deri në vdekje. Mimar Koxha Sinani, si një ndër personalitetet më të njohura dhe më të rëndësishme të historisë sonë të arkitekturës, madje ndër personalitetet më të rëndësishme të botës në fushën e arkitekturës, e realizoi detyrën e tij në periudhën e Javuz Sulltan Selimit, Kanuni Sulltan Sulejmanit, Selimit II dhe Muratit III, si periudha ku Perandoria Osmane ishte më e fuqishme se kurdoherë.



Ka marrë përgjegjësi të mëdha në punët e ndërtimit në ushtrinë osmane, në saje të të cilave ka tërhequr vëmendje të madhe. Sipas burimeve të ndryshme, Mimar Sinani, bashkë me nxënësit ose me arkitektët që vareshin prej tij, i la shoqërisë osmane më shumë se treqind e pesëdhjetë ndërtime, duke përfshirë 84 xhami, 52 mesxhide, 57 medrese, 7 shkolla dhe darulkurra (kurse Kur'ani), 22 tyrbe, 17 azile, 3 darushshifa (spitale), 7 rrjete kanalizimi për ujë të pijshëm, 8 ura, 20 kervansaraje, 35 qoshke dhe saraje, 6 hambarë dhe depo nëntokësore, 48 hamame.

Ndërtimi i ndërtesës së parë të rëndësishme është xhamia Shehzade (Mehmed) në Stamboll. Ajo u ndërtua në kohën kur Sinani ishte çirak. Xhamia Sulejmanije, bashkë me kompleksin e saj, të cilën Sinani e cilëson si vepër të periudhës kur ai ishte kallfa, është një ndër ndërtimet më të rëndësishme të arkitekturës osmano-turke. Xhaminë

Selimije në Edirne, Mimar Sinani e cilëson si vepër të kohës kur ishte usta. Këtu ka realizuar kupolën më të madhe, me diametër që i tejkalonte 31 m. Selimija është një vepër shumë e rëndësishme, që nga struktura e deri në formimin e vendit, nga përmasat e deri në zbukurim. Ajo është një simbol i arkitekturës osmano-turke të periudhës klasike dhe që vendos rregullat kryesore në fushën e arkitekturës.

Fakti që provoi të realizojë një kupolë, e cila do të mbulonte hapësirën më të gjerë, që do të ngjitej me tri shkallë që nuk bashkoheshin në minaren më të hollë dhe më të



gjatë, dhe në shrefetë (ballkonet) e këtyre minareve dhe fakti që ia doli ta bënte këtë, është shembull i rëndësishëm i këtij gjenialiteti të inxhinierisë.

Në rastet kur ka qenë e nevojshme, Mimar Sinani është orientuar drejt formave të reja, duke arritur të krijojë kështu një lidhje mes së vjetrës dhe së resë. Mimar Sinani, për shkak të risive që solli në fushat e arkitekturës dhe të inxhinierisë, për shkak se ndërtoi vepra të forta e të mahnitshme, në të cilat mishëroheshin të gjitha veçoritë dhe bukuritë e artit, është quajtur si “kreu i arkitektëve të botës të të gjitha kohëve”. Fakti që shumica e ndërtimeve të tij qëndrojnë më këmbë edhe pas 400 vitesh, madje që përdoren ende, tregon për kujdesin që është treguar në ndërtimin e tyre, duke nisur që nga themelet e më tej.

Mimar Sinanit iu ngarkua edhe detyra e zgjidhjes së problemit të ujit në Stamboll. Kështu, ai realizoi infrastrukturën e ujit, të njohur si Kırkçeşme (Dyzet çezma), që i tejkalon 50 km gjatësi dhe që shoqërohet me diga, tunele, tubacione dhe kanalizime uji, me strukturat e rezervimit dhe të shpërndarjes së ujit.

Kur flasim për profesion, në përgjithësi kuptohet puna që një person kryen për të fituar jetën ose për të fituar të ardhurat e jetesës. Në çdo profesion parimet dhe standardet morale janë shumë të rëndësishme. Duke qenë se Mimar Sinani ishte i përgjegjshëm ndaj profesionit të tij, duke qenë se vepronte me besimin që njeriu duhet të jetë i interesuar dhe i përgjegjshëm ndaj problemeve shoqërore, është ndër arsyet themelore që veprat e tij qëndrojnë ende më këmbë. Pavarësisht se Mimar Sinani u bë shumë i famshëm ngaqë punoi me këtë vetëdije dhe ngaqë njihte e dashuronte profesionin e arkitektit dhe punonte me një ndjenjë të madhe përgjegjësie, madje pavarësisht se jetoi në një periudhë kur Perandoria Osmane ishte më e fuqishme dhe e pasur, ai vdiq i varfër. Kur ndërroi jetë, në vitin 1588, nuk kishte para të lëna mënjanë.



## Mustafa Kemal Atatürk: Dashuria ndaj atdheut



Mustafa Kemal Atatürk lindi në Selanik, në vitin 1881. Ndërroi jetë në moshën 57-vjeçare, më 10 nëntor 1938, në Sarajin Dolmabahçe. Babai i tij është Ali Riza Efendi, ndërsa nëna është zonja Zubejde. Hafiz Ahmet Efendi, gjyshi nga ana e babait, është ndër nomadët (jorukët) e Kocacık që u vendosën në Maqedoni nga Konja dhe Ajdini. Ndërsa nëna e tij, zonja Zubejde, është vajza e një familjeje të vjetër turke të vendosur në qytezën Langaza në afërsi të Selanikut.

Kur arriti në moshën e shkollës, me dëshirën e së ëmës, Mustafai filloi të frekuentonte shkollën e lagjes, si nxënës i Hafiz Mehmet Efendiut. Pas një farë kohe, më dëshirën e babait, u transferua në shkollën e Shemsi Efendiut.

Në vitin 1899 përfundoi shkollën Ushtarake të Manastirit dhe në të njëjtin vit filloi arsimin në shkollën ushtarake në Stamboll. Në vitin 1902 u diplomua me rytben e nëntogerit.

Në vitin 1911 shkoi me detyrë në Tripoli, ndërsa më 1912-n në luftërat e Ballkanit. Tregoi heroizma të mëdha në Luftën e Parë Botërore të filluar në vitin 1914, që u zhvillua në Çanakkale për të mbrojtur dhe shpëtuar atdheun.





136

Mustafa Kemali mori detyra edhe në Edirne dhe Dijarbakir, në vitin 1916, pas luftërave të Çanakalasë. Në vitin 1916, duke luftuar me forcat ruse, mundësoi rimarrjen e Mushit dhe Bitlisit. Pas detyrave afatshkurtra në Damask dhe Halep erdhi në Stamboll në vitin 1917. Më 15 gusht 1918 u kthye si komandanti i 7 i ushtrisë në Halep. Në këtë front bëri përpjekje për mbrojtjen e tokave osmane përballë forcave angleze.

Pas marrëveshjes së Mondrosit, pasi forcat aleate filluan të pushtojnë tokat osmane, Mustafa Kemali u dërgua në Samsun, më 19 maj 1919, si inspektori i 9 i ushtrisë.

Pas luftës së gjatë dhe të mundimshme të Çlirimit, e cila filloi më 15 maj 1919 dhe përfundoi më 4 shtator 1922, dhe që u realizua bashkë me popullin e Anadollit, populli turk fitoi pavarësinë dhe Turqia u bë një atdhe i lirë.

Ataturku, me fjalët: "Gjokset e turqve të mbushur me dashurinë e atdheut do të lartësohen gjithmonë si një mur përballë ambicieve të mallkuara të armiqve", tërheq vëmendjen mbi rëndësinë e nacionalizmit. Ataturku ka vlerësuar mbi çdo gjë dashurinë ndaj atdheut dhe popullit. Për hir të kësaj dashurie ka vrapuar gjatë gjithë jetës nga një front në tjetrin dhe bashkë me shokët e tij të luftës u ka lënë amanet turqve atdheun e tyre. Dhe kjo tregon se sa i mbushur ishte ai me dashurinë ndaj atdheut. Kështu, etërit turq lanë amanet Turqinë, tokat më të bukura dhe më të begata të botës. Të mbrosh këtë amanet është një ndër përgjegjësitë fetare dhe nacionale e popullit turk.

Etërit tanë (të popullit turk) kanë luftuar heroikisht për të mos lejuar që armiqtë të shkelin tokat e atdheut, i kanë flijuar me dëshirë jetët e tyre. Duhet ta dimë shumë mirë

vlerën e atdheut tonë, i cili u vadit në çdo pëllëmbë me gjakun e dëshmorëve. Për këtë arsye, të duam atdheun dhe, kur të nevojitet, ta mbrojmë atë e t'i nënshtrohemi me dëshirë çdo vështirësie, është një detyrë e shenjtë.

Njëra prej veçorive më të rëndësishme që e bën popullin turk më të dalluar dhe më të fuqishëm, është dashuria dhe vartësia ndaj atdheut. Dashuria ndaj atdheut dhe popullit është një ndër trashëgimitë më të rëndësishme të etërve të Turqisë. Dashuria e atdheut dhe e popullit janë ndër dashuritë më fisnike dhe ndër vlerat e shenjta të popullit turk.



### Le të mendojmë

Atdheu nuk duhet të perceptohet vetëm si një copë toke, mbi të cilën jetojmë. Atdheu, përtej të qenit një copë e thatë toke, ka edhe një kuptim me vlerë të lartë.

Populli

Populli turk, tokat mbi të cilat jeton i ka konsideruar gjithmonë më të vjera se jeta dhe gjaku i tij, është përballur me çdo lloj vështirësie dhe sakrifice për t'i mbrojtur dhe zhvilluar ato. Nënshtetasit me origjinë rurale, të cilët kanë shtegtuar në qytete, për të mos u larguar nga tokat ku kanë lindur dhe janë rritur, në shumicën e rasteve i varrosin xhenazet në fshatin ose qytezën ku kanë lindur. Edhe biznesmenët që kanë migruar në qytete të mëdha si Stambolli dhe Ankaraja, borxhin që kanë pasur ndaj vendeve ku kanë lindur dhe janë rritur mundohen ta paguajnë me vepra si shkolla, spitale dhe xhamia. Në ditët e sotme, malet, gurët, uji, luginat e Anadollit konsiderohen si të vjera, në veçanti burimet e mëdha të ujit perceptohen si mirësi hyjnore dhe kështu besohet se janë.

Në Himnin Kombëtar, të cilin Ataturku e pranoi me një çmim të madh, poeti ynë Mehmet Akif Ersoy bën thirrje kështu:

*“Mos shkel mbi këtë tokë duke bërë sikur s’di!*

*Mendo për mijërat që shtrihen nën të pa qefin!*

*Ti je bir dëshmori, mos e fyej tët atë kurrsesi:*

*Mos e jep këtë vatan si xhennet botën sikur të të japin!*

*E kush nuk bëhet fli për këtë xhennet vatan?*

*Dëshmorë shpërthejnë, po ta shtrydhësh, nga kjo tokë!*

*Edhe në m’i marrtë Zoti jetën, të dashurit, gjithë ç’kam,*

*Të mos më lërë të ndarë nga vatani im në këtë botë!”*



### Le të diskutojmë

Cilat janë veprat konkrete të dashurisë ndaj atdheut? Diskutoni

Në një transmetim që i aludohet Pejgamberit tonë të dashur, thuhet kështu: “Dashuria ndaj atdheut vjen nga besimi.” Pra, kjo do të thotë se: “Besimi formon dashurinë e atdheut te njeriu. Dashuria ndaj atdheut vjen nga besimi.”





Në Kur'anin e Madhërueshëm, kur lexojmë ajetet që lidhen me hixhretin atje, ndiejmë një dashuri të theksuar për atdheun. Në Kur'anin e Madhërueshëm, në 40 ajete përmendet fjala "atdhe". Muslimanët kanë për detyrë ta duan atdheun e tyre dhe ta ruajnë atë.

Më poshtë do të lexojmë fjalët e Ataturkut, të cilat tregojnë në mënyrë të qartë se ç'është dashuria për atdheun. Pas kësaj vlerësoni shkurtimisht se ç'është dashuria ndaj atdheut.



### Të diskutojmë së bashku

"Dashuria ndaj atdheut matet me shërbimin ndaj tij."

"Nuk ka detyrë më të rëndësishme dhe më pozitive se detyra e mbrojtjes së atdheut."

"Në gjithësi nuk ka asnjë popull që ta përputhë dashurinë fetare me dashurinë ndaj atdheut."

138



### Përmbledhja e kapitullit

Në formimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, një rol të rëndësishëm kanë pasur një sërë personalitetesh që kanë jetuar përgjatë historisë së Turqisë.

Ndër më kryesorët është Hoxha Ahmed Jeseviu, i cili jetoi në Azinë e Mesme, në shekujt 11 dhe 12. Sipas Jeseviut, cilësia kryesore që duhet të ketë një musliman është dashuria ndaj shërbimit. Prandaj, të hash hakun dikujt, të vjedhësh të drejtën publike, të jetosh në kurriz të të tjerëve janë ndër gjynahet që Allahu nuk i fal.

Kur themi dashuri, ajo që na vjen në mendje është Junus Emre. Junus Emre është një dervish turkmen, i cili jetoi në Anadoll në shekullin XIII. Konceptet që hasim më shpesh në poezitë e Junus Emresë janë dashuri dhe ashk.

Një ndër personalitetet më të njohura dhe më të rëndësishme të historisë sonë të arkitekturës, Mimar Sinani, si një personalitet i kushtuar ndaj detyrës, me veprat e tij që qëndrojnë ende më këmbë, vijon të udhëzojë edhe sot, në çdo aspekt, arkitektët e rinj.

Mevlana, i cili vjen në krye të alperenëve, ka luajtur gjithmonë një rol bashkues dhe unifikues, me parimin e tolerancës ndër njerëzit, pa krijuar grupe të ndara në "ne" dhe "ata", por duke i parë të gjithë njerëzit si një tërësi pa dallim feje, gjuhe, race dhe medh'hebi.

Haxhi Bektash Velu është ndër arkitektët shpirtërorë të Anadollit. Haxhi Bektash Velu, i cili ishte i lidhur me zemër ndaj Kur'anit dhe sunnetit të Hz. Muhammedit, duke pasur si thelbësor konceptin "edhe nëse lëndohesh, prapë mos lëndo", ka marrë për bazë

dashurinë dhe tolerancën.

Mustafa Kemal Atatürku, dashurinë ndaj atdheut e ka konsideruar si më të lartën nga çdo gjë. Ai mori përsipër rolin më të rëndësishëm të të lënit amanet të një atdheu dhe pjesën më të madhe të jetës, për hir të pavarësisë së atdheut, e kaloi me luftëra.



## Të rishikojmë kapitullin



1. Përmendni pesë personalitete, prej të cilëve duhet të marrim mësim nga historia jonë dhe sjelljet e të cilëve duhet të merren si shembull.
2. Si duhet të jetë një model që duhet të merret shembull? Diskutoni.
3. Diskutoni mbi dobitë e personaliteteve shembullore për shoqërinë tonë.
4. Ç'tregohet në vargun e Mevlanës: "Jeta është e mundur nëpërmjet paqes së të kundërtave." Shpjegoni.



## Pyetje vlerësuese



**1. Për cilin nga emrat e mëposhtëm është bërë ankesë pranë sulltanit për shkak se jepte mësim edhe ndaj femrave?**

- A) Hoxha Ahmet Jesevi.
- B) Mevlana Xhelaleddin Rumi.
- C) Junus Emre.
- D) Haxhi Bektash Veliu.

**2. Cili nga poetët e mposhtëm thotë: “Në ke shembur një herë një zemër, ky që fal s’është namaz!”**

- A) Hoxha Ahmet Jesevi.
- B) Junus Emre.
- C) Mevlana Xhelaleddin Rumi.
- D) Haxhi Bektash Veliu.

**3. Cila nga veprat e mëposhtme nuk është ndër veprat e Mimar Sinanit?**

- A) Xhamia Sulejmanije.
- B) Xhamia Selimije.
- C) Ura Büyükçekmece.
- D) Xhamia Sulltan Ahmet.



**4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ka të bëjë me kufirin e tolerancës së Mevlanës?**

- A) Të krishterët.
- B) Hebrenjtë.
- C) Budistët.
- D) Asnjëri prej këtyre.

**5. Cili është dijetari që thotë: “Edhe nëse lëndohesh, prapë mos lëndo”?**

- A) Hoxha Ahmet Jesevi.
- B) Mevlana.
- C) Junus Emre.
- D) Haxhi Bektash Veliu.

**6. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk konsiderohet ndër shkaqet e fokusimit të M. Kemal Atatürkut mbi “Dashurinë ndaj atdheut”?**

- A) Ai që nuk ka atdhe nuk ka as liri.
- B) Dashuria ndaj atdheut është kushti themelor i daljes zot të atdheut.
- C) Nëse nuk ka atdhe, nuk mund të formohet as populli.
- D) Edhe popujt që nuk kanë atdhe kanë arritur në një mënyrë të jetojnë të lirë.



## Çelësi i përgjigjeve



## KAPITULLI 1

1. C, 2. B, 3. D, 4. D, 5. A

## KAPITULLI 2

1. D, 2. B, 3. D, 4. C, 5. D

## KAPITULLI 3

1. B, 2. B, 3. B, 4. C, 5. B

## KAPITULLI 4

1. D, 2. A, 3. B, 4. C, 5. B

## KAPITULLI 5

1. B, 2. A, 3. D, 4. C, 5. C

## KAPITULLI 6

1. B, 2. C, 3. D, 4. C, 5. C

## KAPITULLI 7

1. A, 2. B, 3. D, 4. D, 5. D, 6. D

## Literaturë

- A. Vehbi Ecer, "Tarihte Türkler, İslamiyet ve Mezhepleri" (Turqit në histori, Islami dhe medh'hebet", *Erdem Atatürk Kültür Merkezi Dergisi, Türklerde Hoşgörü Özel Sayısı II*, Ankara 1996, f. 485-501.
- Akseki, A. Hamdi, *Ahlak İlimi ve İslam Ahlakı (Shkenca e moralit dhe morali islam)*, Nur Yayınları, Ankara 1991.
- Armağan, Servet, *İslam Hukukunda Temel Hak ve Hürriyetler (Të drejtat themelore dhe liritë e legjislaturës islame)*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1992.
- Arslan, Ahmet, *Felsefeye Giriş (Hyrje në filozofi)*, Vadi Yayınları, Ankara 1996.
- Asya, Arif Nihat, (1996), *Dualar ve Aminler (Duatë dhe thirrjet amin)*, Ötüken Yayınları, İstanbul.
- Başkurt, İrfan, *Kur'an Açısından Din Eğitiminde Adalet, Ölçü, Denge; Eğitimde Sıratı Müstakim (Drejtësia, njësia matëse, ekuilibri në arsimin fetar në aspektin e Kur'anit; rruqa e drejtë në arsim)*, İşaret Yayınları, 2000.
- Bayraklı, Bayraktar, *Ayetler Işığında İman, İbadet ve Ahlak Üzerine Sohbetler (Besimi në dritën e ajeteve, biseda mbi adhurimin dhe moralin)*, Bayraklı Yayınları, 2000.
- Bayrakdar, Mehmet, (1997), *İslam ve Ekoloji (Islami dhe ekologjia)*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara.
- Bildiriler (Kumtesat); *Mevlana'nın 700. Ölüm Yıldönümü Dolayısıyla Uluslararası Mevlana Semineri (Seminari ndërkombëtar i organizuar me rastin e 700-vjetorit të vdekjes së Mevlanës)*, përg. Mehmet Önder, Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları Ankara 1973.
- Bilmen, Ömer Nasuhi, *Büyük İslam İlmihali (İlmihali i madh islam)*, Bilmen Basım ve Yayınevi, Ankara 1992.
- Çağrırcı, Mustafa, *Ana Hatlarıyla İslam Ahlakı (Moralı islam me linjat kryesore)*, Ensar Neşriyat, Stamboll 1985.
- Cerrar, Ethem, *İslam'da Sevgi ve Kardeşlik (Dashuria dhe vëllazëria në İslam)*, Dünya Yayıncılık, Stamboll 1993.
- Çubukçu, İ. Agah, *İslam'da Ahlak ve Vazifeler (Moralı dhe detyrat në İslam)*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1974.
- Demirci, Mehmet, *Yunus Emre'de İlahi Aşk ve İnsan Sevgisi (Ashku hyjnor dhe dashuria e njeriut te Junus Emre)*, Selçuk Yayınları, Stamboll 1991.
- Doğan, Lütfi, *Toplumun Temelini Sarsan Belli Başlı Problemler (Disa probleme të caktuara që tronditin themelin e shoqërisë)*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1986.
- Draz, M.A., *Kur'an Ahlakı (Moralı i Kur'anit)*, përkth. Emrullah Yüksel- Ünver Günay, Stamboll 1993.
- Duman, M. Zeki, *Kur'an-ı Kerim'de Adab-ı Muaşeret (Rregullat e mirësjelljes në Kur'anin e Madhërueshëm)*, Tuğra Neşriyat, Stamboll 1982.
- Erdem, Hüsameddin, *Ahlak Felsefesi (Filozofia morale)*, Hüner Yayınları, Konja 2003.
- Ersoy, M. Akif, *Safahat*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1990.
- Eskicioğlu, Osman, *İslam Hukuku Açısından Hukuk ve İnsan Hakları (Ligji dhe të drejtat e njeriut në aspekt të legjislaturës islame)*, İzmir 1996.
- Felsefe Dünyası (Bota e filozofisë)*, 1996 Felsefe Kongresi Özel Sayısı, Ankara 1997.
- Gölcük, Şerafettin, *Kur'an'da İnsanın Değeri (Vlera e njeriut në Kur'an)*, Zafer Matbaası, Stamboll 1983.
- Gövsä, İbrahim Alaaddin, *Çocuk Şiirleri (Poezi për fëmijë)*, Kanaat Kütüphanesi, Stamboll 1911.
- Güler, İlhami, *İman-Ahlak İlişkisi (Marrëdhënia besim-moral)*, Ankara Okul Yayınları, Ankara 2003.
- Haxhi Bektash Velii, *Makalat*, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 2008.
- Haxhi Bektash Velii, *Besmele Tefsiri (Şerh-i Besmele) (Tefsiri i fjalës bismil'lah)*, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 2008.
- Hamdi Mert, *Hoca Ahmet Yesevi, Hayatı, Fikirleri ve Hizmeti (Hoxha Ahmet Jeseviu, jeta, idetë dhe shërbimi i tij)*, pa datë botimi, Ahmet Yesevi Üniversitesi Yardım Vakfı, Bilig Yayınları, Ankara.
- Hamdi Mert, *İslam'da Hoşgörünün Simgesi Hünkâr Hacı Bektaş Veli (Simboli i tolerancës në İslam - Haxhi Bektash Velii)*, pa datë botimi, Bilig Yayınları, Stamboll.
- Hayati Develi, *Ahmet Yesevi*, Şule Yayınları, Stamboll 1999.
- Hoşgörü Yılında Mevlana (Mevlana në vitin e tolerancës)*, Bilimsel ve Kültür Araştırmaları Vakfı, Ankara 1995.
- İlhan, Suat, *Atatürk ve Askerlik (Ataturku dhe ushtria)*, Türk Tarih Kurumu Basımevi, Ankara 1990.
- İzutsu, Toshihiko, *Kur'an'da Dini ve Ahlakî Kavramlar (Konceptet fetarë dhe morale në Kur'an)*, Pınar Yayınları, Stamboll 1991.
- Kandemir, Yaşar, *Örneklerle İslam Ahlakı (Moralı islam i ilustruar me shembuj)*, Rağbet Yayınları, 2000.
- Karagöz, İsmail, *Ayet ve Hadislerin Işığında Sevgi ve Dostluk (Dashuria dhe miqësia në dritë të ajeteve dhe haditheve)*, DİB Yayınları, Ankara 2006.
- Karaman, Hayrettin, *İslam'da İnsan Hakları: Din, Vicdan ve Düşünce Hürriyeti (Të drejtat e njeriut në İslam: Feja, ndërjegjja dhe liria e mendimit)*, Ensar Neşriyat, pa datë botimi.
- Kaynak, Mesut, *Kur'an'da Sevgi (Dashuria në Kur'an)*, Stamboll 2003.





- Kılıç, Recep, *Ayet ve Hadisler Işığında İnsan ve Ahlak (Njeriu dhe morali në dritën e ajetit dhe të haditheve)*, Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 1995.
- Koçyiğit, Talat, *Hadislerin Işığında İman, İbadet, Ahlak (Besimi, adhurimi dhe morali në dritën e haditheve)*, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1974.
- Komisyon, *İlmihal, İman ve İbadetler I, İslam ve Toplum II (İlmihali, besimi dhe adhurimet I, İslami dhe shoqëria II)*, Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Stamboll 1999.
- Komisyon, *İlköğretim Din Kültürü ve Ahlak Bilgisi Dersi Öğretmen Kılavuzu (Udhërrëfyeti për mësues të shkollës fillore mbi kulturën dhe informacionet fetare)*, 5, 7 Milli Eğitim Basımevi, Stamboll 2002.
- Kuçuradi, İonna, *İnsan ve Değerleri (Njeriu dhe vlerat)*, Türk Felsefe Kurumu, Ankara 1998.
- Kur'an-ı Kerim Meali*, përg. Doc. dr. Halil Altuntaş –Dr. Muzaffer Şahin, D.İ.B., Ankara 2002.
- Mehmet Akif Ersoy, *Safahat*, Stamboll 1974.
- Mehmet İhsan Oğuz, *Junus Emre*, Pamuk Ofset, Stamboll 1992.
- Mehmet Önder, *Mevlana: Hayatı-Eserleri (Mevlana: Jeta-veprat)*, pa datë botimi, Tercüman Gazetesi Yayınları, Stamboll.
- Mevlana, *Mesnevi I*, përkth. A. Baki Gölpınarlı, MEB 1988.
- Milletlerarası Hoca Ahmet Yesevi Sempozyumu Bildirileri (Kumtesat e simpoziumit ndërkombëtar Hoxha Ahmed Jesevi)*, Yayına Hazırlayanlar: Abdulkadir Yuvalı, Mustafa Argunşah, Ali Aktan, Kajseri 1993.
- Mustafa Keskin, *Atatürk'ün Millet ve Milliyetçilik Anlayışı (Konceptimi i popullit dhe nacionalizmit tek Ataturku)*, Atatürk Kültür Dil ve Tarih Yüksek Kurumu, Atatürk Araştırma Merkezi, Ankara 1999.
- Namlı, Tuncer, *Ahlaki kavramlarda anlam arayışı (Qasja e kuptimit te konceptet morale)*, Fecr Yayınları, 2001.
- Nihat Sami Banarlı, *Resimli Türk Edebiyatı Tarihi (Historia e letërsisë turke me fotografi)*, Stamboll I, 1971.
- Pazarbaşı Erdoğan, *Kur'an ve Medeniyet, Doğuşu-Gelişimi-Çöküşü (Kur'ani dhe qytetërimi, lindja-zhvillimi-rënia)*, Pınar Yayınları, Stamboll 1996.
- Rifat, Ahmet, *Tasvir-i Ahlak (Përkufizimi i moralit)*, përg. Hüseyin Algül, Tercüman 1001 Temel Eser Serisi, Pa datë.
- Savater, Fernando, *Oğluma Ahlak Üstüne Öğütler (Këshilla ndaj djalit mbi moralin)*, përkth. Şadan Karadeniz, İletişim Yayınları, Stamboll 1999.
- Toksarı, Ali, "Adab-ı Muaşeret", 6-8, *İslami Kavramlar*, Sema Yazar Gençlik Vakfı Yayınları: 2, Ankara 1997.
- Yakıcı, Ali, *Yunus Emre'ye Şiirler (Poezi për Junus Emrenë)*, Kültür Bakanlığı, Ankara 1991.
- Yusuf Ekinci, *Hoca Ahmet Yesevi*, Ocak Yayınları, Ankara 1995.